REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë_____/_____/2026

MBI MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT "RINDËRTIMI I GODINËS SË KOPSHTIT "DONIKA KASTRIOTI", BERAT" , MIRATIMIT TË PRISHJES SË OBJEKTIT EKZISTUES ''KOPSHTI DONIKA KASTRIOTI'', SI DHE MIRATIMIT TË BASHKËFINANCIMIT TË BASHKISË BERAT PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTI.

Këshilli Bashkiak Berat, në mbledhjen e dates / /2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Berat, për miratimin e projektit "Rindërtimi i godinës së kopshtit 'Donika Kastrioti', Berat" dhe bashkëfinancimin e Bashkisë Berat për zbatimin e tij, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr.107/2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, Aktit të ekspertizës së Institutit të Ndërtimit nr. 1049/7 datë 19.11.2025 ''Vlerësimi i aftësisë mbajtëse strukturore të ndërtesës ekzistuese Kopshti'' Donika Kastritoi Berat'',Udhëzimit nr. 9 datë 27.04.2022 ''Përkriteret , procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjeve dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e qeverisjës vendore për financimin/bashkëfinancimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe arsimore, Urdhërit nr. 382 datë 20.07.2026 të Ministrisë së Arsimit "Mbi shpërndarjen e financimit për projekte të reja, me cikël financimi 2026-2028, nga Programet ''Arsimi Bazë'' dhe ''Arsimi i Mesëm'', shkresës numër 4235/11 dt 20.07.2026 të Ministrisë së Arsimit '' Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat", pika 7, germa a dhe b,

VENDOSI :

1. Miratimin në parim të projektit "Rindërtimi i godinës së kopshtit "Donika Kastrioti" Berat",si dhe miratimin e prishjes së objektit ekzistues ''Kopshti ''Donika Kastrioti'', projekt me vlerë totale 112,934,436 (njëqind e dymbëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë me TVSH, me afat zbatimi 10 muaj, financimi i të cilit shtrihet sipas planifikimit financiar në vitet 2026–2028.

2. Miratimin e bashkëfinancimit të Bashkisë Berat për projektin "Rindërtimi i godinës së kopshtit 'Donika Kastrioti' Berat", në masën 20% në shumën totale prej 22,586,887 lekësh, të shtrirë në vitet buxhetore si më poshtë:

për vitin 2026, në shumën 3,600,000 lekë;

për vitin 2027, në shumën 18,986,887 lekë.

3. Për vitin 2026, fondi prej 3,600,000 lekësh, i nevojshëm për bashkëfinancimin e Bashkisë Berat, të sigurohet nga fondet e planifikuara në programin AB102 “Shërbime publike, Infrastrukturë dhe Emergjenca Civile”, produkti P452AAU “Hartim projekte, studime, oponenca teknike, VNM”, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe buxhetor.

4. Pjesa e mbetur e bashkëfinancimit të Bashkisë Berat, në shumën 18,986,887 lekë, të planifikohet në buxhetin e vitit 2027, në përputhje me procedurat ligjore dhe buxhetore në fuqi.

5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Investimeve, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria Juridike, Njësia Shpenzuese Drejtoria Ekonomike e Arsimit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, sipas fushës së përgjegjësisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë_____/_____/2026

PËR

SHTESË NË BUXHETIN E BASHKISË BERAT PËR VITIN 2026 DHE DETAJIMIN E FONDEVE TË AKORDUARA NË ZBATIM TË AKTIT NORMATIV NR. 2 DATË 30.06.2026

Këshilli Bashkiak Berat, në mbledhjen e dates / /2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Berat, "Për shtesë në buxhetin e bashkisë berat për vitin 2026 dhe detajimin e fondeve të akorduara në zbatim të Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026", mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar , Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 14.01.2026 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026"; Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026, Shkresa e Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore, "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026" me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat",

VENDOSI :

1. Miratimin e shtesës në buxhetin e Bashkisë Berat për vitin 2026, në shumën totale prej 4,762,595 (katër milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh, sipas pasqyrës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shtesën në buxhetin e Bashkisë Berat të fondit prej 2,915,000 (dy milionë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekësh, nga transferta e pakushtëzuar sektoriale, në Programin AE102 Siguria dhe Mbrojtja e Territorit , Produktin V0328AAA, Llogarinë ekonomike 600, për funksionimin e shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, për përballimin e shpenzimeve për pagesën e orëve të punës jashtë orarit normal të punës të punonjësve të këtij shërbimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Shtesën në buxhetin e Bashkisë Berat të fondit prej 1,847,595 (një milion e tetëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh, nga transferta e pakushtëzuar e

përgjithshme, në Programin AF102 102Turizmi, Kultura dhe Sportet, në produktin/projektin përkatës V822AAD, në Llogarinë ekonomike 231, dhe destinimin e tij për realizimin e ndërhyrjes "Furnizim/ vendosje e tapetit të sigurisë prej gome në sheshin 'Teodor Muzaka", pranë Zyrës së Informacionit Turistik''.

4. Ngarkohet struktura përgjegjëse për financat në Bashkinë Berat për pasqyrimin e ndryshimeve të miratuara me këtë vendim në dokumentacionin buxhetor dhe në sistemet përkatëse të menaxhimit financiar.

5 Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Investimeve për zbatimin e procedurave për realizimin e ndërhyrjes së përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

Pasqyra 1 : Detajimi i fondeve të akorduara në zbatim të Aktit Normativ nr. 2 datë 30.06.2026

në lekë

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Vlera
2102001	**Bashkia Berat (Aparati)**					**4,762,595.00**
2102001		**AE102**	**Siguria dhe Mbrojtja e Territorit**			**2,915,000.00**
2102001	01.1	AE102	V0328AAA	600	Shpenzimeve për pagesën e orëve të punës jashtë orarit normal të punës të punonjësve të PMNZ	2,915,000.00
2102001		**AF102**	**Turizmi, Kultura dhe Sportet**			**1,847,595.00**
2102001	01	AF102	V822AAD	231	"Furnizim/ vendosje e tapetit të sigurisë prej gome në sheshin 'Teodor Muzaka', pranë Zyrës së Informacionit Turistik	1,847,595.00
Total Shtesa						**4,762,595.00**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Berat, më 28.07. 2026

RELACION

PËR SHTESË NË BUXHETIN E BASHKISË BERAT PËR VITIN 2026 DHE DETAJIMIN E FONDEVE TË AKORDUARA NË ZBATIM TË AKTIT NORMATIV NR. 2, DATË 30.06.2026

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në zbatim të **Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026"**, si dhe në vijim të shkresës së Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore, "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026", **Bashkisë Berat i janë akorduar fonde shtesë nga buxheti i shtetit, në kuadër të transfertave të pakushtëzuara.**

(Shkresa e Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore, "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026", dhe tabelat bashkëlidhur saj , nr. 1214/3 dt. 06.07.2026, regjistruar ne bashki me nr. 4249 prot datw 09.07.2026).

Bashkisë Berat i janë akorduar fonde në shumën totale prej 4,762,595 lekësh, nga të cilat :

- **2,915,000** lekë në kuadër të transfertës së pakushtëzuar sektoriale, për përballimin e shpenzimeve që lidhen me funksionimin e shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit

- **1,847,595** lekë në kuadër të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme.

Fondet e mësipërme propozohet të pasqyrohen në buxhetin e Bashkisë Berat për vitin 2026 dhe të detajohen sipas destinacioneve përkatëse, siç përcaktohet në vijim të këtij relacioni.

BAZA LIGJORE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
Ligji nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, i ndryshuar;

Akti Normativ nr. 2, datë 30.06.2026, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026";
Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, i Ministrit të Financave, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar;
Shkresa e Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore, "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026", dhe tabelat bashkëlidhur saj.

1. Për fondin e akorduar për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit

Në kuadër të transfertës së pakushtëzuar sektoriale për funksionimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, Bashkisë Berat i është akorduar fondi prej 2,915,000 (dy milionë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekësh.

Fondi i mësipërm do të përdoret në kuadër të Programit AE102, Produktit V328AAA, në llogarinë ekonomike 600, për përballimin e shpenzimeve që lidhen me funksionimin e shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, konkretisht për pagesën e orëve të punës jashtë orarit normal të punës të punonjësve të këtij shërbimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me destinacionin e fondit të akorduar.

Fondi i akorduar do të mundësojë përmbushjen e detyrimeve financiare që lidhen me punën jashtë orarit normal të punonjësve të MZSH-së, duke mbështetur vijueshmërinë dhe funksionimin e këtij shërbimi të rëndësishëm për sigurinë dhe mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronës së komunitetit.

2. Për fondin e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme

Në kuadër të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme, Bashkisë Berat i është akorduar fondi prej 1,847,595 (një milion e tetëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh.

Propozohet që fondi i mësipërm të destinohet për:

"Furnizim/ vendosje e tapetit të sigurisë në sheshin 'Teodor Muzaka', pranë Zyrës së Informacionit Turistik''.

Projekti parashikon furnizimin dhe vendosjen e tapetit të sigurisë prej gome, në përputhje me standardet teknike dhe të sigurisë në fuqi. Realizimi i kësaj ndërhyrjeje do të krijojë kushte më të sigurta për zhvillimin e aktiviteteve rekreative, do të përmirësojë funksionalitetin dhe aksesueshmërinë e hapësirës, si dhe do të kontribuojë në përmirësimin e imazhit urban dhe të atraktivitetit të sheshit "Teodor Muzaka", si një hapësirë e frekuentuar nga banorët dhe vizitorët, në afërsi të Zyrës së Informacionit Turistik.

Për realizimin e kësaj ndërhyrjeje, fondi prej 1,847,595 lekësh **propozohet të planifikohet në** Programin AF102 "Turizmi, Kultura dhe Sportet"**, në** Produktin V822AAD**, me përshkrimin përkatës** "Shpenzimet për pika informimi, shfaqje kulturore dhe artistike për promovimin e trashëgimisë kulturore apo forma të tjera për promovimin e trashëgimisë kulturore brenda territorit të njësive të vetëqeverisjes vendore"**, në** llogarinë ekonomike 231**, si shpenzim kapital.**

Ndërhyrja do të realizohet në bazë të dokumentacionit teknik dhe preventivit përkatës, në përputhje me fondin e miratuar dhe me legjislacionin në fuqi.

Në përfundim, fondet e akorduara për Bashkinë Berat në kuadër të zbatimit të Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026, në shumën totale prej 4,762,595 lekësh, propozohet të reflektohen në buxhetin e Bashkisë Berat për vitin 2026, sipas burimit të financimit, programeve, produkteve dhe llogarive ekonomike përkatëse.

Për sa më sipër, propozojmë:

Miratimin e projektvendimit "Për shtesë në buxhetin e Bashkisë Berat për vitin 2026 dhe detajimin e fondeve të akorduara në zbatim të Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026", sipas tekstit bashkëlidhur.

Faleminderit

KRYETARI I BASHKISË

Ervin CECA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Berat, më 27.07. 2026

RELACION

MBI MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT "RINDËRTIMI I GODINËS SË KOPSHTIT "DONIKA KASTRIOTI", BERAT" , MIRATIMIT TË PRISHJES SË OBJEKTIT EKZISTUES ''KOPSHTI DONIKA KASTRIOTI'', SI DHE MIRATIMIT TË BASHKËFINANCIMIT TË BASHKISË BERAT PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTI

Kryetari Bashkisë mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, , ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr.107/2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, Aktit të ekspertizës së Institutit të Ndërtimit nr. 1049/7 datë 19.11.2025 ''Vlerësimi i aftësisë mbajtëse strukturore të ndërtesës ekzistuese Kopshti'' Donika Kastritoi Berat'', Udhëzimit nr. 9 datë 27.04.2022 ''Përkriteret , procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjeve dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e qeverisjës vendore për financimin/bashkëfinancimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe arsimore, Urdhërit nr. 382 datë 20.07.2026 të Ministrisë së Arsimit '' Mbi shpërndarjen e financimit për projekte të reja, me cikël financimi 2026-2028, nga Programet ''Arsimi Bazë'' dhe ''Arsimi i Mesëm'', shkresës numër 4235/11 dt 20.07.2026 të Ministrisë së Arsimit '' Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat", pika 7, germa a dhe b,

PROPOZON:

MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT "RINDËRTIMI I GODINËS SË KOPSHTIT "DONIKA KASTRIOTI", BERAT" , MIRATIMIT TË PRISHJES SË OBJEKTIT EKZISTUES ''KOPSHTI DONIKA KASTRIOTI'', SI DHE MIRATIMIT TË BASHKËFINANCIMIT TË BASHKISË BERAT PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTI

Kopshti "Donika Kastrioti" pozicionohet në veri të qytetit të Beratit, në drejtimin fundor të rrugës "Pavarësia", ndërmjet një blloku banimi me objekte 1,2 dhe 4 kate. Objekti ekzistues ka një lartësi prej 2 katesh dhe paraqitet në gjendje mjaft të degraduar.

Kopshti Publik “Donika Kastrioti” përballet me problematika të rënda strukturore, të evidentuara në Akt-Ekspertizën teknike të kryer nga Instituti i Ndërtimit, nr. 1049/7 datë 19.11.2025 ‘’Vlerësimi i aftësisë mbajtëse strukturore të ndërtesës ekzistuese Kopshti’’ Donika Kastritoi Berat’’. Sipas vlerësimit teknik, godina paraqet devijime në themele dhe dëmtime në elementët strukturorë mbajtës, të cilat kanë ndikuar në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit.

Këto problematika kanë rritur ndjeshëm nivelin e riskut për fëmijët, personelin dhe përdoruesit e tjerë të godinës, duke e bërë të pamundur garantimin e kushteve të sigurta për zhvillimin e procesit edukativ. Për shkak të gjendjes së amortizuar dhe mangësive strukturore, objekti nuk përmbush më standardet teknike dhe të sigurisë të kërkuara për institucionet e arsimit parashkollor.

Në këto kushte, rehabilitimi i pjesshëm i godinës nuk konsiderohet një zgjidhje e qëndrueshme dhe afatgjatë.

Prishja e objektit ekzistues dhe ndërtimi i një objekti të ri paraqitet si alternativa më e sigurt dhe më efektive për garantimin e sigurisë së fëmijëve dhe ofrimin e një shërbimi parashkollor cilësor, në përputhje me standardet bashkëkohore të ndërtimit dhe funksionimit të institucioneve arsimore.

Përveç problematikave të sigurisë strukturore, godina ekzistuese nuk plotëson standardet bashkëkohore për organizimin e shërbimeve parashkollore, aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, kushtet higjieno-sanitare, sistemet e sigurisë kundër zjarrit, hapësirat e dedikuara për fjetje, ushqyerje dhe zhvillimin e aktiviteteve edukative. Këto kufizime ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit të ofruar dhe në mundësinë për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetit.

Ndërtimi i një godine të re përbën zgjidhjen e vetme afatgjatë për eliminimin e këtyre problematikave dhe për garantimin e një infrastrukture të sigurt, funksionale, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me standardet kombëtare për institucionet e arsimit parashkollor.

Aktualisht prej mëse 6 muaj, fëmijët e kopshtit janë zhvendosur në ambientet e shkollës ‘’Shyqyri Lakra’’, dhe ndërtesa aktuale e kopshtit është mbyllur për arsye sigurie.

Kopshti ka në total një numër prej 110 fëmijësh, dhe ka shumë kërkesa për shtimin e frekuentimit në këtë zonë të populluar me blloqe banimi.

Pas dëgjesave me prindërit dhe stafin mësimor, janë marrë në konsideratë kërkesat e tyre për ambientet e kopshtit të ri, si dhe kërkesa për t’a kthyer në kopësht me drekë, kërkesa të cilat janë përfshirë në projekt nga grupi i projektimit inxhinierik, duke përfshirë kuzhinën dhe mencën.

Objekti i ri do të ndërtohet sipas standardeve bashkëkohore për institucionet e arsimit parashkollor, me kapacitet për 110 fëmijë të organizuar në 5 grupe. Investimi synon të sigurojë ambiente të përshtatshme, të sigurta, funksionale dhe gjithëpërfshirëse për edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve, duke iu përgjigjur nevojave në rritje të komunitetit të lagjes “Donika Kastrioti’.

Godina do të përfshijë 5 salla aktiviteti, 3 ambiente fjetjeje për grupet me ushqim, kuzhinë dhe mensë, zyra administrative, dhomë psikologu, ambiente për stafin pedagogjik, depo ndihmëse,

tualete sipas standardeve, përfshirë tualet të aksesueshëm për persona me aftësi të kufizuara, si dhe sisteme të sigurisë kundër zjarrit dhe dalje emergjence.

Investimi do të përfshijë gjithashtu sistemet e ngrohjes, ventilimit dhe ndriçimit natyral, rampa hyrëse aksesimi për personat me aftësi të kufizuara, oborr të pajisur me lodra të certifikuara dhe sipërfaqe sigurie, si dhe rrethim të plotë të perimetrit të objektit.

Qëllimi i investimit është garantimi i vazhdimësisë së shërbimit parashkollor në kushte optimale sigurie dhe cilësie, përmirësimi i aksesit në arsim për fëmijët e zonës dhe krijimi i një infrastrukture moderne, të qëndrueshme dhe në përputhje me standardet kombëtare për arsimin parashkollor.

Projekti teknik është i përbërë nga :

1. Relacion Teknik
2. Analizat e ndërtimit
3. Specifikime Teknike Ndertimore
4. Relacion Teknik Elektrik
5. Grafik Punimesh
6. Preventiv total
7. Projekti Konstrutiv

Përfituesit direkt të projektit janë rreth 110 fëmijë parashkollorë dhe midis tyre edhe femijë me aftësi ndryshe, të organizuar në 5 grup-mosha, si dhe stafi pedagogjik dhe administrativ prej rreth 10 personash (drejtues, edukatore, psikolog dhe personel mbështetës).

Përfitues indirekt janë familjet e fëmijëve dhe komuniteti lokal në zonën veriore të qytetit të Beratit, të cilët do të përfitojnë nga përmirësimi i shërbimeve të edukimit parashkollor.

Bashkia Berat, ka përgatitur projektin e plotë të zbatimit dhe në thirrjen e hapur nga Ministria e Arsimit në muajin Qershor 2026, aplikoi për mbështetje financiare për këtë projekt.

Pas procesit të konkurrimit të 61 bashkive, Bahskia Berat u shpall fituese nga Ministria e Arsimit, nëpërmjet shkresës nr 4235/11 datë 20.07.2026. Kriteri i financimit për këtë thirrje, mbulon 80% të fondeve të projektit nga Ministria e Arsimit dhe 20% nga Bashkia Berat.

Sipas kushteve të financimit të përcaktuara për këtë projekt, financimi do të realizohet në masën **80% nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit**, dhe në masën **20% si bashkëfinancim nga Bashkia Berat**.

Vlera totale e projektit, sipas preventivit të miratuar, është: **112,934,436 lekë me TVSH.**

Struktura e financimit paraqitet si më poshtë:

Viti	Financimi Ministria e Arsimit	Bashkëfinancimi Bashkia Berat	Financimi total
2026	19,269,510	3,600,000	22,869,510

Viti	Financimi Ministria e Arsimit	Bashkëfinancimi Bashkia Berat	Financimi total
2027	21,500,000	18,986,887	40,486,887
2028	49,578,039	–	49,578,039
TOTAL	**90,347,549**	**22,586,887**	**112,934,436**

Financimi nga Ministria e Arsimit, sipas planifikimit të përcaktuar, shtrihet në vitet buxhetore si më poshtë:

- **Viti 2026:** 19,269,510 lekë;
- **Viti 2027:** 21,500,000 lekë;
- **Viti 2028:** 49,578,039 lekë.

Në zbatim të kërkesës për bashkëfinancim, Bashkia Berat duhet të sigurojë shumën totale prej **22,586,887 lekësh**, e cila parashikohet të shtrihet në vitet buxhetore si më poshtë:

- **Viti 2026:** 3,600,000 lekë;
- **Viti 2027:** 18,986,887 lekë.

Për vitin 2026, fondi i nevojshëm prej **3,600,000 lekësh** për bashkëfinancimin e Bashkisë Berat do të sigurohet nga programi **AB102 "Shërbime publike, Infrastrukturë dhe Emergjenca Civile"**, produkti **P452AAU "Hartim projekte, studime, oponenca teknike, VNM"**, ku për vitin 2026 është parashikuar një fond prej **42,800,000 lekësh**, nga i cili janë angazhuar/prokuruar fonde në shumën 19,120,000 lekë, duke mbetur fonde të disponueshme në shumën 23,680,000 lekë.

Pjesa e mbetur e bashkëfinancimit të Bashkisë Berat, në shumën **18,986,887 lekë**, parashikohet të planifikohet në buxhetin e vitit 2027, në përputhje me afatet e financimit dhe zbatimit të projektit.

Projekti parashikon një afat zbatimi prej **10 muajsh**, ndërsa financimi i projektit shtrihet në vitet 2026-2028 sipas planifikimit financiar të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe angazhimeve buxhetore të Bashkisë Berat.

Duke vlerësuar rëndësinë e këtij investimi për garantimin e sigurisë së fëmijëve, përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor, rikthimin e shërbimit në godinën e kopshtit "Donika Kastrioti" dhe përmbushjen e nevojave në rritje të komunitetit të zonës, propozohet:

Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli Bashkiak Berat mbi miratimin në parim të projektit "Rindërtimi i godinës së kopshtit "Donika Kastrioti", Berat" , miratimit të prishjes së objektit ekzistues ''Kopshti Donika Kastrioti'', si dhe miratimit të bashkëfinancimit të Bashkisë Berat për zbatimin e këtij projekti në masën 20% të vlerës totale të projektit.

Faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin CECA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK BERAT

Berat,më / /2026

Raporti 6 mujor i realizimit te buxhetit 2026 te planifikuar për Këshillin Bashkiak.Berat.

Në funksion të ecurië së punës së Këshillit Bashkiak të qytetit të Beratit për gjashtë mujorin parë të vitit 2026, janë realizuar një pjesë e shpenzimeve të planifikuara në buxhetin vjetor të bashkisë. Këto shpenzime lidhen me pagesat e anëtarëve të këshillit, funksionimin administrativ dhe përmirësimin e kushteve të punës.

1. Pagesat për anëtarët e keshillit bashkiak.

   Plani vjetor për periudhën: 9,486,000 lekë
   Shpenzimi faktik për periudhën Janar-Qershor: 4,929,000 lekë
   Pagesat janë realizuar në përputhje me pjesëmarrjen aktive të këshilltarëve në mbledhjet e zhvilluara.

2. Paga e Sekretarit të Këshillit

   Plan: 1,889,000 lekë
   Fakt: 992,772 lekë
   Pagesa është realizuar në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me kontratën individuale të punës.(Përfshire mungesa/leje lindje)

3. Paga Specialist i Këshillit

   Plan: 1.096,000 lekë
   Fakt: 0 lekë

4. Shpenzime për kancelari dhe pajisje zyre

   Plan: 103,000 lekë
   Fakt: 7,047 lekë

Janë përfshirë blerje materialesh kancelarike, furnizime për sallën e mbledhjeve, toner printeri, letër, si dhe mjete ndihmëse për përgatitjen e dokumentacionit të mbledhjeve.

5. Shpenzime për dhurata ceremoniale (buqeta lulesh, kurora,)
   Plan: 64,000 lekë
   Fakt: 10,000 lekë
   Janë përfshirë shpenzimet per blerjen e kurorave me lule për rastin e Ditës së Dëshmorëve 5 Maj 2026.

6. Shpenzime për mirëmbajtje pajisje kompjuterike

   Plan: 60,000 lekë
   Fakt: 10,000 lekë
   Janë shpenzime për shërbime teknike gjatë mbledhjeve, mirëmbajtje të pajisjeve IT.

7. Blerje çertifikata, karta, kartolina urimi për festat zyrtare
   Plan: 18,000 lekë
   Fakt: 0 lekë

8. Shpenzime për konsultime (seance konsultimi me bashkësinë, dëgjesat publike, transparenca e informimit)

   Plan: 75,000 lekë
   Fakt: 0 lekë

9. Shpenzime për aleancen e grave këshilltare dhe nisma me bazë ligjore

   Plan: 200,000 lekë
   Fakt: 0 lekë

Vlerësim dhe rekomandime

Shpenzimet për periudhën janar-qershor 2026 janë kryer në përputhje me planifikimin buxhetor dhe tregojnë një menaxhim të kujdesshëm të fondeve publike. Rekomandohet që edhe në vijim të vitit, të ruhet një qasje e njëjtë etransparencës përballë komunitetit lidhur me zërat e shpenzimeve..

SEKRETARE E KESHILLIT BASHKIAK

Bora Agalliu

GRAFIK PUNIMESH

Objekti:Rindertimi I godines se kopshtit "Donika Kastrioti" ne qytetin e Beratit

	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5	Muaji 6	Muaji 7	Muaji 8	Muaji 9	Muaji 10
	PUNIME NDERTIMORE										
	1. PUNIME DYER DRITARE										
	2. PUNIME SHTRESASH 2										
	3. PRISHJE										
	4. PUNIME DHEU										
	5. PUNIME MURATURE TULLE										
	6. PUNIME BETONI DHE B/A										
	7. PUNIME HEKUR BETONI										
	8. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE										
	9. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI										
	10. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME										
	11. PUNIME SHTRESASH										
	12. PUNIME TE NDRYSHME										
	13. D. SINJALET DHE PAJISJET SHTESE. NGADALESUESIT E SHPEJTESISE										
	14. PUNIME BOJATISJE										
	15. ANALIZA JASHTE LISTE										
	PUNIME ELEKTRIKE										
	1. INSTALIME PER NDRICIM										
	2. PUNIME GERMIMI										
	3. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA										
	4. NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE										
	5. ANALIZA TEKNIKE PER PUNIMET DHE INSTALIMET TEKNOLOGJIKE										
	6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME										
	7. GAZ E NAFTESJELLES										
	8. ANALIZA JASHTE LISTE										
	9. PAJISJE JASHTË LISTE										
	PUNIME HIDROSANITARE										
	1. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE										
	2. UJESJELLES E KANALIZIM I JASHTEM										
	3. PUNIME MONTIMI (M2)										
	4. PUNIME DHEU										
	5. PUNIME SHTRESASH 2										
	6. ANALIZA JASHTE LISTE										
	7. PAJISJE JASHTË LISTE										
	PREVENTIV PUNIMESH MNZ										
	1. ANALIZA JASHTE LISTE										
	2. PAJISJE JASHTË LISTE										
	PREVENTIV PUNIMESH KONDICIONIMI										
	1. ANALIZA TEKNIKE PER PUNIMET DHE INSTALIMET TEKNOLOGJIKE										
	2. ANALIZA JASHTE LISTE										
	3. PAJISJE JASHTË LISTE										

Punoi: ARENA MK shpk

Ing. Endrit MYRTAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
DREJTORIA E KONFORMITETIT AKT EKSPERTIZAVE DHE PROJEKTEVE

Nr.1049/7 prot

Tiranë,më 19/11/2025

AKT EKSPERTIZË

VLERËSIMI I AFTËSISE MBAJTËSE STRUKTURORE TË NDËRTESËS EKZISTUESE:

EMËRTIMI OBJEKTIT: **KOPSHTI "DONIKA KASTRIOTI" BERAT**
BASHKIA BERAT

KOORDINATAT: **40°42'10.4"N 19°58'12.7"E**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË - INSTITUTI I NDËRTIMIT - TIRANË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E ARSIMIT
Nr. 719/1 Prot
Date. 13/11/2025

Skanuar me CamScanner

1.VENDNDODHJA E OBJEKTIT

Objekti ndodhet në Berat, Bashkia Berat ka gjerësi dhe gjatësi gjeografike ***40°42'10.4"N 19°58'12.7"E*** *sipas koordinatave Google sikurse tregohet edhe në pamjet e mësipërme.*

Skanuar me CamScanner

2. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

2.1. Përshkrimi i Strukturës

Objekti 2 kate dhe shtesë 1 kat mbi tokë ndodhet pranë rrugës Pavarësia, Berat, Bashkia Berat.

Objekti është ndërtuar në fillimin e viteve 1990, përbëhet nga një trup i çrregullt në plan 2 kate dhe nga një shtesë 1 kat. Objekti ka sistem konstruktiv me mure mbajtës tulle si për objektin 2 kate ashtu edhe atë një kat. Në objektin 2 kate është mbjellë një kolonë b/a pa informacion mbi kohën e realizimit dhe funksionit të saj.

Muratura: Muraturë tulle me trashësi 38cm për të dy katet si dhe shtesën një kat.

Mbulesa: Mbulesa e objektit është me tarracë të inspektueshme dhe me solete me Sap.

Sipërfaqja kati përdhe: rreth 320m^2

Sipërfaqja kati i parë: rreth 270m^2

Sipërfaqja totale e objektit: rreth 590m^2

Shoqërues gjatë inspektimit: Pjesëtarë të stafit të kopshtit dhe Drejtorisë së Arsimit Berat

Data e inspektimit: 21.10.2025

Skanuar me CamScanner

2.2. Përshkrimi i Dëmtimeve

Objekti i ndërtuar në fillim të viteve 1990, ka dy kate në formë të çrregullt drejtkëndore si dhe një shtesë anësore një kat, muraturë mbajtëse tulle të plotë 38cm, një kolonë në cep b/a si dhe tarracë me soleta Sap e inspektueshme. Si dhe trare të ndërmjetëm në të dy katet me dimensione b*h=15*25cm.

Objekti paraqet dëmtime si në elementët strukturorë ashtu dhe ata jo strukturorë.

Objekti paraqet çedim themeli. Kjo vërehet tek çarja e trotuareve perimetral prej betoni, në dyshemenë e brendshme vërehen çarje të pllakave dhe sipas dëshmive të punonjësve këto dëmtime vijnë periodikisht dhe janë riparuar pllakat e dyshemesë së brendshme së fundmi.

Në cepin verior të objektit vërehet nga inspektimi se cilësia e suvase është shumë e dobët dhe aty ndodhet një kolonë b/a. Zhveshja e shtresës mbrojtëse të kolonës b/a vjen me shumë lehtësi, kjo edhe për shkak të infiltrimeve të lagështisë nga ana e themelit, por edhe cilësisë së zhavorit, kjo ka sjellë që shufrat e hekurave punues të jenë totalisht të korroduar dhe jashtë funksionit. Stafat e kolones janë distancuar rreth 35cm nga njëra tjetra duke konsideruar zonën kritike të kolonës dhe mundësinë e krijimit të cernierave plastike. Gjithashtu diametri i shufrave është i ndryshëm nga një pozicion tek tjetri. I gjithë cepi përbën rrezik pasi mund të shkëputet shtresa mbrojtëse dhe suvaja.

Gjithashtu trau lidhës mbi xokolaturen prej guri në pjesën e jashtme si dhe në pjesën e brendshme (objekti 1 kat) paraqet të njëjta karakteristika dhe dëmtime si kolona si: zhveshja e shtresës mbrojtëse të trau b/a (në këtë rast është i zhveshur), lagështia, cilësia e zhavorrit, ekspozimi i shufrave të hekurave, korodimi dhe dalja jashtë funksionit, distanca jashtë normave teknike të stafave.

Objekti paraqet të çara në pjesën lidhëse ndërmjet dy trupave (2 kate dhe 1 kat) dhe në pjesën lidhëse të murit perimetral prej guri me objektin. Fasadat paraqesin probleme të degradimit të suvase si dhe shkëputje, të çara 45° në pjesët e davanzaleve të dritareve, të çara vertikale si dhe

Skanuar me CamScanner

degradim dhe dëmtime në pjesën e parapetit të tarracës. Këto dëmtime dhe të çara janë të pranishme në të dy anët e muratures.

Në pjesën e brendshme, në mjediset e pjesës veriore, në të dyja katet vërehen të çara që fillojnë dysheme, pastaj vazhdojnë në murature dhe në solete. Në pjesën jugore pjesa e soletes paraqet një harkim të lehtë të suvase së elementëve solete Sap.

Mungesa e hidroizolimit të themelit ka bërë që të ketë prani të lageshtisë, ku falë efektit kapilar uji të depërtojë vertikalisht duke bërë që: si suvaja së bashku me llaçin e muraturës, ashtu edhe kolona b/a në cep, si dhe trarët e themeleve të degradohen duke bërë që të humbasin aftësinë mbajtëse.

Gjithashtu në të dy katet vërehet e njëjta problematikë me lagështinë ku si pjesa e muratures (jashtë dhe brenda) ashtu edhe pjesa e tavanit ka prani lagështie.

Faktorë të tjerë që kanë ndikuar në gjendjen e objektit janë edhe cilësia e materialeve të ndërtimit, mungesa e mirëmbajtjes dhe ndërhyrjeve cilësore, por edhe forcat sizmike që kanë vepruar ndër vite.

3. KONKLUZIONE

Objekti paraqet dëmtime të mëdha si në elementët strukturorë ashtu dhe në elementët jo strukturorë siç përmendet më sipër. Këto dëmtime vijnë si pasojë e shumë faktorëve: cilësia e materialeve të ndërtimit, mungesa e mirëmbajtjes, amortizimi nga koha, prania e lartë lagështisë që ndikon në uljen e aftësisë mbajtëse të elementeve murature, kolona dhe trare, por edhe forcat dinamike prej tërmeteve të ndryshëm dhe paslëkundjet e tyre. Dëmtimë paraqiten edhe në muraturën ndarëse si dhe në rifiniturat e ndryshme.

Skanuar me CamScanner

4. FOTO

1

2

3

4

5



6



7

Skanuar me CamScanner

8

9



10



11

12

13

14



15

Skanuar me CamScanner

16

17

18



19

20



21

22

Skanuar me CamScanner

23

24

25

26



Skanuar me CamScanner

27



28

29

30

31



Skanuar me CamScanner

32



33



Skanuar me CamScanner

5. REKOMANDIME

Duke marrë në konsideratë gjithë problematikat e sipërpërmendura grupi i punës rekomandon:

- Të merren masa me shirit parandalues që në pjesën veriore ku ndodhet kolona b/a të ndalohet hyrja rastësore pasi i gjithë lartësia përbën rrezik potencial shkëputje.
- Të bëhet përforcimi dhe hidroizolimi i themelit dhe të disiplinohen ujërat sipërfaqesore.
- Të merren masa për riparimin e dëmeve të shkaktuara në strukturë nga presenca e lagështisë, amortizimit nga koha, por edhe forcave dinamike të tërmeteve dhe paslëkundjeve të tyre në momente të ndryshme.
- Riparimi i dëmeve të bëhet vetëm sipas një projekti përforcimi të detajuar të hartuar nga një projektues i liçensuar sipas K.T.P dhe EURO CODE në fuqi.
- Projektuesi duhet të marri parasysh studimin gjeologjik dhe sizmicitetin e zonës ku ndodhet ky objekt.
- Rekomandohet që të bëhet modelimi i objektit.
- Të përforcohen muret perimetrale të katit përdhe dhe të katit të parë, kolona b/a e cila është jashtë funksionit, soleta, parapeti i tarracës, por edhe elementët e tjerë të dëmtuar.
- Të hartohet një projekt për riparimin e objektit i cili garanton:
  a. Rezistencë mekanike, stabilitet dhe rritjen e aftësisë mbajtëse, dhe kapacitetin sizmik të strukturës.
  b. Përdorim të sigurtë të ndërtesës.

Grupi i inspektimit në terren:

Ing. Mateo Fili

Ark. Almir Hoxhaj

Ark. Rea Lamaj

Miratoi:
Matilda HAZIZAJ
Drejtor i DKAP

Data 10.11.2025

Skanuar me CamScanner

Faturë Elektronike

PLATFORMA QENDRORE E FATURAVE

Shitës

Emri:	**INSITUTI I NDËRTIMIT (IN)**
Emri tregtar:	INSITUTI I NDËRTIMIT (IN)
NIPT:	J91912001A
Adresa:	TIRANË
Qyteti dhe Kodi postar:	TIRANË
Shteti:	Albania
Adresa elektronike:	J91912001A

INFORMACIONE TË FATURËS

Kodi / Emri i llojit të faturës:	388 / Faturë tatimore
Specifikimi i standardit:	urn:cen.eu:en16931:2017
Lloji i Procesit:	P2 Faturimi i dërgesave të mallrave dhe shërbimeve bazuar në një kontratë
Faturë borxh i keq:	false

TË DHËNAT E FATURËS

Numri i faturës:	830/2025
Data dhe ora e lëshimit të faturës:	10.11.2025 13:33:18
Monedha e faturës:	ALL
Monedha e llogaritjes së TVSH-së:	1,000000
Data e fillimit të periudhës së faturimit:	10.11.2025
Data e mbarimit të periudhës së faturimit:	10.11.2025
Kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit:	10150275143 (qx662ns668), Rruga Myslym Keta,BRAR,TUFINE, Tirane, Albania
Kodi i operatorit:	INSTITUTI I NDERTIMIT (I N) (my557gn340)
NIVF:	d57ebe19-b8b3-4807-88c0-e448950eed05
NSLF:	1778A79132985A7BECA340B2FDBB41F2

BLERËSI / KLIENTI

Emri:	**DREJTORIA E ARSIMIT BERAT**
Emri tregtar:	DREJTORIA E ARSIMIT BERAT
NIPT:	K52917025B
Adresa:	BERAT
Shteti:	Albania
Adresa elektronike:	K52917025B

Skanuar me CamScanner

ARTIKUJT E FATURËS

Nr.	Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit Njesia e Matjes Sasia	Çmimi bruto për njësi Ulja e çmimit Çmimi bruto për njësi	Vlera e zbritjes Vlera e shtesës Vlera neto pa TVSH	Kodi i TVSH Shkalla e TVSH
1	Akt Ekspertize Copë 1.000	166 666,67 200 000,00	0,00 0,00 166 666,67	S-VAT 20

SHPËRNDARJA E TVSH-SË

Kodi i TVSH-së	Shkalla e TVSH-së	Vlera e tatueshme	Shuma e TVSH-së
S-VAT	20	166 666,67	33 333,33

TOTAL NË ALL	
Shumat totale neto të artikujve:	166 666,67 ALL
Shuma totale pa TVSH:	166 666,67 ALL
Shuma totale e TVSH-së:	33 333,33 ALL
Shuma totale me TVSH:	200 000,00 ALL
Shuma e paguar:	0,00 ALL
Shuma e rrumbullakimit:	0,00 ALL
Shuma totale e mbetur për t'u paguar:	**200 000,00 ALL**

Skanuar me CamScanner

INFORMACIONI I PAGESËS

Afati i pagesës **10.12.2025**

Mënyra e pagesës:	Pagesa në llogarinë bankare(Account)
Emri i llogarisë:	CREDINS BANK NE LEK
IBAN:	AL962121109200000000000649685
Emri i bankës:	Credins Bank
Përshkrimi i pagesës:	ACCOUNT

Mënyra e pagesës:	Pagesa në llogarinë bankare(Account)
Emri i llogarisë:	BANKA KOMBETARE TREGTARE
IBAN:	AL30205110210914 22CLCUCLALLA
SWIFT:	NCBAALTX
Emri i bankës:	Banka Kombëtare Tregtare
Përshkrimi i pagesës:	ACCOUNT

SHËNIME

Akt ekspertize objektive: Nopshti Donika Kastrioti dhe kopshti Molisht, ne baze te marreveshjes me nr prot tuajin 573 dhe tonin 1049 date 19.09.2025, Credins bank : AL962121109200000000000649685

Skanuar me CamScanner

Faturë Elektronike

PLATFORMA QENDRORE E FATURAVE

Të gjitha informacionet e nevojshme për pagesën e kësaj fature mund të gjenden në këtë kod QR

Të gjitha informacionet në lidhje me këtë faturë mund të shihen në këtë Kod QR

Specifikimi i hollësishëm i artikullit të faturës

Nr.	Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit Njësia e Matjes Sasia	Çmimi bruto për njësi Ulja e çmimit Çmimi bruto për njësi	Vlera e zbritjes Vlera e shtesës Vlera neto pa TVSH	Kodi i TVSH Shkalla e TVSH
1	Akt Ekspertize Copë 1.000	166 666,67 200 000,00	0,00 0,00 166 666,67	S-VAT 20

Shuma bazë: **166666.67**
Sasia: **1.00**
Njësia e Matjes: **Copë**

Për të gjitha informacionet dhe ndihmë kontaktoni:
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Numri i Telefonit: 0800 14 14
E-Mail: einvoice_support@tatime.gov.al
Adresa: Rruga Gjin Bue Shpata, Tirana 1000, Albania

Për të gjitha informacionet dhe ndihmë kontaktoni:
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
Numri i Telefonit: +355 422 77750
E-Mail: einvoice_support@akshi.gov.al
Adresa: Rr. Papa Gjon Pali i II, Nr 3, Tirana1003,

Skanuar me CamScanner

“SELAS” sh.p.k

Projekt – Menaxhim - Konsulta

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania

Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

RAPORT I VLERESIMIT

TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER OBJEKTIN:

“ PUNIME REHABILITIMI PER MIREMBAJTJEN E DIGES TE REZERVUARIT BOVE, ROSHNIK”

BASHKIA BERAT

TIRANE, 2026

“SELAS” sh.p.k

Projekt – Menaxhim - Konsulta

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania

Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

P E R M B A J T J A

i. Parathenie

II. Hyrje

a. Pershkrim i pergjithshem

b. Kuadri ligjor

c. Karakteristikat fizike e klimaterike

III. Pershkrimi i projektit

a. Pershkrimi i hollesishem i te gjithe objektit

b. Pershkrimi i nderhyrjeve suipas projektit te miratuar

iv. Te dhena per mjedisin egzistues

v. Ndikimi i mundeshem ne mjedis dhe masat e propozuara per parandalimin dhe zbutjen e tyre

vi. Konkluzione dhe detyra

vii. Perfundime

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

I. NE VEND TE PARATHËNIES

Shqipëria, si palë nënshkruese e një numri konventash ndërkombëtare, disa kontratave dhe dokumentave të tjera ligjore është e detyruar të zbatojë një sistem efektiv për administrimin e tokës, ujit dhe ajrit, jo vetëm në drejtim të zgjidhjes së një problem të caktuar, por edhe të zbatimit të përgjegjësive të saj nën këto marrëveshje ndërkombëtare.

Mbrojtja e mjedisit, si një sistem dinamik, që ndryshon herë pas here fizikisht dhe biologjikisht, duhet parë në tërësinë e faktorëve natyrorë dhe të veprimit njerëzor që ushtrohet mbi të.

Zhvillimi urban në Bashkine Berat jep një ndikim të caktuar, duke goditur pak a shumë natyrën përreth, sidomos kur parametrat e ndërtimit dhe të menaxhimit të tij nuk analizohen konform ligjeve e rregullave të natyrës, në dobi të ruatjes së ekuilibrave e të ekosistemeve të saj etj.

Një ndër burimet e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit janë zhvillimet urbane, që sipas natyrës dhe mënyrës teknike të aplikuar shkaktojnë ndotje, me sasi dhe natyra të ndryshme, midis të cilave më të rëndësishme janë:

- Gjatë operacioneve të ndërtimit, dhe pastaj edhe të funksionimit;
- Sistemi teknologjik i furnizimit me lëndë të parë dhe eleminimi i mbetjeve të tyre;
- Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit;
- Sistemi mbrojtës nga përmbytjet dhe rreziqet e mundshme natyrore; Metodat e uljes së ndotjes, në zhvillime urbane si qendra banimi, biznesi, shlodhëse, etj, konsistojnë në perfeksionimin e teknikave të mirëmbatjes dhe mirë menaxhimit të zonave apo të komplekseve të ndërtimit, por mbi të gjitha në marrjen e masave kundrejt atyre faktorëve që mund të ndikojne negativisht ndaj parametrave natyror e shëndetësor.

Këto ndërtime japin një efekt të caktuar, duke goditur pak a shumë natyrën përreth, sidomos kur parametrat e ndikimit të saj nuk analizohen konform ligjeve e rregullave të natyrës, në dobi të ruatjes së ekuilibrave e të ekosistemeve të saj.

Nxitja e tyre kërkon një përkujdesje më të madhe nga ana e organeve legjislative dhe vendimmarrëse, në mënyrë që të rritet interesi për ndërtime dhe aktivitete të tilla, si dhe shoqëria investuese duhet të tregojë interes, si për zhvillimet në fushën e ndërtimit, dhe në ruatjen e ekuilibrave natyror, dhe veçanërisht në ruatjen e ekosistemeve.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

II. HYRJE

a.-Një Pershkrimi i pergjithshem

Objekti: **"**Punime Rehabilitimi per Mirembajtjen e Diges te Rezervuarit Bove, Roshnik" ndodhet në Bashkine Berat.

Objekti i mësipërm ka disa nënobjekte:

1-Diga e rezervuarit

2. Ujlëshuesi i rezervuarit

3. Shkarkuesi katastrofik i rezervurit

4. Rruga per ne objekt

b-Kuadri Ligjor

Ky raport i Vleresimit dhe Ndikimit ne Mjedis eshte hartuar duke patur parasysh:

Legjislacionin e Shtetit Shqiptar dhe te Komunitetit Europian, me akte juridike ligjore dhe nenligjore specifike qe rregullojne ushtrimin e aktivitetit te investimeve dhe gjithashtu aktet ligjore lidhur me mbrojtjen e mjedisit si me poshte:

1. *Ligji per Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 8934, dt. 23.01.2003, 05.09.02 neni 26 "Procesi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis".*
2. *Ligji Nr. 8990, date 23.01.2003, neni 8 dhe 9 "Mbi vleresimin e ndikimit ne mjedis"*
3. *Ligji "Leja per veprimtarite qe ndikojne ne mjedis"*
4. *Ligji "Per token" nr. 7501 dt.27.01.1995*
5. *Udhezues Nr. 6 i Ministrise se Mjedisit, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie"*
6. *VKM per "Sigurimin dhe Informacionin e Mjedisit e Drejta e Publikut per Informacion", dt.06.01.1998*
7. *Ligji nr. 8990, dt.23.01.2003 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis".*
8. *Ligji Nr.10440, dt.07.07.2011 " Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis".*
9. *Ligji Nr.12/2015 " Per disa ndryshime ne ligjin Nr.10440 date 07.07.2011.*
10. *Ligji 10006,date 23.10.2008 "Per mbrojtjen e faunes se eger"*
11. *Ligji 9587, date 20.07.2006 "Per mbrojtjen e biodiversitetit"*
12. *Ligji 8906, date 06.06.2002 "Per zonat e mbrojtura" i ndryshuar*

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

13. *VKM Nr.686, date 29.07.2015 " Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit te deklarates mjedisore.*
14. *Ligji Nr.128/2020 " Per disa ndryshime e shtesa ne Ligjin Nr.10440 date 07.07.2011."Per vleresimin e ndikimit ne mjedis" te ndryshuar.*
15. *Ligji Nr.27/2016 "Per menaxhimin e kimikateve"*
16. *Ligji Nr.155/2020 " Per ndryshimet klimatike"*
17. *Ligji Nr.162/2014" Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis" se bashku me nenaktet ligjore.*

c.- Karakteristikat fizike e klimaterike te zones ku ndodhet objekti

Sipas ndarjes klimatike të dhënë në librin Klima e Shqipërisë (Botimi i Institutit Hidrometerologjik) Tiranë,1975), Rajoni i Roshnikut, kryesisht shtrihet në nënzona Mesdhetare Kodrinore Jugore.
Ndërkohë që pjesa tjetër e territorit të bashkisë, në Jug e Jug-Lindje i nënshtrohet kushteve klimaterike karakteristike për nënzonën mesdhetare kodrinore jug-lindore, përfshi këtu edhe zonën e pellgut ujëmbledhës.
Në përgjithësi, kjo zonë karakterizohet nga një shpërndarje e dukshme e rreshjeve ku numri i ditëve me rreshje është nga 110 deri 120 ditë.
Dimri është relativisht i butë dhe ditët me ngrica në këtë territor janë të pakëta, duke mos i kaluar 5 -10 ditë në vit.

Regjimi i rrezatimit

Në përgjithësi, kjo zonë karakterizohet nga vlera relativisht të larta të diellzimit dhe rrezatimit diellor. Konkretisht, në këtë zonë vrojtohen mbi 2 200 orë me diell në vit.
Zona në fjalë karakterizohet nga një lagështirë relativisht e lartë, me vlerë të mesatares vjetore 65 ÷70%.
Vlera më e ulët vrojtohet në Korrik 61% .

Reshjet atmosferike

Një element tjetër mjaft i rëndësishëm për të karakterizuar klimën e një vendi janë rreshjet atmosferike.
Edhe në fushën e reshjeve, kjo zonë paraqitet mjaft homogjene.
Sasia mesatare vjetore e rreshjeve në ketë zonë varion nga *930 ÷ 1010 mm* shi në vit, ndersa rreshjet maximale 24 oreshe, ne vlere mesatare vjetore rezultojne ne rreth *115 mm* shi.
Sasia më e madhe e rreshjeve, rreth 65% e tyre bie gjatë gjysmës së ftohtë të vitit. Muaji më i lagët është muaji Nëntor, gjatë të cilit mund të bien deri në 165 mm.shi.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Kurse përsa i perket rreshjeve maximale me probabilitete dhe kohezgjatje te ndryshme, nga 30 min (minuta) deri ne 24 ore, në studim i jemi referuar te dhenave meterologjike te Stacionit Metrologjik Fierit, si stacioni me i afert (25 km ne vije ajrore), i cili ka te dhenat e mjaftueshme edhe per sasine e rreshjeve me probabilitete perseritje te ndryshme por edhe per kohezgjatje stuhie per 10 (minuta) apo edhe per 20 (minuta).

Era

Pergjithesisht, ererat ne kete zone jane te paqendrueshme, por gjate vitit me shume mbizoteron drejtimi i Veri-Perendim - Jug-Lindje.

Një erë karakteristike është dhe murlani, që sa vjen e dobësohet drejt pjesës qendrore të ultësirës, ku bën pjesë dhe rajoni ynë, e cila sjell shpesh pasoja negative.

Në rajon ndihen mirë dhe erërat e nxehta e të thata, që kanë rastisje jo të vogël.

Ngjarjet e pazakonta klimaterike

Ndër dukuritë e pazakonta klimatike, që mund të hasen në rajonin në fjalë, kryesisht bëjnë pjesë ato që lidhen me regjimin e reshjeve.

Zona jonë si pjesë e një rajoni siç është Shqipëria, me klimë tipike mesdhetare, karakterizohet nga një regjim i çrregullt i reshjeve nga pikëpamja e shpërndarjes vjetore. Kjo shpërndarje karakterizohet nga një maksimum në muajt e dimrit (30-40% e reshjeve vjetore) dhe një minimum në muajt e verës (10%).

Përveç ndryshimeve të ndjeshme në sasitë që ato bjen, çrregullime në lidhje me reshjet vihen re edhe në shpërndarjen e tyre gjeografike.

Kështu, në shkallë lokale herë pas here ndodhin edhe ngjarje jo të zakonta si reshjet intensive brenda 24 orëve të shoqëruara në disa raste me përmbytje apo mungesa e theksuar e reshjeve ne periudha të ndryshme që sjell thatësira të zgjatura.

Në vitet e ardhshme (sipas UNEP, 1994) pritet që deri në vitin 2100, si rezultat i ngrohjes globale, të ndodhë një ndryshim i temperaturës mesatare vjetore me 0,7 ÷ 2,5°C, gjë e cila do të pasqyrohet edhe në ciklin hidrologjik.

Gjatë dimrit pritet që rritja e temperaturës të ndjekë ecurinë vjetore, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet deri me 5%. Gjatë pranverës temperaturat mesatare që ndryshojnë mes 13,8 dhe 15,7°C mendohet të ndryshojë në 15,2°C dhe 18,5°C, ndërsa sasia e reshjeve do të rritet me 0,18%. Gjatë verës temperaturat mesatare do të luhaten nga 23,2°C në 24,7°C, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet me 60%.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Disa dukuri Gjeologjike

Ne ndertimin gjeologjik te kesaj zone (Lugine) pergjithesisht marrin pjese formacionet flishoidale te moshes Krete-Paleogen i Ri dhe depozitimet e Kuaternarit.

Depozitimet kuaternore perfaqesohen nga depozitime deluviale - suargjilore me permbajtje fraksione çakullore, ndersa ne shtrat takohen edhe depozitime te paketa zhavorore.

Ne pjesen e siperme te pellgut shimbledhes por edhe ne zonen e diges dhe ne perroin qe kalon aty prane, vihet re se brigjet e lugines kryesisht paraqiten te çrregullte dhe vende vende me rrezime (shkarje) te skarpatave te tyre.

Ne kete zone bregu i djathte i perroit, perbri te cilit kalon dhe rruga kryesore e fshatit, nderkohe qe ndodhet edhe diga e rezervuarit, perfaqesohet nga teraca e pare e perroit, qe perbehet kryesisht nga depozitime deluviale – aluvjale te perfaqesuara nga dhera suargjilore me permbajtje fraksionesh çakellore, ne gjendje mesatarisht te ngjeshura.

Kurse ne zona relativisht me te thella pergjate segmentit ku shtrihet diga, vihen re depozitimet aluviale te perfaqesuara nga dhera suargjilore te pluhuruara ngjyre kafe te hapur e deri ne ngjyre gri.

Ne konkluzionet dhe rekomandimet e studimit gjeologjik theksohet se ne pergjithesi keto depozitime vleresohen si lehtesisht te gerryeshme e qe behen plastike e me premisa rreshqitje nën prezencen e ujrave e të lageshtise. Në keto kushte, vihet ne dukje ne vleresimin gjeologjik, se nevojat per nje ngjeshje relativisht te plote deri ne kompaktesim te materialit qe do te hidhet per mbushje ne dige mbetet detyre parësore gjate zbatimit te punimve.

Gjithashtu ne studimin gjeologjik vihet ne dukje se nga pikepamja e sizmicitetit, zona ne fjale perfshihet ne zonen sizmike me intensitet te lekundjeve deri 7-8 balle, por gjithashtu vihet re se, për nje kohe relativisht te gjate (prej gati 55 vitesh), ne kete dige nuk jane vene re cedime apo çarje te mirefillta per shkaqe sizmike.

Nga pikepamia tektonike zona ne studim ben pjese ne Zonen e Ultesires Adriatike.

Bazuar ne rikonjicionin gjeologjik te kryer ne vend nga autoret e studimit si dhe informacionin e mare nga harta gjeologjike ne shkalle 1:25.000.

Planshetat K-34-112-

Ku, formacionet gjeologjike qe takojme në kete zone jane të tipit : Pliocen i mesem (N22r)

Këto lloj formacione takohen ne rajonin e Kavajes, Rrogozhines, Frakulles, Divjakes, Kryevidhit, Patosit, Kuçoves, Roskovecit, Mallakastër, etj. dhe ne teresi ne te gjithe Ultesiren Adriatike. Ne thellesi ato jane faktuar nga shume puse te shpuar.

Depozitimet e formacionit "Rrogozhina" vendosen mbi pakon argjilore te formaciomit "Helmasi" dhe kane maredhenie normale me të.

Ato kane perhapje ne te gjithe shtrirjen e Ultesires së Adriatikut .

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Ne ranoret dhe konglomeratet e ketij formacioni gjenden shtresezime te pjerrta e te kryqezuara, karakteristike e trashesise te ormacionit mollasik. Ne Pliocenin e mesem formacioni "Rrogozhina" karakterizohet nga prezenca ne prerje e nje faune shoqeruese te varfer te foraminifereve planktonike dhe me mbizoterim ryesisht te formave bentosike. Trashesia e formacionit "Rrogozhina" leviz nga 50m.ne prerjen e Patosit, deri ne 1450m. ne prerjen e Rrogozhines.

Theksojme qe argumentimi moshor i depozitimeve te Pliocenit ne Ultesiren e Adriatikut eshte mbeshtetur dhe nga studimet makrofosilore.

Kuaternari

Depozitimet e Kuaternarit ne zonen ne studim perfaqesohen nga depozitimet e Holocenit si dhe nga depozitimet e perziera (apo te pandara) te Holocen Pleistocenit.

Ne depozitimet e Holocenit mund te dallojme depozitimet e Holocenit te siperm (alQh2) te perfaqesuara nga depozitimet aluviale te shtratit te perbera nga nje nderthurje ritmike e zhavorreve, rerave, argjilave e suargjilave, si dhe depozitimeve te Holocenit te oshtem (alQh1) te perfaqesuara nga depozitimet terracoro-aluviale te perbera nga nje asortim i keq zhavorreve, rerave dhe alevriteve.

Tektonika

Objekti yne i studimit ben pjese ne zonen tektonike te Ultesires Adriatike.

Ultesira Adriatike ndodhet ne pjesen qendrore e veriperendimore Albanideve te jashtme, ne buzen e orogjenit ne kontakt me platformen Adriatike.

Ajo perfaqeson nje ultesire paramalore qe shtrihet mbi zonat e Sazanit, zonat Jonike etj,

Ne pjeset anesore, sidomos aty ku ato vendosen mbi orogjenin, depozitimet molasike te ultesires, vendosen transgresivisht mbi vazhdimin e strukturave te zones Jonike (Cakran, Kreshpan, Patos-Verbas, etj.) dhe te zones Kruja (sinklinali i mbivendosur i Tiranes).

Ne pjesen qendrore ku ajo vendoset mbi zonen e Adriatikut Jugor, pergjithesisht pranohet shuarja e mosperputhjeve dhe mardhenie suksesive te depozitimeve.

Ne teresi Ultesira Adriatike, duke gjykuar nga ndertimi tektonik dhe sidomos nga mardheniet me katin e poshtem strukturor, mund te ndahet ne tre sektore :

Sektori lindor:- Shtrihet prane buzes lindore te Ultesires, duke filluar nga Kanina, Treblova, Selenice-Kreshpan, Ardenica, Marinze-Bubullime, Kemishtaj.

Ky sektor vazhdon me mulden-in e Kuçoves, Pekisht e me ne veri me mulden e Galushit dhe akoma më në veri me sinklinalin e Tiranes.

Ne pergjithesi pranohet vijushmeria e depozitimeve.

Në siperfaqe si rezultat i fazes rrudhosese postpliocenike verehen struktura antiklinale ne forme vargjesh. Duke filluar nga verilindja dallohet antiklinali i Golem - Kavajes.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Ne perendim te antiklinalit te Golem-Kavajes ndodhet sinklinali i Myzeqese i cili eshte nje rrudhosje me dimensione te konsiderueshme, duke filluar nga Mallakastër deri ne gjirin e Lalsit ne veri e akoma me tej ne ujrat e detit Adriatik. Ky sinklinal ne siperfaqe mbulohet nga depozitimet e Kuaternarit nen te cilat vazhdojne ato te Pliocenit dhe Miocenit të siperm.

Ne perendim te sinklinalit te Myzeqese ndodhet vargu antiklinal Ardenic-Divjake Kryevidh.

Ky varg perfaqesohet nga struktura relativisht te qeta, me krah perëndimor më të pjerret se krahu lindor.

Depozitimet e krahut lindor bien nga lindja me kënde 20-25°, kurse ato te krahut perendimor nga perendimi me kende 25-30°.

Sektori perendimor: - Perfshin kryesisht zonen detare, pra pjesen më perendimore të Ultesires, ku *molasat* mbivendosen mbi zonen tektonike te Sazanit.

Pergjithesisht strukturat jane me krah simetrik me renie te depozitimeve 1020°.

Strukturat ne pjesen jugore (Himare) paraqiten ne forme monoklinale e me ne veri ne forme hundesh strukturore e antiklinale te mirefillte. Keto struktura jane pergjithesisht te qeta te krijuara si rezultat i fazes postpliocenike e cila me sa duket ka patur ndikim te vogel.

Depozitimet neogjenike sipas edhe te dhenave të puseve të shpuar në det, duke filluar nga perendimi ne drejtim te lindjes vendosen shkalle-shkalle transgresivisht mbi gelqerorët e Krete-Paleogjenit nga ato me te rejat Messiniani deri në Burdigalian si me te vjetra, duke kaluar gradualisht drejt lindjes në prerje suksesive, poshte Ardenice-Divjakes, ku me sa duket ajo unifikohet me zonen e Adriatikut jugor.

Sizmiciteti

Zona jone e studimit, bazuar ne harten e Rajonizimit Sizmik te Republikes Shqiperise, karakterizohet nga lekundje sizmike prej 8 ballesh.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

III. Pershkrimi i projektit

Objekti **" Punime per rehabilitimin e diges se rezervuarit Bove, Roshnik",** Bashkia Berat**,** përbehet nga disa nënobjekte, si me poshte:

Diga (trupi i diges) së Rezervuarit; shkarkuesi katasrofik; ujlëshuesi, puseta e hyrjes dhe daljes së ujlshuesit, rruga e aksesit per në digë : **(***Shih në vijim një përshkrim më të detjuar per këto nënobjekte)*

a. Pershkrimi i gjendjes se objektit dhe nenobjekteve të tij

Rezervuari i Bovës: Është projektuar për një kapacitet ujëmbajtës rreth 350 mije m3 ujë me aftësi ujitëse prej rreth se 120 ha, por aktualisht kapaciteti ujëmbajtës i tij është reduktuar disi për shkak të mbushjes qoftë edhe të pjesëshme të kupës së rezervuarit nga aluvionet .

Rezervuari ka vetëm një digë me gjatësi të digës rreth 230 m, dhe gjerësi të kurorës prej rreth 5 m.

Sipërfaqja e rezervuarit në kuotën e nivelit normal të ujit është rreth 6.7 ha.

Përgjatë kurorës së digës duken gjurmë rrotash, çka tregon se ajo (kurora e digës) shërben edhe si rrugë për komunitetin e zonës, megjithëse akualisht kurora e digës nuk është aspak e shtruar as me çakell e as me ndonje material tjetër.

Diga është e tipit homogjene me mbushje e ngjeshje me material argjilore të gërmuara kryesisht në karrierat në bjefin e sipërm të kupës së rezervuarit .

Mbushja me ujë e rezervuarit realizohet nga vetë pellgu i tij shimbledhës direkt i rezervuarit.

Shkarkimi i ujrave të tepërta nga rezervuari i Bovës është parashikuar dhe bëhet nga një shkarkues katastrofik i tipit "i lirë" me një prag betoni që ndodhet në krahun e majtë të kurorës së digës.

Ky shkarkues duket se ka qënë i veshur me beton, por aktualisht në segmente të caktuara ka mjaft dëmtime të ndryshme të koritës (seksionit terthor) së këtij shkarkuesi, sa mund të gjykohet se është komplet i dëmtuar përgjatë gjithë gjatësisë së tij.

Kurse ujëlëshuesi është i tipit klasik me "tub çeliku" ndoshta me diameter Fi 400-500 mm me një sistem komandimi nga ana e jashtme e rezervuarit, ku duket se ka dy saraçineska por që nuk punojnë mirë.

Aktualisht ujëlëshuesi në dalje duket se është pjesërisht i bllokuar.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

b. Pershkrimi i nderhyrjeve sipas projektit te miratuar

Nga sa u përshkrua më lartë dhe, siç duket edhe nga fotot në vijim, mund te thuhet se :Nderhyrja ne ketè veper per studimin, vleresimin dhe percaktimin e masave te mundshme qe mund dhe duhet te merren per menjanimin, sa me shume te jete e mundur te demeve qe mund te shkaktohen nga kjo vepër, eshte plotesisht e justifikuar.

Bazuar ne te dhenat e siguruara dhe studimet e mesiperme projekti e ka trajtuar rehabilitimin e kesaj dige e veprave anekse te saj si me poshte :

Ndërhyrjet e propozuara

- Ndërhyrjet e propozuara ne digë e në kurorën e digës.

Në kohën e rilevimit (Qershor 2026), vija e nivelit të ujit në bjefin e sipërm, duket qartë që është në një vijë relativisht e pastër, pothuajse ne vije te drejte me vetë kurorën e digës. Ajo është pothuajse e njëtrajtshme dhe nuk duket të ketë indikacione apo shenja për deformime të skarpatës apo prishje të stabilitetit të saj, qoftë edhe në segmente të veçanta.

Kurora e digës duket se është relativisht e sheshtë me një gjerësi thuajse uniforme e që varion ndërmjet 4.5–5 m. Sidoqoftë, për shkak të gjatësisë relativisht të madhe të digës, prej rreth 230 metrash, nivelacioni në drejtimin gjatësor të kurorës nuk vihet re lehtësisht, por, po të vrojtohet me kujdes, dhe në raport me nivelin e ujit (më qartë nga matjet topografike) vihet re se nivelacioni i kreshtës në drejtimin gjatësor (përgjatë kurorës) ka një valëzim të lehte sidomos në pjesën ne krahun e majtë ku ulja është diçka e dukshme dhe arrini edhe në më shumë se 20 ÷ 30 cm..

Si ndërhyrje të propozuara në kurorën e digës përmenden fillimisht punime skarifikimi dhe gërmimi, përgjithësisht në anët më të ngritura (më afër mbështetjeve) dhe shumë pak mbushje në zonën më të ulët. Nuk është propozuar një mbushje me lartësi të madhe dhe kalimi i mjeteve të rënda për të realizuar ngjeshjen nuk do të lejohet.

Për të shmangur efektin negativ të mungesës së frankos së lejueshme, të vlerësuar nga llogaritjet e mësipërme, pas nje nivelimi të lehtë , përfshi edhe përmirësimin e shtresave rrugore, projekti e ka zgjidhur problemin e krijimit të frankos së nevojshme per prurjen me 0.1 % siguri.

Nëpërmjet vendosjes të një parapeti betoni, në krejt kuroren e diges në një gjatësi prej afro 190 metrash dhe lartësi 1.2 m , pra deri në kuotën 255.60 m.

Funksioni primar i këtij parapeti është pengimi i kapërcimit të dallgëve të rezervuarit, nëse niveli i digës është maksimal.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Ndërhyrjet e propozuara në skarpata dhe drenazhime

Skarpata e bjefit të sipërm,

Pjerrësia mesatare në këtë skarpatë është 1:2.75 – 1:3.

Skarpata është e veshur me gurë në formë kalldrëmi dhe është në përgjithësi në gjendje të mirë, por me dëmtime të vogla të pjesshme e të lokalizuara, të cilat duhen dhe janë parashikuar për tu riparuar.

Prerja e vegjetacionit sidomos , ne ketë skarpate (të sipërme) bie në sy nje numur i madh pemesh te cilat pa tjetër duhen prerë.

Skarpata e bjefit të poshtëm :

Eshtë dukshëm e veshur me vegjetacion. Nuk vihen re cedime apo rrëshqitje. Më së shumti ka një errozion të dukshëm sipërfaqësor për shkak të efekteve atmosferike ndër vite. Për skarpatën është propozuar pastrimi nga vegjetacioni i mesëm dhe i lartë dhe një skarifikim i kombinuar me mbushje. Skarifikimi do të realizohet shkallë-shkallë.

Duke fillua nga gjysmë lartësia e digës në skarpatën e poshteme e deri në fund të bjefit të poshtëm, në një gjerësi prej rreth 30-40 ml, vihet re një lagështi relativisht e madhe shpesh edehe me ujra të dukshme.

Pjesërisht, sipas shfrytëzuesve të veprës, kjo lagështi ka qenë edhe më përpara por jo kaq e dukshme, për sa kohë që ka funksionuar sistemi i drenazheve.

Natyrshëm që me kalimin e viteve drenazhet janë bllokuar. Riparimi i tyre në pozicionet ku ata kanë qënë, është praktikisht i pamunduar , pranadj :

Eshtë vlerësuar e nevojshme që për të përmirësuar gjendjen e për të rritur disi qendrueshmërinë e digës duhet një drenazh i konsiderueshëm, në formën e një kontrabankine pjesërisht me gurë kave, e më tej një berme, me një material çakëllor, me një granulometri të paracaktuar e të shoqeruar edhe me një veshje me gjeotekstil. Gjithashtu, në zonën më fundore do të realizohen drenazhet e reja, të cilat do të jenë kanale prej zhavorri.

IV.- Te dhena per mjedisin ekzistues

Problemet kryesore mjedisore, qe potencialisht mund te lindin gjate funksionimit te kësaj vepre do te jene:

1.- Prodhimi i pluhurave

Gjate punes per ndertimin e ketij objekti krijohen pluhura te ndryshem, por sasia e tyre eshte e pa perfilleshme.

2.- Krijimi i zhurmave

Si rezultat i perdorimit te paisjeve te sherbimeve, krijohen zhurma te ndryshme.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

3.- Krijimi i mbeturinave nga sherbimet

Gjate proceseve te ndryshme te sherbimeve krijohen mbeturina te karaktereve te ndryshme.

V.- Ndikimi i mundeshem ne mjedis dhe masat e propozuara per parandalimin dhe zbutjen e tyre

Duke patur parasysh shtrirje jo të mëdha të territorit në gjëndjen aktuale, mendohet se kompensimet dhe ndikimet e tjera pozitive, si punësimet, përmirësimet në infrastrukturë marrin një rëndësi të veçantë për komunitetin e rajonit. Këto ndikime nxisin edhe komunitetin për mbështetjen e investimeve.

Avantazhet dhe dobësitë e infrastrukturës aktuale të mjedisit të rajonit

AVANTAZHET	**DOBËSITË**
Vendndodhja -Vendndodhja në dhe pranë një rezervati natyror. -Ka potencial për zgjerimin e aktiviteteve të shlodhjes; **Administrimi i tokës dhe planifikimi i shfrytëzimit të saj;** -Kërkesa e lartë për ndërtime të mëtejshme; -Kapaciteti rregullator, relativisht i fortë i rajonit në lidhje me mbrojtjen e hapësirave të gjelbërta; **Pronësia dhe regjistrimi i tokës** -Konflikte të zgjidhura lidhur me të drejtat e pronësisë -Përqindja e lartë e pronës private, si bazë për motivim dhe zhvillim; - Prezencë e tokave publike -Prezencë objekteve publike	**Administrimi dhe planifikimi i shfrytëzimit të tokës :** -Shtrirja e paplanifikuar urbane; -Në aktivitetet ndërtimore nuk merren në konsideratë zonat e rreziqeve gjeologjike, tektonike e sizmike; -Kushtet e këqija të jetesës, për shkak të kanaleve të pamjaftueshme kulluese. - Humbja e tokave bujqësore, për shkak të aktiviteteve ndërtimore të pakontrolluara - Cilësia e dobët e planifikimit të shfrytëzimit të tokës; -Kapaciteti planifikues dhe zhvillues i rajonit i pamjaftueshëm; - Aktivitete të pa organizuara ndërtimore, si pasojë e zhvillimit spontan të tregëtisë; -Instrumenta të dobët për planifikimin dhe zbatimin e planeve; -Kapaciteti rregullator i ulët i shtetit; -Tokat janë të pakëta për zhvillimin e

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

	industrive të teknologjive të avancuara; - Nuk ka koordinim për zhvillim rajonal. **Pronësia dhe regjistrim i tokës:** -Pronësia private si pengesë për administrimin e mirë të tokës

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Avantazhet dhe dobësitë në lidhje me infrastrukturën teknike bashkiake

AVANTAZHET	DOBËSITË
Furnizimi me ujë: -Aktivitete të realizuar në shtrirjen e sistemit të furnizimit me ujë - Personel i kualifikuar relativisht mirë -Kapacitetet kërkimore në fushën e hidrogjeologjisë; **Sistemi i ujërave të zeza:** -Njohuri teknike në trajtimin e ujërave të zeza; -Kapaciteti kërkimor në fushën e trajtimit të ujërave të zeza. **Administrimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta** - Njohuri në trajtimin e mbetjeve urbane; - Kapaciteti kërkimor në fushën e trajtimit; **Furnizimi me energji elektrike:** - Konceptimi i furnizimit me energji elektrike	**Furnizimi me ujë:** - Burime të mjaftueshme sipërfaqësore dhe nëntokësore ujore; -Furnizim i pamjaftueshëm me ujë, gjatë periudhave të thatësirës, me pasoja negative për biznesin, bujqësinë, turizmin dhe jetën private; -Humbje të mëdha të ujit të pijshëm, për shkak të rrjedhjeve masive në sistemin e tubacioneve dhe ndërhyrjeve të paligjshme (humbjet mesatare arrijnë në masën 45%); -Shpërdorimi i ujit të pijshëm, për shkak të çmimit të pa përshtatshëm (që bazohet te numri i krerëve për familje dhe jo në konsumin aktual); -Administrimi jo efektiv i ujërave; **Sistemi i ujërave të zeza:** - Mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, dhe si pasojë derdhja e ujërave të ndotur në kanalet kullues.
	Administrimi dhe trajtimi i mbeturinave të ngurta: - Në gjithë zonën nuk ka një grumbullim e trajtim të rregullt të mbeturinave; - Mostrajtimi ekologjik i mbetjeve; **Furnizimi me energji elektrike** - Paqëndrueshmëri në furnizim me energji

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

bazohet në vlerësimin e kërkesave të së ardhmes; - Agjensitë financuese respektojnë këtë koncept dhe nxisin zbatimin e tij; -Rinovimi i rrjetit energjitik e sistemi i furnizimit sipas standarteve Europiane; **Telekomunikacioni** - Prezenca e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme dhe fikse me kompani private;	-Rrjete të vjetër dhe administrim jo efektiv sistemit të furnizimit me energji; - Çmime të papërshtatshme për energjinë; - Nuk ka tradita në përdorim të energjisë diellore -Nuk ka tradita në përdorim të energjisë së erërave -Nuk ka tradita në përdorim të energjisë ujore **Telekomunikacioni** - Mbulimi i pa mjaftueshëm i fshatrave; - Nuk ka sisteme të mjaftueshëm të parandalimit të zjarreve;

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Avantazhet dhe dobësitë në lidhje me kushtet natyrore dhe mjedisin

AVANTAZHET	DOBËSITË
• Plani kombëtar i Veprimit për Mjedisin; • Disponueshmëria e burimeve ujore (rezervuarëve); • Tokat pjellore; • Kushte të favorshme klimatike; • Pejsazh interesant; Cilësia e ajrit shumë e mirë; • Zbatim të Projekteve kombëtare për rehabilitimin e veprave kulluese; • Zbatim të Projektit të	• Ndërtimet e paligjshme; Niveli i lartë i ndotjes së ujit, për shkak të mos trajtimit të ujërave të zeza; • Ndotja, për shkak të mos trajtimit të mbeturinave urbane; • Teknologjitë dhe fabrikat e ndryshme janë kërcënuese për mejdisin; • Konflikti midis shkarkimit të hapur të ujërave të zeza dhe sistemit të kullimit;
kombëtare për kalimin e pyjeve ne pyje komunal; Shkalla e lartë e erozionit në kodrat me pjerësi, për shkak të degradimit të pyjeve.	• Zonat lumore nuk janë marrë në konsideratë gjatë zhvillimit të aktiviteteve; Mbeturinat e ngurta shkarkohen në vende të hapura dhe të shpërndara; • Plani Kombëtar i veprimit për Mjedisin nuk zbatohet;

Komponentët e ndjeshëm ndaj ndotjeve

Ndotja e ajrit

Pluhurat që dalin nga proçeset e ndërtimit, si dhe shkarkimi i gazrave të makinave janë burimet e mundëshme të ndotjes së ajrit, të cilat mund të rrisin përqëndrimin e materialeve të imta në të. Pjesa më e madhe e pajisjeve do të operojë në një ambjent të hapur, me një

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

dispersion të madh, për shkak të rrymave dhe erërave. Ndikimi në ndotjen e ajrit, pra mund të konsiderohet i lartë.

Standartet e cilësisë së ajrit dhe shkarkimet ndotëse në mjedis

Ndotësi	**Autoriteti**	**Vlerat mesatare të elementeve ndotës**					
SO2	**NOX**						
Vjetore	**24h MAX**	**Ditore**	**Vjetore**	**24h MAX**	**Ditore**	**Orare**	
BANKA BOTËROE	0.10	0.5 (jashtë)	1.0 (brënda)	0.05 ppm	-	0.05	-
SHBA	0.02ppmwaç 0,03ppmwbç	0.1ppmwaç 0.14 wbç 0.5ppm wacç	-	0.05 ppm	-	-	-
WHO	-	90µg/m3	-	-	-	-	190320 µg/m3

Ndotja e ajrit nga grimcat e ngurta

Rrugët ndihmëse të furnizimit me lëndë do të trajtohen vazhdimisht me ujë përpara se të kalojnë automjetet, duke evituar kështu gjenerimin e pluhurave.

Efektet e dëmshme të ajrit të ndotur

Elementet që gjenden në ajër ushtrojnë efekte negative në shëndetin e njeriut. Këto efekte manifestohen në forma të ndryshme, që fillojnë me shqetësime në frymëmarrje, vazhdojnë me sëmundje kronike profesionale dhe arrijnë deri në intoksikacione të rënda, madje deri në vdekje. Aktualisht, studiuesit ndjekin pikërisht këto efekte, që vijnë si pasojë e ekspozimit për një kohë të gjatë me substanca ndotëse të veçanta ose të

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

përziera. Organet e para që preken nga këto ndikime janë organet e frymëmarrjes. Ajri që thithet nga njeriu hyn në kontakt me gjakun dhe përhapet në gjithë trupin.

Efektet e dëmshme të gazeve

Veprimi i dëmshëm i gazeve ushtrohet kryesisht në rrugët e frymëmarrjes. Shpesh, ai vepron në kombinim me grimcat e ngurta. Gazet, në pjesën më të madhe të rasteve kanë veçoritë e tyre karakteristike, në mekanizmin e veprimit në organizëm.

Ndërmjet gazeve, që ndotin atmosferën mund të përmendim CO2, CO, SO2, SO3, H2S etj. Këto japin efekte të dëmshme në rrugët e sipërme të frymëmarrjes, për shkak të tretshmërise së tyre.

Gazet, që kanë në përbërje azotin ushtrojnë veprim toksik në rrugët e thella të frymëmarrjes.

Efektet pathollogjike të gazeve shfaqen në këto sëmundje:

- bronkiti kronik;
- azma bronkiale;
- sëmundje të aparatit të frymëmerrjes, etj.

Nga studimet e kryera mbi popullsinë e zonave të ndotura është vënë re rritje e sëmundshmërisë me kalimin e kohës.

Këtu mund të përmendim pneumoninë, bronkitin, tuberkulozin dhe sidomos, ato të rrugëve të sipërme të frymëmarjes, siç janë rihinite, faringite, otite etj.

Duke patur parasysh që ndotja e ajrit është prezente duhet të ndërmeren masa të ndryshne praktike për të ulur ndikimin negativ, që ato kanë në rrugët e frymëmarrjes.

Zhurmat dhe dridhjet

Zhurma nga aktivitetet e ndërtimit mund të jetë e rëndësishme për një periudhë të kufizuar kohe.

Nivelet e zhurmës të shkaktuara nga aktivitetet e ndërtimit mund të ndryshojnë shumë, në varësi të fazës së ndërtimit dhe detyrës specifike, që po kryhet.

Të gjitha pajisjet që lëshojnë zhurmë do të mirëmbahen ashtu siç duhet për të minimizuar ndikimin e zhurmës në rajon.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Pajisjet që lëshojnë zhurmë do të jenë sipas standarteve të BE rreth zhurmës së shkaktuar në mjedis.

Gjatë periudhës së ndërtimit, zhurma që do të gjenerohet do të jetë e neglizhueshme.

Burimet e vetme të mundshme do të jenë motorët e pompave, por ata do të vendosen në vendet të mbyllura dhe të izoluara.

Ne vijim paraqiten nivelet maksimale të zhurmës, që pranohet.

 E vazhdueshme 1.000m nga kompleksi 45dBA; E çastit 1.000m nga kompleksi 55dBA;

Niveli maksimal 1m nga pajisja 85dBA.

Ndotja e ujit

Derdhja e ujrave të larjes apo i mbeturinave të lubrifikanteve të motorrave, mund të krijojnë kushte për ndikime të tjera, objekt i të cilave të jetë uji nëntokësor.

Ndikimi i këtyre faktorëve është *”i vogël”,* duke marrë në konsideratë nivelin e pajisjeve të përfshira dhe standartet me të cilat duhet të punojnë këto tip pajisjesh.

Masat zbutëse

Masat zbutëse përfshijnë “*Praktikat më të Mira të Menaxhimit të Ndërtimit”,* të cilat do të jenë një nga këkesat bazë të specifikimeve të kontratës.

Mbeturinat

Gjatë periudhës së ndërtimit do të ketë dy burime mbeturinash: Materiali mbushjes për të realizuar infrastrukturën e parashikuar në tokë;

 Materiali i tepërt që do të rezultojë nga sheshimet apo nivelimet e ndryshme në zonën e shërbimeve.

Gjatë periudhës së funksionimit, problemi i prodhimit të mbeturinave do të jetë aq i rëndësishem sa në periudhën e ndërtimit, sepse do të prodhohen mbeturina nga vetë proçeset e punës.

Pritet një prodhim jo i vogël i mbeturinave nga aktiviteteve e shërbimit.

Pritet gjithashtu, prodhimi i një sasie të madhe edhe të mbeturinave personale të punëtorëve dhe personelit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Llojet, sasitë, data dhe mënyra e largimit të të gjithë mbeturinave të rëndësishme do të shënohet në një regjistër dhe për më tepër
puntorëve do tëu kërkohet të mbledhin veç fraksionet e ndryshme të mbeturinave.

Shqetësimet estetike

Ndikimet estetike që rezultojnë nga ndërtimi dhe materiali i gërmuar konsiderohen si të neglizhueshme.
Në zonat e ndërtimit në rajon, ka operacione, si ngarkimshkarkim, lëvizja e materialeve, operacionet e karburanteve, për të cilat nuk pritet të rezultojnë në ndonjë shqetësim të dukshëm estetik, vetëm se pritet të jenë të pranishme gjatë operacioneve ndërtimore.

Cënimi i interesave publike ose private

Cënimi i interesave publike apo private dhe interferenca në përdorimin publik nuk konsiderohet një ndikim domethënës i fuqishëm. Ndërtimet e propozuara do të kryhen me konsideratën e minimizimit të të gjitha cënimeve të interesave publike apo private.

Ndikimi në burimet arkeologjike dhe kulturore

Ndikimi në burimet kulturore dhe arkeologjike, që rrjedh nga operacionet e gërmimit dhe depozitimit nuk pritet që të ndodh.

Nuk ka vende arkeologjike dhe kulturore, qoftë në vendin e gërmimit, ashtu dhe në atë të depozitimit apo reklamimit të tokës.

Ndryshimet tokësore

Këto veprimtari përfshijnë përmirësimin e aksesit në sheshet e ndërtimit, përgatitjen e shesheve të ndërtimit, kullimin e shesheve, punimet e themeleve, largimin e mbeturinave, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve, udhëtimet e punëtorëve dhe veprimtari të tjera të nevojshme për t`u kryer.

Dukuritë që do të ndodhin gjatë ndërtimeve

Proçesi i ndërtimit do të jetë një nga zërat më voluminozë dhe me kohëzgjatje jo të madhe.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Është më se e natyrshme që gjatë kësaj periudhe do të ketë një sërë ndikimesh në mjedis, që mendojmë se është e udhës të merren në konsideratë.

Ndikimet në biodiversitet

Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitet nga dridhjet, pluhurat dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi siç është përcaktuar në uljen e niveleve të tyre për ajrin dhe ujin.
Përsa i përket humbjes së biomasës në territorin që do të shfrytëzohet,
do të merren masat si, gjelbërimi brenda territorit të sheshit te ndertimit per mbjeljen me bar të skarpatës së digës, gjë që do të rrisë sipërfaqet e gjelbëruara, e më tej garantohet ndikimi sa do i vogël i diellzimit te nevojshëm për nxitjen e zhvillimit të specieve të tjera spontane.
Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegjetacionit në zonat përreth.
Rritja e vegjetacionit autokton do të nxisë edhe afrimin e faunës së përshtatshme për këtë vegjetacion, çka përputhet me faunën autoktone të zonës.

Ndikimi njeriut në rajon

Nga çpyllëzimi, flora dhe fauna janë ekspozurar ndaj fenomenit me emrin njeri, duke vënë në kërcënim zhdukjen e habitateve të krijuara ndoshta 100-ra vjeçare.
Sensibilizimi i komunitetit për ruajtjen e florës dhe faunës nuk është në nivelet e dëshiruara dhe si rrjedhojë ndodhin fenomene që çojnë në prishjen e ekuilibrave mjedisorë.
Zona në vazhdimësi duhet trajtuar me kujdes, duke pasur parasysh edhe vlerësimet e bëra më lart dhe në përputhje të plotë me planet zhvillimore për një zhvillim të qëndrueshëm të saj.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Vlerësimi dhe identifikimi i ndikimeve negative e pozitive gjatë ushtrimit të aktiviteteve

Lloji i ndikimit në tokë	**Identifikimi i ndikimit**		
Gjatë ndërtimit	**Gjatë shfrytëzimit**		
Po	**Jo**	**Po**	**Jo**
Ndryshime topografike të terrenit	x	x	
Prishja e tokës bujqësore	x	x	
Ndotja e tokës nga rrjedhjet	x	x	
Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta	x	x	
Ndotja e tokës nga depozitimet e llumrave	x	x	
Lloji i ndikimit në cilësinë e ajrit	**Identifikimi i ndikimit**		
Gjatë ndërtimit	**Gjatë shfrytëzimit**		
Po	**Jo**	**Po**	**Jo**
Prodhimi i pluhurit	x	x	

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania

Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Lloji i ndikimit në florën dhe faunës	**Identifikimi i ndikimit**		
Gjatë ndërtimit	**Gjatë shfrytëzimit**		
Po	**Jo**	**Po**	**Jo**
Shkatërrimi i rëndësishëm i habitateve natyrore	x	x	
Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit	x	x	
Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë përmes zonës	x	x	
Përçarje apo izolim të habitateve të egra	x	x	
Interferencë midis rrugës natyrore të emigrimit të sisoneve	x	x	

"SELAS" sh.p.k

Projekt – Menaxhim - Konsulta

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania

Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Identifikimi i ndikimit

Lloji i ndikimit në ujë	**Gjatë ndërtimit**	**Gjatë shfrytëzimit**	
Po	**Jo**	**Po**	**Jo**
Trajtimi i ujrave të ndotur	x	x	
Ndotja e ujit prej pluhurit, plumbit, derdhjeve aksidentale dhe substancave të tjera	x	x	
Impakti sekondar në ndotjen e ujit për toka bujqësore, ujrat nëntokësore etj.	x	x	
Modifikim në drenazhimin e ujrave natyrore	x	x	
Ndotja e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore	x	x	
Lloji i ndikimit në ndotjen nga zhurmat	**Identifikimi i ndikimit**		
Gjatë ndërtimit	**Gjatë shfrytëzimit**	**Gjatë shfrytëzimit**	
Po	**Jo**	**Po**	**Jo**
Rritja e nivelit ekzistues të zhurmave	x	x	

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Rritja e nivelit të zhurmave nga aktivitetit, makinave	x	x	
Rritja e nivelit të zhurmave për njerëzit	x	x	
Niveli më i lartë i zhurmave për kafshët	x	x	

Lloji i ndikimit në përfitimin e tokës	**Identifikimi i ndikimit**		
Gjatë ndërtimit	**Gjatë shfrytëzimit**		
Po	**Jo**	**Po**	**Jo**
Shkatërrim banesash	x	x	
Ndryshime të rëndësishme në programet për të ardhmen e përdorimit të tokës	x	x	
Rivendosje banesash	x	x	
Shpronësime të tokës	x	x	

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Lloji i ndikimit për trashëgiminë kulturore	**Identifikimi i ndikimit**		
Gjatë ndërtimit	**Gjatë shfrytëzimit**		
Po	**Jo**	**Po**	**Jo**
Ndryshime apo dëmtime të zonave arkeologjike apo me vlerë historike e kulturore	x	x	

Lloji i ndikimit në energji	**Identifikimi i ndikimit**		
Gjatë ndërtimit	**Gjatë shfrytëzimit**		
Po	**Jo**	**Po**	**Jo**
Përdorim i sasive të mëdha të karburantit për energji	x	x	
Rritje të rëndësishme të kërkesave për burime ekzistuese të energjisë apo kërkesave për tipe të reja të energjisë	x	x	

"SELAS" sh.p.k

Projekt – Menaxhim - Konsulta

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania

Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Lloji i ndikimit në interesin publik (infrastruktura)	**Identifikimi i ndikimit**		
Gjatë ndërtimit	**Gjatë shfrytëzimit**		
Po	**Jo**	**Po**	**Jo**
Hapja e kompleksеve do të ketë apo jo nevojë për ndryshim në këtë fushë të interesit publik	x	x	
Energji elektrike	x	x	
Sistemin e komunikacionit	x	x	
Sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza e të bardha	x	x	
Sistemin e ujësjellësit	x	x	
Mbetjet e ngurta dhe depozitimi i tyre	x	x	

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Lloji i ndikimit në shëndetin publik	**Identifikimi i ndikimit**		
Gjatë ndërtimit	**Gjatë shfrytëzimit**		
Po	**Jo**	**Po**	**Jo**
Krijimi i çfarëdo rreziku apo mundësie për dëmtimin e shëndetit të njerëzve	x	x	
Krijimi i raportit të njerëzve me rreziqet e mundëshme për dëmtimin e shëndetit publik	x	x	

Lloji i ndikimit në qarkullim dhe transport	**Identifikimi i ndikimit**		
Gjatë ndërtimit	**Gjatë shfrytëzimit**		
Po	**Jo**	**Po**	**Jo**
Shtime të rëndësishme të qarkullimit të automjeteve	x	x	

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Pakësime të vendqëndrimeve të automjeteve apo nevoja për vendqendrime të reja	x	x	
Ndikime të rëndësishme në sistemin e komunikacionit	x	x	
Ndryshime në qarkullimin apo lëvizjen e njerëzve	x	x	

Plani i zbutjes së ndikimeve negative dhe rehabilitime te pergjitheshme

Mbrojtja e mjedisit është një detyrë që duhet të zgjidhet që në hartimin e projekt zbatimit të aktivitetit. Ky projekt në skemën e tij duhet të përmbajë elemente, që sigurojnë marrjen e masave në rast anomalie apo avarish, që mund të jenë deri në dëmtues të lëndës së parë apo rënie zjarri. Hartimi i projektit të cekët apo me mangësi, zbatimi i punimeve me cilësi të dobët që bëhen burim avarish, janë shkaqet që sjellin pasoja të rënda në mjedis.

Masat paraprake për zbutjen e rreziqeve

Për uljen e rrezikut të aksidentimit të banorëve nga mjetet e objekteve që do të ndërtohen në zonë, duhet të pajiset me tabela treguese të shpejtësisë së mjeteve deri në 20 km/orë.

Për evitimin e bllokimit të rrugës nga pamundësia e kalimit të dy mjeteve njëkohësisht në drejtime të kundërta, duhet të krijohen zgjerime në formë xhepash, në frekuenca të mundëshme dhe të aprovuara nga autoritetet.

Në rastet kur nuk është identifikuar asnjë masë zbutëse ose kur ndikimi nuk mund të zbutet siç duhet.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Ndikimet reziduale shqyrtohen për secilin aspekt mjedisor dhe për nivelin e tyre të identifikimit.

Ulja e intensitetit të ndotjeve

Ulja e intensitetit të ndotjes së ajrit

Më lart u argumentua se veprat urbane do të gjenerojnë ndotje të ajrit nëfazën e ndërtimit, por do të ketë ndërhyrje për minimizimin e saj.

Ulja e intensitetit të ndotjes së zhurmave:

Lëvizja e automjeteve e përqëndruar në një interval dite kohor janë një burim zhurme, por me kohëzgjatje të rendit të milisekondave.

Nivelet e zhurmës së krijuar nga lëvizja e automjeteve me llogari teorike mbërrijnë në fshat me vlera rreth 40-50 dB(a), por jo më të mëdha.

Në rastin e punëtorëve të këtij aktiviteti, kjo zhurmë i kalon kufijtë e lejueshme të ekspozimit profesional prej 65dB(a) për 8 orë ekspozim të vazhdueshëm

gjatë javës 40 orëshe të punës.

Lëvizja e shpejtë e makinave për uljen e ekspozimit ndaj zhurmave në njësi kohe nuk mund të realizohet, për shkak të rritjes së rriskut për aksidente dhe gjenerimit më të madh të pluhurave edhe në rast se rruga është e asfaltuar.

Pra, niveli i zhurmave të këtyre mjeteve në rrugën pranë saj llogaritet në vlerat 75-85dB(a).

Për shkak se në rrugën në fjalë edhe përpara projektit kalojnë automjete, zhurmat e krijuara nga automjetet për furnizim me mall nuk përbën një problem të ri për zonën, por gjithësesis duhet mbajztur në vëmëlndje për shkak se do të një rritje të intensitetit.

Ulja e ndikimit të ndotjes së ujërave sipërfaqësore

Ndotja e ujërave sipërfaqësore pritet të ndodh kryesisht nga shpëlarja e ambjentit

përreth, ku këto ujra do të derdhen në një kanal.

Për këtë, në se do të lind nevoja do të merren disa masa zbutëse për rehabilitimin e këtyre ujrave.

Në këto kanale do të maten nivelet e ndotësve prej vajrave, duke normalizuar në nivelet e ujërave industrial dhe në këtë moment ato derdhen pa problem në lume. Siç është përmendur më lart, gjatë proçesit të ndërtimit çlirohen gjithashtu tymra djegjes si; COV, NOX, CO, SOX, PM10.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Në tabelën e mëposhtme jepen pajisjet e ndërtimit të standarteve që do të përdoren si dhe sasitë e gazrave që këto pajisje potencialisht shkarkojnë në atmosferën, ku punojnë.
Është plotësisht e mundur të vlerësohet numri dhe tipi i pajisjeve, që do të përfshihen në praktike, duke u bazuar në publikime të ndryshme dhe në zgjatjen e periudhës së përdorimit.

Disa masa zbutëse për zvogëlimin e ndikimeve në reduktimin e çlirimeve të ndryshme gjatë fazës së ndërtimit

Këto çlirime dhe ndikimet e tyre mund të konsiderohen të neglizhueshme, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e kufizuar të fazës së ndërtimit (vetëm disa mujore) .

Të dhëna mbi çlirimin e gazeve nga makineritë e ndërtimit

Pajisja	**CO wgh-1ç**	**COV wgh-1ç**	**NOX wgh-1ç**	**Soxwgh-1 ç**	**Dust wgh-1ç**
Makinë shtrimi, Eskavatorë dhe buldozier me rrota gome, Ekskavatorë të vegjël me rrota	259.58	113.17	858.19	858.19	
Autobetoniere, Rul, Autovinç,	816.81	86.84	1889.1	206	116
Kamion, Traktor me rrota gome Autobot					

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Vinç, Grup gjeneratori, Kompresor ajri, Saldatriçe, Çekiç pilotash	306.37	69.35	767.3	64.7	63.2

Ulja e ndikimeve negative në biodiversitet

Për të zbutur humbjen e biomasës në territorin që do të shfrytëzohet, habitateve të fragmentizuara do të merren masat si më poshtë:

- Së pari do të bëhet mbjellja në zona me metodën e mulçirimit, që është e njohur nga punonjësit e shërbimit pyjor në rrethe.
- Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegjetacionit në zonat përreth.
- Pas mbjelljes, fidanët për një periudhë 2 vjeçare do të ruhen (mbrohen) nga Bashkia Berat, prej kullotjes.
- Rritja e vegjetacionit autokton do të nxisë edhe afrimin e faunës së përshtatshme për këtë vegjetacion, çka përputhet me faunën autoktone të zonës.

Ulja e intensitetit të erozionit dhe zbutja e ndryshimit të topografisë

Si masat zbutëse kundër erozionit të mundshëm të formuar në rrugët e hapura për komunikim me objektet që do të ndërtohen janë dy nivelet bazë, masa hidroteknike dhe biologjike duke realizuar:

- Mbajtjen e brezave me sipërfaqe, me gjelbërim të përhershëm jashtë dhe brenda objekteve dhe mbjelljen e pemëve halore të natyrës së mjedisit;

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Masa zbutëse	Frytshmëria
Realizimi sa më shpejt që të jetë e mundur i shtrimit të rrugëve të brendëshme	70%
Larja e rrugëve të pista dhe të shesheve të ekspozuara të ndërtimit gjatë stinës së thatë	60%
Ujitja e grumbujve të inerteve në mënyrë periodike	60%
Përdorimi i hinkave për shkarkimin e matrialeve	65%
Kufizimi i shpejtësisë së mjeteve të rënda	Sipas fazës

Masat zbutëse gjatë periudhës së ndërtimit

Masat për uljen dhe kontrollin e çlirimeve gjatë fazës së operimit janë përshkruar në tabelën e mëposhtme. Këto përfshijnë:

- Minimizimin e ngarkësës
- Përmbajtjen
- Rekuperimin apo Riciklimin
- Pakësimin e çlirimeve
- Trajtimin dhe largimin e mbeturinave.

Qarku i Fierit do të jetë përgjegjës drejtpërsëdrejti për shfrytëzimin korrekt të objektit sipas Legjislacionit Shqiptar dhe standarteve ndërkombëtare të sigurisë të listuara dhe do të mbajë përgjegjësinë për zbatimin e masave të përmbledhura në tabelat e mëposhtme.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Masat zbutëse gjatë periudhës së ndërtimit

Veprimtaria	Ndikimet e Mundëshme	Masat zbutëse
Menaxhimi i dherave të ndotura	Shqetësime të mundshme të shëndetit	Dheu i ndotur do të ruhet në mënyrë të sigurtë nën zonë të asfaltuar për të shmangur përhapjen e ndotësëve
Menaxhimi i mbeturinave industriale dhe inerte	Shqetësime të mundshme të shëndetit	Selektimi i mbeturinave urbane dhe pas largimi i tyre
Fuqia punëtore për veprim	Fluksi i puntorëve krijon trysni mbi banesat dhe trafikun	Fluksi i puntorëve do të jetë i ulët dhe pjesa dërrmuese e tyre do të jetojë në rajon
Furnizimi me ujë të pijshëm	Përkeqësim furnizimin me ujë të komunitetit	Përdorimi i ujit industrial nga burime të ndryshme nga ujësjellësi
Përfundimi i punimeve	Pamja estetike	Nivelim dhe gjelbërim i sipërfaqeve të lira të sheshit, si dhe të sheshit përqark

Masat zbutëse të ndikimeve në mjedis gjatë periudhës së funksionimit Përmbledhja e vlerësimeve të ndikimeve në mjedis gjatë shfrytëzimit

Parametri mjedisor	Burimi	Rëndësia e Përgjithshme
E(U)lët	**E(M)oderuar**	**E(L)artë**
Ndotja e ujit	Ujra potencialisht të ndotura nga rrjedhja	U

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

	e"shpërlarjes së parë"	
Cilësia e ajrit	Çlirimet VOC	U
Pluhurat	M	
Motorrat e pajisjeve	M	
Trafiku	Udhëtimet e kamioneve për	M
	ngarkimin e prodhimeve	
Mbeturinat e rrezikshme	Shkumrat e lagura nga impjanti ndarës naftë/ujë	U
Mbeturinat e ngurta	Gjatë operimit	U

Masat zbutëse gjatë periudhës së funksionimit

Aktiviteti	**Ndikimet e Mundshme**	**Masat zbutëse**
Lëvizjet e kamionave Për ngarkimin e prodhimeve	Trafiku Çlirimet e tymrave dhe blozës së djegieve	Parashikimi i një grafiku lëvizjesh në orët e qarkullimit të pakët(natën mundësisht)
Parashikimi i një grafiku lëvizjesh në orët e qarkullimit të pakët(natën mundësisht)		
Derdhje të rastit	Ndotja e mundëshme e ujit	Shtrimi me beton i baseneve të ruajtjes do të lejojë mbledhjen efektive të rastit në pusetat përkatëse dhe trajtimi i tyre sipas normave të

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

		parashikuara në projekt. Uji i ndotur me vaj do të trajtohet para se të derdhet në mjedis.
Menaxhimi i mbeturinave të lëngshme	Ndotja e mundëshme e mjedisit	Mbetjet e lëngëta do të riciklohen ose po të jetë e nevojshme do të depozitohet dhe do të nënshtrohet periodikisht trajtimit të përhershëm para se të derdhet.
Menaxhimi i mbeturinave të ngurta	Ndotja e mundëshme e mjedisit	Tipet, sasitë, data dhe mënyra e largimit të të gjithë mbeturinave të rendësishme do të rregjistrohen dhe do të bëhen sipas tableës

Masat për uljen e efekteve negative

- Me karakter teknik;
- Me karakter organizativ;
- Kontrolli dhe monitorimi në kohë.

Ripërtëritja e mjedisit

Ndërtimi i strukturave do të behet duke mos cënuar bimësinë, që rritet aty dhe sipërfaqen e gjelbër. Për fat të mirë, në sektorët e propozuar, kulturat bujqësore të mbjella mungojnë plotësisht perveç ne aksin e tubacionit te dergimit. Në marrëveshje të plotë me pronarët përkatës, sipas një plani që do të përmendet paksa më poshtë, sipërfaqet përqark objekteve do të sistemohen, duke marrë masa për ta ruajtur dhe mbrojtur nga erozioni. Ky plan përfshin:

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

- Minimizimin e lëvizjes së dheut;
- Mbjelljen e barit dhe të pemëve mbi lartësinë e ndërtimeve në zonat, ku parashikohet erozioni;
- Ndalimin e dëmtimit të shkurreve, pemëve frutorë, pemëve pyje, aty pranë shesheve të ndërtimit;
- Ndalimin e dëmtimit të bimësise së ulët e të lartë;
- Rekuperimin e saj trefish, aty ku mund të ketë ndonjë ndërhyrje të detyruar, etj.

Restaurimi dhe rehabilitimi i ndikimeve ndaj mjedisit do të kryhet si një domosdoshmëri në kthimin e pasurive të vlerësuara në kushtet e mëparshme, sa më mirë që të jetë e mundur.

Kjo do të jetë e mundur, sepse vetë Operatori, si dhe studimi i linjës së bazë të ndikimeve në mjedis, që po paraqet, kanë identifikuar ndikimet potenciale dhe masat që duhet marrë për parandalimin, minimizimin dhe mënjanimin e ndikimit të tyre.

Mjedisi urban dhe shëndeti

Me gjithë përpjekjet për përmirësime,

- rrjeti i amortizuar shpërndarës i ujit të pijshëm, i cili nuk mbulon të gjithë zonën e banuar;
- mungesa e sistemit te kanalizimit te ujrave të zeza;
- shkarkimi i tyre ne gropa septike;
- mungesa e një administrimi të përshtatshëm të mbeturinave urbane dhe mbetjeve solide urbane në përgjithësi; siguria ushqimore e ulët; kanë premisa dhe mund të krijojnë (qoftë edhe rrallë) vatra të ndotura, që ndikojnë dhe rrezikojnë shëndetin e komunitetit.

Mbrojtja e mjedisit

Nga Bashkia duhet zhvilluar në harmoni me vlerat e natyrës, por që vitet e fundit janë dëmtuar disi.

Lumenjt e perrenjte e zonës, shpatet e kodrinave përbëjnë habitate potenciale për biodiversitetin e pasur që mbartin.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania

Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Problemet e vërejtura

- Mungesa e organeve përgjegjëse ligjore për hartimin e strategjive;
- Administrimi i mangët ligjor i territorit urban, (njohja e kthimi i pronave); Menaxhimi i mangët i mjedisit urban e i aktiviteteve të tjera për të mbështetur

zhvillimet që respektojnë mjedisin;

- Ndërgjegjësimi i pakët i komunitetit për mbrojtjen e mjedisit; Mungesa e rrjetit informativ e ndërgjegjësues për mjedisin.

Studimi e aplikimi i projektit të impiantit të trajtimit të ujrave të zeza

- Kryerja e një plan veprimi për eleminimin e shumë pikave të shkarkimit;
- Ndërtimi jo vetëm i një impianti trajtimi sipas studimit teknik, por të disa impianteve) në bazë zone apo sektori.

Përmirësimi i krejt sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm

- Krijimi i degëzimeve të reja për lagje të reja e rikonstruksioni i rrjetit të vjetër.
- Shërbime në depo, klorinimi i rregullt, rritja e numrit të pikave të marrjes së mostrave për analizë.
- Zgjidhja teknike për realizimin e klorinimit për degëzimin për lagjet e reja. Përcaktimi, ngritja e funksionimi efektiv i sistemit të largimit të mbeturinave urbane dhe hartimi i një plani veprimi e zbatimi i tij.
- Përcaktimi i pikave, kohës, frekuencës, llojit të automjetit për evadimin e mbeturinave dhe gjetja e vendit të përshtatshëm dhe burimeve financiare për këtë qëllim;
- Caktimi i ditëve për largimin e objekteve të ndryshme të vjetëruara nga banesat

të nxjerra si mbetje;

- Ndërgjegjësimi i komunitetit për mbajtjen pastër të zonës së Bashkise dhe aplikimi i gjobave.

Mbetjet urbane të Bashkise do të trajtohen integralisht, duke bërë një parcelë me formacion argjilor të caktuar ndarjen dhe përgatitjen si lëndë e parë për riciklimin, ripërdorimin dhe kompostimin.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania

Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Rehabilitimi i vatrave të ndotura nga shkarkimet e mbetjeve të ndryshme.

- Largimi i mbeturinave nga vatrat e ndotura;

Ky vend do të caktohet në një formacion përsëri argjilor së bashku me trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane

Zbatimi dhe mundësimi i teknologjive e aktiviteteve ricikluese të mbetjeve

- Mundësimi i riciklimit të qelqit, letrës, metaleve, etj;
- Përgatitja dhe zbatimi i një plan veprimi për këtë qëllim.

Mbrojtja e natyrës

Restaurimi dhe përmirësimi i habitatit dhe biodiversitetit

- Kryerja e studimit të gjeorreziqeve për zonën e "mbrojtur nga ndërtimet" dhe për zhvillimin e habitatit;
- Restaurimi me mbjellje dhe harmonizimi me objektet e tjera urbane;
- Përcaktimi i bimësisë dhe biodiversitetit që vendoset;
- Përgatitja dhe zhvillimi i planit të veprimit për këtë qëllim.

Përmirësimi i brezit të gjelbert me anë të masave sipas një plani veprimi.

- Përgatitja dhe zbatimi i një plan veprimi për ndalimin e kullotjes pa kriter
- Monitorimi i gjëndjes së pyjeve, inventarizimi dhe mbrojtja e tyre;
- Përcaktimi i zonave të gjelbërta, që nuk do të preken nga ndërtimet;
- Vënia në efiçencë e sistemit të gjobave.
- Plan veprimi për marrjen e masave për mbrojtjen nga rreziku nga rrjeti i amortizuar, kabinat e dëmtuara, ndërhyrjet e kundër ligjëshme, etj.
- Promovimi i sistemeve lehtësuese e nxitja e aktiviteteve që bëjnë furnizimin me gaz të lëngët çon në uljen e përdorimit të energjisë elektrike.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

VI.- Konkluzione dhe detyra

- Shtimi i siperfaqes se gjelbert ne hapsirat ndermjet objekteve eshte nje tjeter faktor ne mbrojtje te mjedisit.
- Materialet qe dalin si rezultat i punes ne objekt, te grumbullohen, transportohen dhe depozitohen ne vendin e caktuar dhe ne oraret e percaktuara nga Bashkia Berat.
- Transporti i mbeturinave te kryhet me automjete te mbuluara me mushama, me qellim qe te mos kete ndotje te rruges e te mjedisit me teresine e tij.
- Gjate veprimtarise ne objekt te mbahet nen kontroll ndotja e ajrit brenda nivelit 90 mikrogram/m3 per pluhurin total (LGS) dhe 50 mikrogram/m3 per pluhurin e frymemarrjes (PM10)
- Gjate proceseve te punes te merren te gjitha masat masat per minimizimin apo eliminimin e ndikimeve negative ne mjedis.

VII.- PERFUNDIME :

Perdorimi i elementeve te tille si :

- Minimizimi i pluhurave gjate punes.
- Pastrimi i vazhdueshem i makinerive dhe paisjeve gjate punes
- Shtimi i gjelberimit ne zone.
- Rehabilitimi i rrjeteve ekzistuese inxhinierike
- Te gjitha sa thame me siper jane nje sere faktoresh qe do te prodhonin nje ndikim te forte nga pikpamja e permiresimit te parametrave mjedisore urbane. Mund te themi se investimi qe do te kryhet nuk do te kete efekte negative te rendesishme ne mjedis, duke qene se eshte nje aktivitet qe nuk krijon premisa per ndotjen e mjedisit apo te sjelle pasoja negative ne mjedis.
- Perfundimi me i rendesishem eshte se ndertimi nuk ka ndikim te rendesishem negativ ne mjedis.
- Rrjeti i kanalizimeve te ujrave te bardha do te ndertohet ne perputhje me kriteret mjedisore, duke respektuar kuadrin ligjor ekzistues.
- Gjate aktivitetit të saj dhe nuk do te shkaktoje ndotje të tokes.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

- Me marrjen e masave ne favor te mbrojtjes se mjedisit edhe ato pak elemente, qe mund te kene nje ndikim te vogel ne mjedis dhe qe jane permendur me lart do te kapercehen.
- Aktiviteti ne kete objekt do te kete efektet e tij pozitive ne te gjitha drejtimet dhe sidomos ekonomike.
- Aktiviteti do te paraqese nje ndikim minimal ne mjedis dhe me zbatimin e masave parandaluese, keto ndikime do te jene pothuajse fare te vogla.

Si perfundim mund te themi se efektet e rehabilitimit të objektit : **"Punime Rehabilitimi per Mirembajtjen e Diges te Rezervuarit Bove, Roshnik"** do te jene pozitive duke patur parasysh edhe kriteret e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

PERGATITI:
"SELAS" sh.p.k
Ing. Vladimir Agalliu

“SELAS” sh.p.k

Projekt – Menaxhim - Konsulta

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

SHENIME DHE SPECIFIKIME TEKNIKE:

“ PUNIME REHABILITIMI PER MIREMBAJTJEN E DIGES TE REZERVUARIT BOVE, ROSHNIK”

BASHKIA BERAT

TIRANE, 2026

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

SHENIME DHE SPECIFIKIME TEKNIKE

TE PERGJITHSHME

Specifikimet e meposhtme jane specifikime teknike te pergjithshem, zbatimi i te cilave eshte kusht per realizimin e projektit dhe kontrates se punimeve.

Keto shenime teknike jane pjese perberese e projektit dhe do te lexohen se bashku me fletet e tjera te projektit si edhe me analizat e çmimeve dhe specifikimet e tjera teknike .

Specifikimet teknike te meposhtme plotesojne shenimet teknike te projektit
Në qofte se në projektet e zbatimit jane vene shenime te ndryshme nga projektuesi lidhur me kushtet teknike apo teknologjine qe duhet zbatuar per ndertimin e vepres, keto shenime teknike (ne projekte e preventiva) marrin perparesi ndaj specifikimeve te pergjithshme dhe duhen zbatuar me rigorozitet nga Kontraktori.

- Disa te dhena te pergjitheshme per objekti

Studimi dhe hartimi i projektit për objektin: "Punime Rehabilitimi per Digën e Rezervuarit Bovë, Roshnik", hartohet me kërkesë të drejtuesëve të Pushtetit Vendor, Bashkia Berat, në kuadrin e punimeve për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e kësaj vepre, si një vepër e rëndësishme për ekonominë e zonës e në mënyrë të veçantë për gjithë komunitetin e banorëve të fshatrave Roshnik etj, që për një periudhë gati 50 vjeçare e shfrytëzojnë këtë vepër.

Diga e Bovës është një digë dheu homogjene, e cila formon një rezervuar që shërben për vaditjen fushave të mbjella pranë fshatit Roshnik, Bashkia Berat.

Diga e Bovës ndodhet rreth 300-400 metër larg fshatit Roshnik, mbi luginën e sipërme të përroit të Vodicës.

Pozicioni i digës është nën fshatit Roshnik në koordinatat: gjerësi gjeografike 40º 73'33" dhe gjatësi gjeografike 20º 03'33".

Projekti eshte hartuar duke u bazuar ne matjet dhe azhornimet topografike te kryera ne periudhen: Qershor - Korrik 2026.

Ne projekt eshte punuar me kuota (perafersisht) absolute duke ju referuar kuotave te disa pikave fikse qe u vendosen ne terren nepermjet aparateve GPS. Keto pika jane percaktuar qarte me kuote e koordinata ne flete te veçanta te projektit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Por, sidoqofte per orientimin e sakte dhe lidhjen e objektit me keto kuota, eshte e nevojshme qe ne cdo rast para fillimit te punimeve nga ana e firmes ndertuese duhet te behen azhornimet topografike per vleresimin e projektit ne pershtatje me kushtet e faktike te krijuara deri ne periudhen kur fillon kryerja e punimeve.

Ne rast mosperputhje, eshte e detyrueshme qe nga ana e firmes ndertuese dhe supervizioni te behen reklamimet e nevojshme per saktesimin e kuotave baze per referime te metejshme.

Paraprakisht duhet thene se si pjese e ketij raporti duhet te jene te gjitha shenimet teknike si dhe te gjitha vleresimet dhe rekomandimet qe jepen per ndertimin dhe shfrytezimin e kesaj vepre, **në** Projekt apo në Relacionin e posaçem teknik te kesaj vepre, ku krahas te tjerash jane dhene disa rekomandime e sugjerime ne lidhje me oraginzimin e zbatimin e punimeve.

DISPOZITAT PARAPRAKE

- **Studimi i kushteve para ndërtimit**

Kontraktori duhet të kryejë studime të kushteve para ndërtimit, por pa u kufizuar, si: në rrugët për shërbimet/telekomunikimet dhe zonat e banuara që ndikohen nga punimet etj.

Për objektin e studimeve te kushteve konkrete para ndertimit, duhet rënë dakord me Supervizorin para se të fillojnë punimet në terren. Konstatimet e këtyre studimeve shënohen me shkrim si nga Supervizori ashtu edhe nga Punëdhënësi para fillimit të punimeve në terren.

- **Aksesi në Terren**

Kontraktuesi është përgjegjës i vetëm për të gjitha transportet e tij dhe nevojat e transportit në Terren. Kontraktuesi duhet të ketë mbledhur të gjitha informacionet e nevojshme për të bërë vlerësimin e tij të kushteve dhe kapaciteteve të rrugëve dhe urave, si dhe është përgjegjës për çdo rehabilitim ose përforcim të nevojshëm për kërkesat e tij.

- **Rrugët Lokale**

Kontraktuesi është përgjegjës për të siguruar se trafiku në terren dhe veprimtaritë e tij nuk i demtojne apo ti bëjnë rrugët lokale të papërdorshme nga banorët lokalë gjatë ndërtimit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Kontraktuesi duhet të riparojë të gjitha rrugët ose zonat e ndikuara , menjehere pasi merr njoftimin per shqetesimin apo për dëmtimin.

- **Shërbimet e Kontraktorit në Terren**

Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për të gjitha shërbimet shtesë që mendohen të nevojshme për plotësimin e punimeve të tij të cilat përfshijnë por pa u kufizuar si: furnizimin me energji, telekomunikimin, furnizimin me ujë dhe menaxhimin e materialeve apo mbetjeve të tjera te ngurta.

Kontraktuesi duhet tëi lejojë dhe ti krijoje akses punëdhënësit dhe Supervizorit per përdorimin e arsyeshëm të shërbimeve në lidhje me Punimet gjatë progresit të tyre.

- **Siguria ne pune**

Kontraktuesi duhet të përcaktojë kërkesat e përgjithshme të sigurisë për Punimet për miratim nga Punëdhënësi dhe Supervizori dhe të veprojë në përputhje me këto kërkesa si dhe është përgjegjës për këto veprime të personelit të tij në lidhje me kërkesa të tilla.

Kontraktuesi është përgjegjës për sigurinë e Punimeve, të cilat përfshijnë objektet dhe nënobjektet përkatëse si dhe siguron dhe ruan vazhdimisht forcën e duhur të sigurisë për të përmbushur këto detyrime.

- **Ditari i Punimeve**

Kontraktuesi duhet të mbajnë një Ditar Punimesh (Ditari i Punimeve) në të cilin shënohen detajet e plota të të gjitha punimeve që kryhen çdo ditë.

Ditari i punimeve duhet të jetë në dispozicion për kontroll nga punëdhënësi e supervizori në çdo moment gjatë realizimit të punës.

Ditari i punimeve duhet të përmbajë minimalisht detajet në vijim:

- Vendin e punimeve të ndryshme të ndërmarra;
- tipin dhe sasinë e punëve të kryera;
- dërgesat dhe faturat bashkangjitur dërgesave si dhe certifikatat e testit të furnizuesve
- numrin e punonjësve ;

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

- makinerite e perdorura
- testet e kryera dhe rezultatet;
- kushtet e motit;
- kontrollet e kryera nga Supervizori dhe Punëdhënësi; dhe
- vizitorët.

Raporti i progresit duhet të përpilohet të paktën një herë në javë duke përdorur edhe fotografi dixhitale.

Ky raport vihet në dispozicion të Supervizorit dhe Punëdhënësit.

- Kontrolli i ujit gjatë ndërtimit

Plani për kontrollin e prezences se ujit ne vendin e punes

Metoda e planifikuar e kontraktuesit për devijimin e ujerave gjatë zbatimit të Punimeve duhet të jetë në përputhje me propozimet e miratuara qe jane paraqitur nga Kontraktuesi në Tenderin e tij.

Pamvaresisht nga perputhja apo mos perputhja e paraqitur , kontraktori nuk mund te shmanget, nga përgjegjësia e tij e plotë për devijimin e ujerave dhe kryerjen e punimeve te tjera mbrojtëse.

REALIZIMI I PUNIMEVE

- **Të përgjithshme**

Kontraktuesi duhet të planifikojë, projektojë, ndërtojë dhe ruajë të gjitha punimet devijuese dhe mbrojtese të nevojshme për parandalimin e rrjedhjes së ujit nga objekti, sistemit të kullimit siperfaqesor dhe qe hyjnë në pjesë të ndryshme të Punimeve.

Devijimi dhe punimet mbrojtëse mund të përbëjnë, por pa u kufizuar domosdoshmërisht, një shumëllojshmëri të pritave kaperderdhese, kanaleve, tubacioneve, tombinove, pompave, ulluqeve të shkarkimit, kanaleve kulluese dhe baseneve të dekantimit.

Vendndodhja e këtyre punimeve duhet të jetë e tillë që të mos ketë dëmtime në asnjë zonë të nevojshme për ndërtimin e Punimeve.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Me përfundimin e punimeve, të gjitha punimet mbrojtëse hiqen dhe asgjësohen ose sistemohen në përputhje me zonën përreth siç është rënë dakord me Supervizorin.

Asnjë material mbushës nuk lihet në zonën e objektit ose në vende ku mund të ndikojë në ndonjë mënyrë në funksionimin ose nxjerrjen jashte perdorimi te Punimeve.

Materialet mbushëse të tepërta transportohen dhe hiqen nga terreni.

- **Përgjegjësia për Punimet**

Kontraktuesi mban përgjegjësi të plotë për çdo dëmtim ose vonesë të Punimeve të shkaktuara nga dëmtimi i devijuesit dhe punimeve mbrojtëse dhe/ose pajisjeve të kullimit të ndërtuara prej tij dhe siguron Punëdhënësin kundrejt pretendimeve të zotëruesve të tokave ose personave apo kompanive të tjera, që rrjedhin nga një dëmtim i tillë.

Kontraktuesi është përgjegjës dhe duhet të riparojë ose rikuperojë me shpenzimet e tij, çdo dëmtim të themeleve te veprave ekzistuese, skarpateve të gërryera apo çdo pjese tjetër të Punimeve që mund te shkaktohen gjate kryerjes te parashikuara si dhe punimeve suplementare devijuese apo mbrojtëse si dhe/ose pajisjeve të kullimit.

- **Materialet, Kantieri dhe Oficina**

Oficina, materialet dhe Kantjeri që përfshihen në Punimet e Përhershme, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, duhet të jenë në përputhje me botimet më të fundit të Standardeve dhe Kodeve të aprovuara te Praktikës si dhe të kryhen në përputhje me planin e Kontraktorit për Sigurimin e Cilësisë.

- **Punetoret dhe Asistenca e Përgjithshme**

Kontraktuesi duhet të sigurojë punëtore me qëllim që të ndihmojë Supervizorin dhe Punëdhënësin në operimet e tyre lidhur me mbikëqyrjen e Punimeve.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

- **PUNIMET MATËSE**

- **Objekti**

Në terren janë bërë matjet topografike dhe janë përcaktuar pikat e përkohshme të referimit për të hartuar vizatimet dhe projektin e punimeve.

Kontraktuesi është përgjegjës që me shpenzimet e tij të verifikojë, konfirmojë ose në të kundërt të ndryshojë të dhënat që jepen në dokumentet në dispozicion, megjithate ai është përgjegjës për zbatimin e këtyre të dhënave.

- **Pikat e Përkohshme të Matjeve dhe Referimeve**

Të gjitha pikat e pandryshueshme, pikat e referimit dhe pikat e matjes të vendosura nga Kontraktuesi, pas vleresimit dhe konfirmimit nga supervizori te perpuethmerise se tyre me ato te projektit, duhet të sigurohen nga kontraktori në mënyrë të qëndrueshme në pozicionet e tyre të pandryshueshme, të mbrojtura mirë dhe të shënuara qartë.

Kontraktuesi duhet të ruajë të gjitha këto pika dhe shenja për matjen e pozicioneve nga ana e Punëdhënësit.

Për këto qëllime, në çdo kohë, pa pagesë shtesë dhe me kërkesën e Punëdhënësit, Kontraktori duhet:

- të tregojë pikat e mbuluara të matjeve;
- të zhvendosë makineritë dhe pajisjet jashtë vijës së nevojshme të shikimit;
- të ndalojë punimet e ndërtimit, shpimet, furnizimin dhe funksionimin e makinerive;
- të kufizojë ose ndalojë lëvizjen e personave ose mjeteve pranë instrumenteve apo brenda vijës së shikimit;
- të sigurojë materialet, veglat, piketat, shënjuesit dhe numrin e duhur të asistentëve nën drejtimin e Punëdhënësit;
- të pastrojë shkurret, të heqë pengesat dhe të nivelojë terrenin në masën e duhur për matjet ndihmëse të Punëdhënësit; dhe
- të ri-vendosë pikat e humbura të matjeve të cilat janë ende të nevojshme.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

- **SIGURIMI TEKNIK DHE MJEDISI**

- **Sigurimi Teknik**

- Kontraktuesi duhet të respektojë standardet e larta të sigurisë për njerëzit dhe makineritë si dhe të sigurojë respektimin e duhur të pikave në vijim:
- Kontraktuesi duhet të marrë masat e duhura paraprake kur është e nevojshme që personeli të punojë në zona të mbyllura dhe zona të tjera të rrezikshme, dhe duhet të lejojë që punonjësit të punojnë në zona të mbyllura ose zona të tjera të rrezikshme vetëm kur ekzistojnë lidhjet e duhura dhe të vazhdueshme të komunikimit me kolegët që sigurojnë ndihmë në rastet emergjente.
- Kontraktuesi duhet të mbrojë njerëzit që punojnë në kanale apo ne lume nga shembjet duke vendosur trarë mbështetës ose shkalle në këto kanale, si dhe duhet të tregojë kujdes të veçantë për personat që punojnë në lume apo kanale, dhe nuk duhet të lejojë që punonjësit të punojnë të vetëm dhe pa masat e posaçme te mbrojtjes këto fronte pune.
- Kontraktori duhet të mbrojë personelin nga pjesët lëvizëse të makinerive duke vendosur dhe mirëmbajtur mjetet e duhura mbrojtëse.
- Kontraktori nuk duhet të lejojë qëndrimin e kalimtarëve të rastësishëm pranë zonave te germuara.
- Kontraktuesi duhet të sigurojë një rrethim të mjaftueshëm përreth zonave të punës.

- **Masat për Mbrojtjen Mjedisore**

Kontraktori duhet te pajtohet me legjislacionin vendor dhe me dispozitat perkatese te Ndikimit Mjedisor dhe Social (Environmental and Social Impact Assessment (ESIA).

Kontraktori duhet të mbrojë shtresat nëntokësore dhe veçanërisht ujërat nëntokësore nga ndotja prej lëndës djegëse ose prej naftës së pajisjeve të tij.

Kontraktori duhet të sigurojë spërkatjen me uje në zonën e punimeve në mënyrë që në atmosferë të mos krijohet pluhur.

Balta duhet te kontrollohet dhe nese eshte e nevojshme, Kontraktori duhet te perdore prita dhe /ose basene sedimentimi.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Kontraktori duhet te mbaje te gjitha strukturat e perkohshme dhe te perhershme te kontrollit te sedimenteve ne menyre qe ato te operojne sic duhet per kapjen dhe depozitimin e sedimenteve. Kontraktori duhet te siguroje qe basenet e sedimenteve te pastrohen nese jane mbushur tej kapaciteteve te tyre. Depozitimet duhet te largohen ne menyre adekuate me miratim te Supervizorit.

Demtimet e mbuleses vegjetale duhet te kufizohen dhe pemet ekzistuese duhet te mbrohen perveçse ne rastet kur eshte rene dakort ndryshe me Punedhenesin dhe Supervizorin.

- **SIGURIMI I CILESISE**

Kontraktori përgatit procedurat për cilësinë për të garantuar se materialet e tij dhe profesionalizmi dhe procedurat e Nën-Kontraktuesve te tij plotësojnë kërkesat e përcaktuara për cilësinë dhe ia parashtron ato Supervizorit për miratim.

Procedurat duhet te përfshijnë minimalisht:

- **Struktura e Menaxhimit**

Struktura e menaxhimit të Kontraktuesit e cila duhet të përcaktojë personelin përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm dhe kontrollin e Kontratës si dhe përfaqësuesit në terren përgjegjës për kontrollin e cilësisë.

- **Nën-Kontraktuesit (nëse përdoren)**

Përshkrimi i mënyrës se si do të mbikëqyren dhe monitorohen standardet e cilësisë së Nën-Kontraktuesve.

- **Materialet**

Përshkrimi i mënyrës se si furnizuesit e materialeve do të kontrollohen për të siguruar se do të prodhohen dhe shpërndahen në terren vetëm materialet që plotësojnë standardet e cilësisë, dhe metodat për përcaktimin dhe heqjen nga terreni të materialeve që nuk plotësojnë këto standarde.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

- **Regjistrimi i Cilësisë**

Përshkrimi i mënyrës së regjistrimit të cilësisë, mostra të raporteve standarde dhe metodave për ruajtjen, plotësimin dhe mirëmbajtjen e këtyre raporteve.

- **Testimi i Kontrollit të Cilësisë / Mos-Përputhja**

Do të përcaktohen detajet mbi mënyrën e monitorimit dhe testimit të profesionalizmit dhe të gjitha materialeve të tjera dhe impiantit të përfshira në Punimet e Përhershme, si dhe do përcaktohet mënyra e veprimit me ato që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara ose botimet më të fundit të Standardeve dhe Kodeve të Praktikës, dhe gjithashtu do të përcaktohen masat riparuese, si dhe të dhënat mbi masat riparuese të ndërmarra dhe metodat për shmangien e mospërputhjes në të ardhmen.
Kontraktori i paraqet Supervizorit të gjitha raportet e testit për kontroll dhe rishikim.

- **PUNIMET E DHEUT**
- **Gërmimi**
- **Të përgjithshme**

Kontraktuesi duhet të njoftojë Supervizorin të paktën brenda 7 ditëve mbi planin e tij për të filluar punime dheu në çdo pjesë të terrenit me qëllim që Supervizori të sigurojë nivelet e sakta dhe të dhëna të tjera mbi terrenin të nevojshme për qëllimet e matjeve.

Punimet e dheut të mësipërme nuk duhet të fillojnë pa miratim nga Supervizori.

Të gjitha punimet e dheut për disa pjesë të punimeve do të kryhen në përmasat dhe nivelet e paraqitura në vizatimet ose specifikimet, ose sipas atyre të paraqitura nga Supervizori.

Për qëllimet e specifikimit, termi "niveli i tokës" i referohet sipërfaqes së tokës para fillimit të punimeve në çdo vendndodhje, por pas pastrimit të bimësisë.

Miratimi i dhënë nga Supervizori për metodat dhe pajisjet e Kontraktuesit, nuk e përjashton Kontraktuesin nga përgjegjësia e tij e plotë për zbatimin e duhur dhe të sigurtë të gërmimeve,

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

apo nga përgjegjësia e tij për dëmtimet ose vdekjen e personave, si dhe çdo detyrim tjetër sipas Kontratës.

Kontraktuesi është gjithashtu përgjegjës për gërmimet që nuk janë specifikisht të nevojshme për ndërtimin e Punimeve të Përhershme, por konsiderohen si dytësore.

Asnje nga materialet për asgjësim nuk duhet të hidhen në lumë apo në një vend ku, sipas mendimit të Supervizorit, këto materiale mund të përfshihen nga prurjet ose mund të bllokojnë kalimin e ujit.

Të gjitha gërmimet në sipërfaqe duhet të jenë reale sipas vijave, pjerrësisë dhe niveleve të paraqitura në vizatimet.

Kontraktuesi duhet që për të gjitha gërmimet e bëra , ne se eshte e nevojshme ,të sigurojë pajisjet e duhura të drenazhimit për grumbullimin dhe largimin e ujit nga çdo burim.

Të gjitha ujërat siperfaqesore apo nëntokësore duhet të kontrollohen për të ruajtur strukturat e punës në gjendje të thatë nëpërmjet drenazheve, kanaleve ose metodave të tjera të pranueshme..

Gjatë vazhdimësisë së punimeve mund të jetë e nevojshme ose e këshillueshme që të ndryshohen skarpatet ose përmasat e gërmimeve të paraqitura në vizatimet përkatëse. Të gjitha këto ndryshime duhet të miratohen nga Supervizori para kryerjes së gërmimeve.

Gërmimet e nevojshme për interesin e Kontraktuesit përveç atyre të paraqitura në Vizatimet e Projektit, gërmimet mbi normë të bëra prej tij, për çdo arsye përveç arsyeve gjeologjike/ gjeoteknike të miratuara nga Supervizori, apo që rezultojnë nga gërmimet e punimeve do të kryhen me shpenzimet e Kontraktuesit. Gërmimet mbi normë mbushen me material të pranueshëm sipas udhëzimeve të Supervizorit me shpenzimet e Kontraktuesit.

Gërmimet e sipërfaqes kryhen nga çdo metodë e pranuar duke përdorur çdo pajisje gërmimi apo transportimi të përshtatshme për punimet në përputhje me projekt zbatimin dhe grafikun e paraqitur, apo me ndryshimet e miratuara.

Gjatë gjithë kohës së ndërtimit, Kontraktuesi duhet të përshtatë procedurat e gërmimeve në mënyrë të tillë që të mos dëmtohet qëndrueshmëria e çdo skarpate. Pranimi nga ana e

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Supervizorit të procedurave apo pajisjeve të gërmimit nuk e përjashtojnë Kontraktuesin nga përgjegjësia e tij e vetme për ruajtjen e qëndrueshmërisë së të gjitha skarpateve të gërmuara sipas kësaj Kontrate.

Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të veçantë gjatë kryerjes së gërmimeve në afërsi të strukturave ekzistuese apo atyre në ndërtim. Ai është përgjegjës për çdo dëmtim të strukturave ose pajisjeve të shkaktuar nga punimet e tij.

- **Pastrimi i bimesise dhe mbeturinave**

Pastrimi përbëhet nga prerja dhe hedhja e të gjitha shkurreve, trungjeve, gërmadhave si dhe çdo bimësie tjetër dhe shtresa sipërfaqësore organike, struktura ekzistuese, themele të strukturave , gardhet dhe materiale të tjera mbushëse në sipërfaqen e tokës në zona që do të pastrohen siç paraqitet në Vizatimet e Ndërtimit, ose sipas udhëzimeve të Supervizorit.

Të gjitha materialet e djegshme që rezultojnë nga pastrimi duhet të digjen ose të asgjësohen nga kontraktuesi në një mënyrë të pranueshme nga Supervizori. Kontraktuesi është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme të sigurisë për djegien e materialeve, dhe është përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar nga zjarri që krijohet si pasojë e punimeve të tij.

Skarifikimi përbëhet nga heqja e të gjitha mbeturinave, humusit, materialeve bimore si dhe shtresave sipërfaqësore organike në gjithe zonen ose pjese te saj në thellësinë e paraqitur në Vizatimet e Ndërtimit ose te udhezuar nga Supervizori.

Skarifikimi kryet nga gërmimet përkatëse dhe pajisjet transportuese të cilat janë të përshtatshme për punimet që sigurojnë progresin efikas të punës në përshtatje me kushtet e terrenit.

- **Gërmimet**

Gërmimet nënkuptojnë gërmimet e përgjithshme të materialeve të tilla si shtresa sipërfaqësore organike, argjila, dherat, rëra, zhavorri dhe gurë me vëllime te ndryshsme si dhe shkëmbinj të shkrifët ose të ngjeshur, të cilët mund nxirren nga toka me anë të mjeteve lëvizëse pa/ose duke përdorur procesin e thyerjes apo shpërthimit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Dimensionet e gërmimeve të kryera dhe përshtatshmëria e zonave të themeleve për të marrë materialet mbushëse, ne rastet e betonimeve, etj., duhet te realizohen e paraqiten në Vizatimet e Ndërtimit (libresat e masave) me saktesi dhe me shumellojshmerine e tyre , perfshi skarpata apo dimensione të tjera, këndin i pjerrësisë , nëse është e nevojshmeetj.

E te gjitha keto duhte te realizohen ne cdo rast, pergjatë gjithe progresit të punës.

Kontraktuesi duhet të ruajë këndin e pjerrësisë së gërmimeve dhe kanaleve.

Në rastin e veshjes se kanaleve , kur për ndonjë arsye pjesa fundore e gërmimeve nuk është ne formacione rrenjesore , dhe materiali i zakonshëm për bazen apo themelet është i shpërbërë ose i shkrifëruar, Kontraktuesi e përmirëson atë duke e ngjeshur ose e zëvendëson ate , te tëre ose pjeserisht me material mbushës të ngjeshur, të miratuar nën drejtimin e Supervizorit.

Te gjitha punimet per germime apo mbushje per formimin e seksionit gjatesor apo terthor, do te behen ne perputhje me seksionin tip dhe specifikimet teknike qe shoqerojne kete project, duke mbajtur parasysh edhe perpuethshmerine ose jo te kushteve konkrete te terrenit. Ne rat mosperputhje do te behen ndryshimet e e nevojshme gjithnje me miratimin e supervizorit.
Para se te fillohet nga puna, qofte edhe ne nje segment ta caktuar, nga ana e zabtuesit do te behet piketimi dhe azhornimi i profilit gjatesor e atyre terthor ne kete segmnet dhe ne asnje rast nuk do te fillohet nga puna pa u bere me pare konfirmimi nga supervizori dhe punedhenesi.

Ne ratet kur perdoren zera punimesh si zeri : “ *germim dheu per vepren* “ Aty perfshihen te gjitha punimet e nevojshme qe duhet te kryhen ne çdo segment per realizimin profilit gjatesor e atij terthor ne perputhje me projektin e dhene.

Në rastet kur mbrojtjet nga gerryerjet apo perpmbytjet nga lumi, perveç argjinaturave, duhet te realizohen edhe me penela asnje rast, atehere eshte e domosdoshme te mbahet parasysh se :

- bazamenti i penelit nuk duhet te qendroje i pa mbeshtetur mire.

- Edhe ne rastet e depresioneve apo prezences se gjurmes se filoneve ujore te ndryshme pergjate shtratit te lumit, bazamneti i penelit duhet te perpunohet me mbushje me gure relativisht te medhenj.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Nëse ndodh ndonjë shkarje apo mund të ndodhë, sipas rastit, duhet të përdoren metoda të përshtatshme në konsultime me Supervizorin për të ruajtur gërmimet nga shkarje të tjera për të stabilizuar skarpatat ekzistuese. Çdo shkarje e mundshme duhet të hiqet sa më shpejt nga Kontraktuesi.

Kontraktuesi nivelon dhe largon nga gërmimet të gjitha materialet e shkrifëruara të cilat duken të pasigurta ose rrezikojnë personat, punën apo pronën.

Fakti që këto nivelime dhe largime mund të zmadhojnë gërmimet mbi vijat e kërkuara të gërmimeve, nuk e përjashton Kontraktuesin nga domosdoshmëria për të kryer këto nivelime dhe heqje.

- **Gërmimet per riseksionime**

Gërmimet per riseskionime duhet te realizohen me metoda që nuk rrezikojnë qëndrueshmërinë e skarpatave anësore.

Për kanalet ekzistuese, të cilat duhet të ripunohen, shkallët e shtresave duhet të jenë në nivelet e kërkuara. Sipërfaqja e vijës së ujit paraqitur në Vizatimet përbën kërkesat minimale dhe pjesët anësore të kanaleve rregullohen sipas skparpatës së nevojshme me qëllim që të sigurohen gjerësi jo më pak se ato që paraqiten në Vizatimet përkatëse.

Mbushjet anësore perdoren e rregullohen për të siguruar dimensione e nevojshme hidrai;like por edhe per te suguruar nje pamje të rregullt e madje edhe sipërfaqe të rregullta.

Materiali i tepërt nëse ka karakteristikat e duhura mund të përdoret në punime per mbushjen e bankinave e argjinaturave ose mund të shpërndahet sipas menyres se miratuar ne bashkepunim me komunitetin dhe Supervizori, ndryshe ky material duhet të largohet nga trualli dhe të asgjësohet plotësisht.

- **Materialet e Gërmuara dhe Depozitimi i tyre**

Në këtë projekt, dherat e germuara qe jane te mbushura me trupa e lende te ndryshme apo mbeturina ndertimore apo ato plastike, jane parashikuar te dalin jashte objektit apo te asgjësohen

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

përfundimisht në zona te caktuara siç është vendosur më pare me Supervizorin dhe pushtetin lokal.

Të gjitha dherat e tjera të gërmuara do te perdoren ne punime per realizimin e nje pjesë te strukturave të përkohshme ose të përhershme siç jane argjinaturat apo mbingritjet e nevojshme te mbushjeve pergjate objektit, ose, shperndahen ne forme shtresash pergjate siperfaqeve me te aferta qe shtrihen pergjate te dy seksioneve.

Kur në Punime do të përdoren materiale mbushëse të gërmuara të një lloji apo cilësie të veçantë, materiali i pershtatshem percaktohet nga Supervizori konsultuar me projektuesin dhe mbi bazen e rezultateve të testeve laboratorike të kryera. Këto materiale transportohen në një vend më vete, duke kufizuar ndotjen e shkaktuar nga mbivendosja ose materialet mbushëse të përfshira të një lloji ose cilësie tjetër.

Të gjitha sipërfaqet e ekspozuara ndaj ndryshimeve të nivelit të ujit duhet të mbrohen kundër gërryerjes nëpërmjet materialeve të përshtatshme mbushëse.

Materiali mbushës i përdorshëm që sillet në terren nëse është i panevojshëm sipas kërkesës, asgjësohet nga Kontraktuesi në mënyrën e pranuar nga Supervizori.

Kontraktuesi është përgjegjës për çdo dëm të punimeve të përhershme ose të përkohshme apo të palëve të treta dhe pronës së tyre shkaktuar nga drenazhimi i pamjaftueshëm i mbeturinave apo zonave me materiale te depozituara.

Materialet mbushëse të gërmuara transportohen në zonat e asgjësimit në mënyrë të tillë që të shmanget derdhja e materialeve në rrugë apo në vende të tjera. Nëse këto materiale derdhen, pastrohen dhe hiqen menjëherë nga Kontraktuesi dhe asgjësohen në një vend të miratuar.

- **Pergatitja dhe Mbrojtja e Siperfaqes se Germimit**

Sipërfaqet e gërmimeve, në të cilat do të vendoset betoni, mbushjet e argjinaturave ose rimbushjet, përgatiten dhe mbrohen siç specifikohet në këtë pikë dhe në përputhje me specifikimet e pjesëve përkatëse të këtyre Specifikimeve ose siç tregohet në Vizatimet e Ndërtimit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Nëse gjatë punimeve gërmuese, materiali është shkrifëruar ose shpërbërë mbi limitet e gërmimeve paraqitur në Vizatimet e Gërmimit, kontraktuesi ringjesh materialin e shkrifëruar ose e largon tërësisht atë dhe e zëvendëson me material tjetër mbushës të ngjeshur, sipas udhëzimeve.

Gërmimet e themelit mbahen të thata mirë dhe pa mbetje uji sipas Planit të Kontraktuesit për Kontrollin e Ujit.

- **Rimbushjet**

Punimet e rimbushjes/mbushjes përfshijnë llojet e mëposhtme të materialeve siç paraqitet ne Vizatimet e Ndërtimit ose sipas Supervizorit Përgjegjës:

- Mbushja e argjinaatures (diges)
- Rimbushja/mbushja e rastësishme
- Rimbushja/mbushja per drenazhim
- Rimbushja/mbushja me rërë-zhavorr e kanaleve
- **Betoni për rimbushje**
- **Të përgjithshme**

Kontraktuesi vendos dhe ngjesh materialet e punimeve rimbushëse/mbushëse të llojeve të veçanta të vijave, nivelimeve dhe dimensioneve të paraqitura në vizatimet e ndërtimit, pas strukturave, në gërmimet e tejkaluara ose në vendet e përcaktuara sipas Supervizorit.

Materiali që do të përdoret për punimet rimbushëse/mbushëse i nënshtrohet miratimit të Supervizorit dhe sipas mundësisë, përftohet nga gërmimet e nevojshme për Punime të Përkohshme ose të Përhershme apo nga karriera të miratuara.

Shpërndarja dhe shkallëzimi i materialit për punimet rimbushëse/mbushëse duhet të jetë i tillë që punimet rimbushëse mbushëse të mos kenë lente, xhepa, shirita ose shtresa prej materiali që ndryshojnë thelbësisht në strukture ose nivelim nga materiali përreth.

Materiali rimbushës/mbushës nuk duhet të ketë lëndë organike dhe Supervizori rezervon të drejtën për të nxjerrë jashtë përdorimit të gjithë ngarkesën e materialit që përmban përqindje të lartë lënde organike, e cila nuk mund të hiqet në mënyrë të kënaqshme.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Lëvizja mbi punimet rimbushëse/mbushëse kontrollohet me saktësi për të shmangur kalimin në rimbushjet/mbushjet e vendosura.

Çdo ngarkesë me material vendoset në mënyrë të tillë që praktikisht të arrihet shpërndarja më e mirë e materialit.

Perdorimi i kamionëve dhe mjeteve të rënda kufizohet ndjeshem mnë këtë objket ose duhet të qëndrojë larg objekteve të përhershme, ndërtesave, mureve, pritave argjinaturave ose objekteve të tjera për të shmangur dëmtimin e Punimeve të Përhershme.

Çdo material që sipas mendimit të Supervizorit është i papranueshëm ose i papërshtatshëm, largohet me shpenzimet e Kontraktuesit.

Nëse sipërfaqja e ngjeshur e ndonjë shtrese është shumë e rrafshët dhe e ngjeshur për tëu lidhur siç duhet me shtresën vijuese, kjo shtresë shkrifërohet nëpërmjet lërimit ose metodave të tjera të miratuara para vendosjes së shtresës vijuese në të.

Veprimet e rimbushjes dhe mbushjes nuk kryhen me plisa dhe materiale të ngrira dhe gjatë temperaturave të ulëta nëse ky material ndikojnë negativisht në punimet përkatëse.

Kontraktuesi mirëmban dhe mbron punimet rimbushëse/mbushëse të përfunduara në kushte të pëlqyeshme gjatë gjithë kohës deri në përfundimin dhe pranimin e Punimeve.

Pas mbarimit të veprimeve rimbushëse dhe mbushëse dhe para mbarimit të nivelimit, Kontraktuesi rafshon sipërfaqet për të parandaluar grumbullimin e ujit.

- **Mbushja e Argjinatures**

Gjatë Shkrifërimit të Sipërfaqes Tokësore ku do të kryhet mbushja me dhe, sipërfaqja e tokës në të cilën do të bëhet mbushja e argjinaturës përgatitet me kujdes.

Ky proces përfshin heqjen e materialeve organike dhe shkrifërimin e sipërfaqes në thellësi jo më të vogël se deri në 0.10m me qëllim që të sigurohet lidhja e parashikuar ndërmjet sipërfaqes tokësore origjinale dhe mbushjes përkatëse. Përmbajtja e lagështirës se sipërfaqes së shkrifëruar duhet të kontrollohet me kujdes ose nëpërmjet tharjes natyrore ose nëpërmjet lagies me shihedhes.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Nëse gjatë ngarkimit dhe ngjeshjes së argjinaturës ka ndërprerje gjatë kohës së mjaftueshme për ngrirjen e sipërfaqes ose për rritjen e bimësisë, përsëritet procesi i pastrimit dhe shkrifërimit nën drejtimin e Supervizorit.

Karakteristikat e procesit të mbushjes do të jenë siç paraqiten në Specifikimet e Veçanta Teknike dhe/ose në shenimet teknike te dhena ne Vizatimet e Ndërtimit *(Shih specifikimet e vecanta per realizimin e argjinatues/digës ne kete objekt).*

Lagështirë e mbushjes përshtatet sipas kushtëzimit të volitshëm që duhet per te realizuar treguesit e tjere te ngjeshjes, ose siç përcaktohet nga Supervizori në varësi të karakteristikave të materialit te ardhur , dhe më pas të atij te ngjeshur deri në 95% të Densitet Maksimal.

Pajisjet e ngjeshjes duhet të funksionojnë në mënyrë të tillë që të arrijnë ngjeshjen e nevojshme pa shkaktuar asnjë ndikim të dëmshëm në materialin mbushës.

Pajisjet kontrollohen me kujdes për të siguruar se të gjitha zonat janë ngjeshur në mënyrë të njëtrajtshme në gjerësinë dhe thellësinë e tyre të plotë.
Mbushje me material te shkrifet/ mbushja/ zhavorri i zgjedhur
Materiali rimbushës/mbushës i shkrifet që do të vendoset brenda perimetrit prej 1m të strukturës, nuk duhet të përmbajë materiale më të mëdha se 100mm.
Rimbushja/mbushja me material te shkrifet vendoset me lagështi në shtresa që nuk kalojnë 300mm, para ngjeshjes. Kjo rimbushje/mbushje ngjishet deri në 70% të dendësisë relative.
Rimbushja-mbushja me material te shkrifet ngjishet me anë të ruleve ngjeshës me terheqje apo auto rule ngjeshës.
Kur është e nevojshme që rimbushja të vendoset afër me strukturat ose në zona të tjera të kufizuara, atëherë ngjishet duke përdorur tokmak ose metoda të tjera të miratuara ngjeshjeje.

- **Mbushja me rërë – zhavorr / mbushja e drenazheve**

Normalisht, rëra dhe zhavorri i niveluar mirë duhet të përdoret për rimbushjen/mbushjen e kanaleve për tubacione, kabllo, tuba, shtresëzime për kanale etj. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, madhësia maksimale e pjesëzës nuk duhet të jetë më shumë se 75mm dhe maksimumi 5 % e peshës që kalon Sitën Standard të US me nr. 200 (0.075mm). Materiali duhet te shpërndahet në

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

shtresa prej 200 mm dhe ngjishet në mënyrë mekanike ose me metoda të tjera të miratuara nga Supervizori.

- **BETONET**
- **Të përgjithshme**

Standardi i materialeve dhe aftësive në punë nuk duhet të jenë nën nivelin e rekomandimeve të versionit aktual të standardeve në vijim sipas rastit për llojin e strukturës:

- EN 13670: 2009 Implementimi i strukturave prej betoni
- EN 206-1 Betoni Pjesa 1: Specifikimet, performanca, krijimi dhe përputhja
- EN 1992 Pjesa 1
- EN 1992 Pjesa 3

Kërkesat e hartuara në dokumentet e mësipërme duhet të lexohen bashkë me kërkesat e kësaj Pjese të Specifikimit dhe në rastin kur ekzistojnë mospërputhje ndërmjet rekomandimeve të dokumenteve të mësipërme dhe atyre të këtij Specifikimi, përparësi marrin kërkesat e këtij Specifikimi.

Kontraktuesi i paraqet Supervizorit për miratim, propozimet e bëra nga ana e tij si pjesë e planit të tij për sigurimin e cilësisë me qëllim që të arrihet cilësia e kërkuar e betonit. Megjithatë, çdo miratim nga ana e Supervizorit nuk e përjashton kontraktuesin nga përgjegjësia dhe detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, veçanërisht detyrimet që lidhen me saktësinë dhe cilësinë e produktit përfundimtar.

- **Përzierja e Betonit dhe Testimi**
- **Çimentoja**

Çimentoja e përdorur për beton, nëse nuk përcaktohet ndryshe, duhet të jetë në përputhje me EN 197-1 Tipi I.

Çimento e Tipit II dhe III të EN 197-1 ose e çimentos në formë pluhuri përdoret vetëm me miratimin e Supervizorit. Deri kur të jetë vërtetuar se tërësia e betonit është krejtësisht e padëmshme ndaj reaksioneve alkaline, e tërë masa e çimentos duhet të jetë e tipit të alkalit të ulët me përmbajtje maksimale 0.6 % alkali e shprehur si natrium-ekuivalent ($Na_2O + 0.658\ K_2O$).

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Kontraktuesi njofton Supervizorin se nga cila Fabrikë apo Fabrika synon të blejë çimenton dhe nëse kjo çimento do të sigurohet me shumicë apo me thasë. Porositë ose kontratat e blerjes për sigurimin e çimentos duhet të përmbajnë kërkesat në lidhje me cilësinë dhe procedurat për kontrollin e cilësisë që do të miratohen nga Supervizori, si dhe dëshmitë e testimit të fabrikës duhet të dorëzohen bashkë me dërgesat.

Çimentoja duhet të jetë e re kur transportohet në Terren dhe Kontraktuesi duhet të përdorë dërgesat me çimento sipas radhës së dorëzimit të tyre. Kontraktuesi shënon datën e dorëzimit në çdo dërgesë si dhe çdo dërgesë ruhet më vete dhe në mënyrë të tillë që të përdoret lehtësisht.

Kontraktuesi nuk duhet të përdorë asnjë çimento në thasë apo kontejnerë të tjerë nëse ato dhe vulat e prodhuesit nuk janë të plota në momentin e përzierjes. Nëse çimentoja është dorëzuar në thasë, Kontraktuesi duhet ta ruajë çimenton në depo ose ndërtesë të papërshkueshme nga uji në temperaturë jo më të vogël se 8^{o}C dhe të vendosë thasët me çimento në dërrasa mbi dysheme për të penguar dëmtimin ose ndotjen për ndonjë arsye. Kontraktuesi mund të përdorë çimento me shumicë me kusht që kjo çimento të jetë ruajtur në kontejnerë të papërshkueshëm nga uji dhe të pranuar.

Kontraktuesi nuk duhet të përdorë çimenton që është ngurtësuar në copa, por pas heqjes së copave nëpërmjet sitjes, Punëdhënësi mund të lejoje përdorimin e kësaj çimentoje në përzierje betoni jo-ndërtimore. Çimentoja që është ruajtur në Terren për më shumë se katër muaj nuk përdoret deri kur të provohet se plotëson kriteret e duhura.

Kontraktuesi nuk duhet të përdorë çimenton që është ngurtësuar.

- **Inertet e Betonit**

Kontraktuesi heton mbi burimet e propozuara të inerteve në detaj dhe paraqet një raport të përgjithshëm i cili përmban informacionet teknike dhe të dhënat në vijim:

- Vendndodhja. Miratohen vetëm Burimet e pajisura me mjetet e duhura për prodhimin e materialeve të specifikuara dhe në sasi të tilla që të jenë në përputhje me zbatimin e duhur të Kontratës.
- Petrologjia e burimeve dhe variabiliteti i mundshëm gjatë periudhës së Kontratës.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

- Metoda e Prodhimit.
- Plani i inerteve të propozuara dhe atyre në dispozicion sipas madhësisë, duke përfshirë detaje të përmasave aktuale të sitës për të prodhuar çdo inert.
- Të dhënat e Testit sipas rastit për çdo lloj dhe madhësi inerti mbi bazën e mostrave përfaqësuese dhe të testuara në përputhje me Standardet përkatëse Britanike.
- Një pasqyrë të detajuar të inertit të propozuar për përdorim në çdo nivel betoni.

Mostrat e të gjithë inerteve, përfshirë inertet e imëta dhe rërën, i paraqiten Supervizorit për miratim. Të gjitha mostrat merren në përputhje me EN 12620.

Kontraktuesi duhet të sigurojë, në çdo dërgesë apo në intervale të drejtuara nga Supervizori, një dëshmi të nënshkruar nga furnizuesi, apo analist tjetër i pranuar, që paraqet në mënyrë të plotë karakteristikat e detajuara kimike dhe fizike të të gjitha inerteve së bashku me analizën e sitës të kryer në përputhje me EN933-1 përkatës apo miratime të tjera të ngjashme.

Për çdo ndryshim të veçorive të inerteve që ndodhin gjatë periudhës së Kontratës, duhet të njoftohet menjëherë Supervizori.

Inertet ruhen në Terren në grumbuj më vete të sistemuar në mënyrë të tillë që të parandalohet përzierja e inerteve të ndryshme. Këto grumbuj mbrohen në mënyrë të mjaftueshme për të penguar ndotjen e inerteve nga toka, mbeturinat apo gjethet, pluhuri apo materiale të tjera të sjella nga era.

Inertet duhet të plotësojnë EN12620 dhe duhet të jenë të pastra dhe të mos kenë materiale të huaja si dhe të mos përbëhen nga guaska apo gurë gëlqerorë argjilorë dhe as tëi përmbajnë ato.

Kur madhësia nominale e përcaktuar është më e madhe se 37.5mm, nivelimi kryhet me miratimin e Supervizorit ose sipas udhëzimeve të tij.

Papastërtitë dhe substancat e dëmshme me kristale të mëdha si dhe inertet e imëta nuk duhet të kalojnë limitet maksimale të përcaktuara.

Inertet e nevojshme për përdorim në ndërtimin e mbajtëses së ujit të betonit, heqjes së ujit dhe çdo strukturë tjetër të ngjashme, duhet të kenë rrëgjim të ulët tharjeje dhe thithja e ujit nuk duhet

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

të jetë më shumë se 3%. Thithja e inerteve matet në përputhje me Standardet përkatëse Evropiane apo të tjera të ngjashme të miratuara.

Preferohen inerte me formë të rrumbullakët apo ndryshe inerte që mund të krijojnë beton me cilësi të mirë që kërkon shtim minimal uji.

Pluhurat që krijohen nga ngjeshja e inerteve nuk lejohet të ndotin grumbujt me inerte. Në rastin kur sipas mendimit të Supervizorit, ndodh ndotje e tillë, ajo asgjësohet menjëherë nëpërmjet mjeteve të miratuara ose në të kundërt këto inerte nuk pranohen.

Për betonin e grumbulluar, me qëllim që të përmirësohet qëndrueshmëria e përzierjes, pluhuri që krijohet nga ngjeshja e inerteve mund të përfshihet pas testimeve të kryera në sasitë e kontrolluara për të shtuar inert të imët.

Përveç rasteve kur inertet janë përcaktuar ndryshe në Vizatimet, nivelimi i inerteve do të jetë si më poshtë dhe në përputhje me inertet e niveluara 4/40, 4.20 dhe 2/14 për inertet me kristale të mëdha 0/4 (MP) dhe 0/2 (MP) të ISO 565 për inertet e imëta nëse nuk miratohet ndryshe.

Inertet me kristale të mëdhenj:

- 10 mm madhësi maksimale, të niveluar për të gjithë betonin "e imët".
- 20 mm madhësi maksimale, të niveluar për të gjithë betonarmenë për binarët si dhe për muret dhe pllakat e çimentos me trashësi jo më të madhe se 400 mm.
- 40 mm madhësi maksimale e niveluar për të gjithë betonarmenë, muret dhe pllakat e çimentos me trashësi më të madhe se 400mm.

Inertet e Imëta

- Inertet e imëta të niveluara 0/4 (MP) dhe 0/2 (MP) të ISO 565

- **Furnizimi me Ujë**

Kontraktuesi duhet të sigurojë të gjithë ujin e nevojshëm, të bëjë përgatitje dhe të bëjë të gjitha pagesat në lidhje me sigurimin e ujit. Uji përdoret në rastin kur merret nga një pikë publike e furnizimit me ujë.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Uji testohet në përputhje me BS EN 1008 dhe nëse është e nevojshme trajtohet për të siguruar përputhjen me këto standarde. Uji që përdoret për betonim duhet të provohet dhe testohet të paktën një herë në muaj ose sipas udhëzimeve të Supervizorit.

Uji që përdoret për larje dhe gatim duhet të plotësojë po ato kërkesa si uji përzierës për beton dhe duhet të jetë i tillë që të mos dëmtojë as qëndrueshmërinë e betonit me sipërfaqe të lëmuar dhe as pamjen e tij.

- **Aditivet**

Para miratimit për përdorim të aditivit prej firmash të regjistruara, kontraktuesi duhet të bindë Supervizorin në lidhje me përshtatshmërinë e punës dhe përputhjen e tij me çimenton që do të përdoret për mbushje.

Preferohet përdorimi i aditivit që mund të përdoret në sasi të pandryshueshme në formë pluhuri (me shpërndarës automatik) ose me kapsula, që shtohen menjëherë në ujin përzierës.

Kur jepet miratimi për përdorimin e më shumë se një lloj aditivi për të njëjtën përzierje betoni, ky aditiv veçohet.

Në të gjitha rastet, Kontraktuesi siguron ushtrimin e kontrollit të duhur në ruajtjen e harmonizimeve të sakta të përcaktuara nga formuluesit. Në rastin kur këto harmonizime nuk janë të sakta apo kur aditivi ndikon negativisht në betonin me sipërfaqe të lëmuar, punimet e kryera riparohen ose zëvendësohen.

- **Aditivi për pakësimin e ujit**

Kontraktuesi duhet të përfshijë aditiv të miratuar për pakësimin e ujit (plastifikator) për rastet kur, sipas Supervizorit, punueshmëria e përzierjes është në rrethana të tjera e pamjaftueshme për të arritur ngjeshjen e pranueshme dhe/ose betonin me sipërfaqe të lëmuar, apo kur vërehet rrjedhje e tepërt e betonit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

- **Aditivi për ngadalësimin e ngrirjes së betonit**

Në rastin kur duhet të vendosen sasi të mëdha betoni në çdo kohë apo kur betonimi kryhet në kushte të nxehta, Kontraktuesi mund të përfshijë aditivin e miratuara për ngadalësimin e ngrirjes së betonit me qëllim që të zvogëlohet nxehtësia e shuarjes me ujë dhe ky proces të kryhet me rregull para përfundimit të ngrirjes së parakohshme të betonit.

- **Aditivi për përshpejtimin e ngrirjes së betonit**

Kontraktuesi nuk duhet të përdorë aditiv për përshpejtimin e ngrirjes së betonit në ndërtime betoni origjinal përveç rasteve kur Supervizori shpreh miratimin e tij për qëllime specifike.

- **Kërkesat për Përzierjet**

Raportet e përqindjes përzgjidhen me qëllim që të sigurohet se punueshmëria e betonit të ri është e përshtatshme për kushtet e transportimit dhe vendosjes, duke i kushtuar vëmendje elementit ndërtimor që do të instalohet, vendosjes së armimit, dhe duke pasur parasysh mjedisin ku do të vendoset.

Në të gjitha rastet e përcaktimit të raporteve të përzierjes, uji i shtuar duhet të jetë sipas kuotave të duhura për lagështirën që ekziston në inerte dhe duhet të jetë minimalisht në përputhje me kërkesat për punueshmërinë.

Në rastin kur përdoret madhësi maksimale prej 40mm e inertit, kërkesat minimale të mbulesës do të rriten me 10mm por të kufizuara deri në 45mm.

- **Qëndrueshmëria**

Qëndrueshmëria karakteristike e betonit nënkupton atë vlerë force kubike për 28 ditë, vlerë nën të cilën parashikohet të bjerë jo më shumë se 5% e të gjitha rezultateve të mundshme të testit.

- **Prodhimi**

Inertet dhe çimentoja balancohen sipas peshës dhe uji balancohet sipas vëllimit. Pas miratimit të marrë nga Supervizori mund të përdoret për pjesë të vogla të punimeve balancimi i inerteve sipas

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

vëllimit por përpjesëtimi i çimentos sipas vëllimit nuk pranohet në asnjë rast. Megjithatë, kontraktuesi mund ta balancojë përzierjen në mënyrë të tillë që çdo përzierje të përdorë një thes apo thasë të plotë me çimento, pesha e të cilit, apo të cilëve dihet me saktësi. Në rastin kur lejohet balancimi i inerteve sipas vëllimit, të gjitha kutitë matëse duhet të jenë të sakta dhe duhet të përcaktohet toleranca e duhur për grumbullimin e inerteve me qëllim që të vlerësohet vëllimi i saktë që do të përdoret.

Inertet dhe çimentoja përzihen tërësisht në një përzierës të pastër mekanik për një periudhë kohe për të cilën është rënë dakord me Supervizorin dhe uji shtohet mbi bazën e projektimit të miratuar.

Makineritë përzierëse të elementeve përbërëse duhet të jenë në përputhje me kërkesat e BS 1305 apo kërkesa të tjera të miratuara. Ato duhet të sigurohen në numër dhe kapacitet të tillë që të sigurohet furnizimi i vazhdueshëm i betonit të sapo përzier gjatë gjithë kohës gjatë ndërtimit.

Përdorimi i makinerive përzierëse të vazhdueshme bëhet vetëm me miratimin e dhënë me shkrim nga Supervizori.

- **Kontrolli i Cilësisë**

Kontraktuesi duhet të sigurojë në Terren pajisjet, stafin dhe punën për kryerjen e provave dhe testimeve dhe ai duhet të kryejë një ose të gjithë këto teste në kohën dhe frekuencën e përcaktuar nga Supervizori.

Të gjitha pajisjet duhet të kalibrohen dhe kontrollohen herë pas here sipas kërkesave të Supervizorit.

Kontraktuesi duhet të sigurojë të gjitha mostrat e kërkuara nga Supervizori. Mostrat që do të testohen në laborator duhet të dërgohen me kujdes nga Kontraktuesi në një laborator të pranuar.

Rezultatet e testeve laboratorike dhe atyre në terren mbahen në terren dhe kopje të dyta të raporteve të të gjitha testeve i dërgohen Supervizorit.

Frekuenca e testeve dhe numri i mostrave të kërkuara bëhen nën drejtimin e rezultateve të testeve të mëparshme, ku gjatë testeve bëhet e ditur cilësia e materialeve dhe uniformiteti i kësaj cilësie.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Nëse ka të dhëna që po dëmtohet cilësia e betonit, Supervizori mund të kërkojë marrjen e mostrave shtesë si dhe krijimin dhe testimin e kubikëve për testim për të përcaktuar shkakun.

Baza kryesore e kontrollit bëhet duke krahasuar rezultatet e provave nën presion të kubikëve për 28 ditë me përjashtim të sasive të vogla të betonit, qëndrueshmëria e të cilëve mund të përftohet në mënyrë tjetër dhe lejohet për përdorim nga Supervizori. Dyzet kubikë me mostra vendosen fillimisht në 8 mostra çdo ditë gjatë 5 ditëve të betonimit dhe më pas një mostër për 25 m^3 betoni por jo më pak se një mostër për çdo ditë betonimi.

Kur materialet janë të një niveli apo lloji të panjohur, testet e ngjeshjes kryhen për 7 ditë dhe bëhen ndryshimet përkatëse para metodave kryesore të kontrollit hartuar më lart.

Referohen kodet e mëposhtme të testimit:

- Testet EN933 për veçoritë karakteristike të inerteve
- Testet EN12350 për betonin e sapokrijuar
- Testet EN12390 për betonin e ngrirë
- Testet EN 12504 për betonin në Struktura

Rezultatet e testeve të cilindrave apo kubikëve shqyrtohen në mënyrë individuale për 10 setet e njëpasnjëshme me nga katër secili dhe llogaritet devijimi standard dhe qëndrueshmëria mesatare për çdo set. Proporcionet e përzierjes së betonit do të pranohen vetëm nëse përmbushen kërkesat në vijim:

- Jo më shumë se 2 rezultate nga 40 janë më pak se qëndrueshmëria karakteristike e ngjeshjes.
- Asnjë vlerë e mesatares për çdo set të katër rezultateve nuk është më e vogël se qëndrueshmëria karakteristike plus gjysmën e marzhit të projektimit.
- Pasi të jenë marrë 40 rezultate dhe pasi të jetë llogaritur qëndrueshmëria mesatare dhe devijimi standard, qëndrueshmëria mesatare minus 1.64 herë devijimin standard duhet të jetë më e madhe se qëndrueshmëria karakteristike.

Kur rezultatet nuk janë në përputhje me kërkesat e mësipërme, në përzierje bëhen ndryshime për të siguruar qëndrueshmërinë e duhur.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Në rastin kur një rezultat është më i vogël se 80% e qëndrueshmërisë karakteristike, konsiderohen ndryshime ndërtimore dhe merren masa sipas urdhrave të Supervizorit.

- **Hekuri**

Shufrat e përforcimit duhet të jenë të nivelit B500B ose B500C deri në BS4449, armimi duhet të jetë në përputhje me Llojin A të BS4483.

Standardet ekuivalente në përputhje me EN 10080 mund të paraqiten për miratim.

Kontraktuesi duhet të marrë nga furnizuesit e tij dëshmi të veçorive mekanike dhe fizike të armimit dhe tëia paraqesë ato Supervizorit për miratim.

- **Vizatimet**

Kontraktuesi duhet të përgatisë dhe të paraqesë vizatimet me detajet e armimit për rishikim dhe miratim, duke përfshirë skicat për vendosjen e shufrave, diagramet për vendosjen e shufrave dhe planet për përkuljen e shufrave.

Vizatimet e detajeve të përforcimeve të Kontraktuesit duhet të tregojnë qartë detajet e domosdoshme të tilla si sasitë, format, gjatësitë, përmasat dhe peshat e shufrave dhe mbivendosjeve, për të kontrolluar shufrat gjatë vendosjes dhe për përdorim në përcaktimin e vlerave monetare.

Vizatimet e detajeve të armimit të Kontraktuesit duhet të jenë të qarta, të lexueshme, të sakta dhe të kontrolluara nga Kontraktuesi para paraqitjes së tyre. Vizatimet e pranueshme të detajeve të armimit do të rishikohen nga Supervizori për saktësinë e projektimit të përgjithshëm dhe për të kontrolluar dimensionet. Gabimet, pakujdesitë ose korrigjimet shënohen në kopje të printuara dhe një kopje për çdo skicim i kthehet kontraktuesit për korrigjim. Kontraktuesi bën të gjitha korrigjimet e nevojshme të paraqitura në kopjet e printuara të kthyera dhe vizatimet e korrigjuara i paraqet si më parë. Ky rishikim dhe miratim nuk e përjashton kontraktuesin nga përgjegjësia e tij për saktësinë e detajeve apo për përputhjen me kërkesat e specifikimeve përkatëse.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

- **Ruajtja**

Hekuri duhet të ruhet në terren nën mbulesë dhe i vendosur me rregull në mënyrë të tillë që të dallohet qartësisht. Mbajtëset duhet të jenë të tilla që të shmangin dëmtimin e çelikut dhe të pengojnë ndotjen dhe gërryerjen.

- **Përkulja dhe Fiksimi**

Kontraktuesi duhet të sigurojë në Terren, mjete për prerjen dhe përkuljen e armimit pavarësisht faktit nëse ai ka kërkuar apo jo kryerjen e përforcimit dhe duhet të sigurojë që në terren të vendoset një sasi simbolike e shufrave të drejta për tëi përkulur në rastet kur kërkohet nga Supervizori.

Armimi duhet të pastrohet dhe të fshihet me shpenzimet e Kontraktuesit, para dhe/ose pas vendosjes së saj në pozicion, sipas kërkesave të Supervizorit.

Para montimit ose fiksimit të armimit, Kontraktuesi kontrollon në përputhje me të dhënat në Vizatimet përkatëse dimensionet sipas të cilave ky material është përkulur.

Armimi fiksohet në përputhje të plotë me të dhënat në Vizatimet në lidhje me mbulesën, hapësirën dhe pozicionin, dhe Kontraktuesi merr masat e duhura paraprake për të parandaluar zhvendosjen e armimit gjatë vendosjes dhe ngjeshjes së betonit.

Kur është e nevojshme për të mbështetur dhe mbajtur armimin në pozicionin e tij të duhur, Kontraktuesi siguron stola shabllon apo mbajtëse të tjera me shpenzimet e tij. Ai gjithashtu lejon prerjen në gjatësinë e duhur të të gjitha shufrave lidhëse këndore të përfshira në diagramin e shufrave si gjatësi standarde.

Blloqet mbajtëse të betonit të derdhura, mbajtëset plastike dhe metalike, ndenjëset etj. që përdoren për të siguruar trashësinë e duhur mbuluese të armimit, i nënshtrohet miratimit të Supervizorit.

Të gjitha kryqëzimet e shufrave në mure dhe në pllaka dhe të gjitha lidhjet ndërmjet lidhëseve dhe shufrave kryesore në kollona ose berma duhet të lidhen me tela hekuri të butë ose me kapëse

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

fiksuese të cilat nuk duhet të hyjnë në kontakt me armaturën apo të hidhen në mënyrë thelbësore në kapakun e përcaktuar.

Saldimi i armimit në kryqëzimet ose lidhjet e shufrave ndalohet pervec rasteve kur lejohet nga Supervizori. Kur jepet miratimi, saldimi bëhet në përputhje me rekomandimet e Institutit të Saldimit për saldimin e shufrave të armimit për ndërtimin e betonarmesë.

Kur armimi i vendosur duhet të lihet i ekspozuar për një periudhë kohore mbi afatet e parashikuara, ai pastrohet plotësisht dhe të lyhet me llaç fino të pastër.

Kur përdoret armim i galvanizuar, çdo dëmtim i shkaktuar nga galvanizimi, riparohet me anë të një formule të pranuar galvanizimi para fillimit të vendosjes së armimit.

- **Telat lidhës**

Telat lidhës për armimin prej çeliku duhet të kenë diametër 1.6mm ku, telat prej çeliku të butë e të temperuar duhet të jenë në përputhje me BS 1052.

- Pjesët lidhëse

Pjesët lidhëse duhet të jenë të përshtatshme për llojin dhe madhësinë e shufrave të armimit dhe të sigurojnë 115% të qëndrueshmërisë karakteristike të shufrave më të vogla të armimit të bashkuara si në tërheqje ashtu edhe në ngjeshje. Pjesët lidhëse vendosen në përputhje me rekomandimet e prodhuesit. Shufrat e armimit në formë katrore të përdredhur nuk duhet të përdoren me këto pjesë lidhëse.

Kontraktuesi duhet tëi paraqesë Supervizorit detajet e pjesëve lidhëse të propozuara për të marrë miratimin e tij paraprak.

- **Kallëpet e betonit**

Termi "kallëp betoni" përdoret për të përfshirë qendërzimin, derdhjen në kallëp të betonit, vendosjen e brezit forcues, lidhjen përforcuese dhe të tjera të ngjashme si këto.

Kontraktuesi duhet tëi paraqesë Supervizorit për miratim propozimet e tij mbi kallëpet e betonit para procesit të betonimit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Kallëpi i betonit duhet të ketë saktësi, qëndrueshmëri dhe ngurtësi të tillë që të mbartë peshën dhe presionin e betonit që do të vendoset mbi të apo ndaj tij, së bashku me elementë të tjerë ndërtimorë, erëra apo ngarkesa të tjera që mund të transmetohen në të, pa dëmtuar betonin me sipërfaqe të lëmuar më shumë se tolerancat e lejuara.

Faqet e kallëpit të betonit duhet të jenë të pastra, pa gozhda të dala, llaç fino të ngjitur dhe mangësi të tjera apo defekte që do të pengonin krijimin e sipërfaqes së lëmuar. Faqet e kallëpit të betonit duhet të trajtohen me bojë të pranuar kundër mykut para vendosjes së tyre. Vëmendje e veçantë duhet tëi ushtrohet parandalimit të ndotjes së armimit ose kallëpit prej çeliku nga boja gjatë krijimit të kallëpeve të betonit.

Kallëpet e betonit të cilat si rezultat i përdorimit të zgjatur apo dëmtimit të përgjithshëm, sipas mendimit të Supervizorit nuk plotësojnë kërkesat e veçanta të përcaktuara në këtë pjesë, nuk duhet të përdoren.

Kutitë për formimin e vrimave duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që të hiqen lehtësisht pa dëmtuar betonin gjatë heqjes. Ato duhet të ajrosen në mënyrë të mjaftueshme për të mundësuar daljen e ajrit të ndrydhur dhe duhet të jenë të izoluara, dhe për rrjedhojë të pengojnë humbjen e llaçit fino. Përveç se me lejen e Supervizorit, nuk lejohet përdorimi i blloqeve prej polistireni për formimin e vrimave apo gropave.

Kallëpet e betonit duhet të jenë të tillë që të mundësohet heqja e tyre pa dëmtuar betonin dhe në rastin e dyshemesë pezull, të hiqen pjesët anësore të arkitrarëve dhe pjesët e poshtme të pllakave pa dëmtuar dërrasat e pjesës fundore të arkitrarëve dhe shtyllat e tyre.

Para betonimit, zonat që synohet të marrin betonin duhet të jenë pastruar nëpërmjet shkarkimit të ajrit të ndrydhur dhe largimit të të gjitha materialeve të huaja dhe ujërave.

Kur druri përdoret për kallëpe betoni, ai duhet të jetë tharë siç duhet, pa shtrembërime, i drejtë, i pastër dhe pa nyje të liruara.

Në rastin kur për kallëpet e betonit përdoren forma metali, këto forma duhet të jenë të përforcuara nga delle të ndërmjetme ose lidhje përforcuese të kryqëzuara.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Kallëpet e betonit të lëvizshme mund të përdoren vetëm kur konsiderohen të përshtatshme sipas Supervizorit.

- **Tolerancat**

Përveç rastit kur paraqiten ndryshe në Vizatime, tolerancat e betonit me sipërfaqe të lëmuar në lidhje me dimensionet e paraqitura në Vizatime nuk duhet të jenë më të larta se limitet e përcaktuara më poshtë:

Tabela 1: Tolerancat e Dimensioneve për Betonin me Sipërfaqe të Lëmuar

Artikujt =	**Toleranca**
Nivelet dhe dimensionet e përgjithshme	5 mm
Përmasat e Kolonës Përmasat e Arkitraut Përmasat e Murit	5 mm
Vijat vertikale të murit të papeshuar	5 mm në çdo 15 m lartësi
Nivelet dhe dimensionet e përgjithshme	5 mm

Dimensionet e betonit me sipërfaqe të lëmuar nuk duhet të jenë më të vogla se ato të paraqitura në Vizatimet.

- **Hedhja ne objekt dhe Ngurtesimi i Betonit**

Betoni me sipërfaqe të lëmuar duhet të jetë i ngjeshur, i qëndrueshëm, i papërshkueshëm nga depërtimi i ujit, pa plasaritje dhe zgavra, dhe rezistent ndaj plasaritjeve dhe goditjeve të zbutura kimike.

- **Transportimi**

Betoni transportohet në vendin e depozitimit përfundimtar me anë të mjeteve të miratuara.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Karrocat e dorës, lopatat dhe pajisje të tjera që përdoren në procesin e transportimit të betonit duhet të pastrohen plotësisht çdo ditë para fillimit të punës apo pas një ndërprerjeje të gjatë dhe në to nuk duhet të ketë beton të ngrirë.

Betoni duhet të transportohet sa më shpejt pas përzierjes, me anë të metodave që pengojnë veçimin, humbjen apo ndotjen e elementëve përbërës.

Është e nevojshme të ndërtohen mjetet e duhura lidhëse në lidhje me lëvizjen mbi armim me qëllim që armimi të mos prishet, dëmtohet apo zhvendoset.

Kur merret miratimi për pompimin e betonit, duhet të ndiqen rekomandimet e prodhuesit të pompës. Pompat e përdorura duhet të kenë kapacitet dhe fuqi të mjaftueshme për të siguruar furnizimin e vazhdueshëm. Kontraktuesi duhet të sigurojë pajisjet e duhura alternative për transportin e betonit në rastin e thyerjes së pajisjeve të pompimit.

Kur transporti i betonit ndërpritet për ndonjë periudhë të caktuar kohe (periudhat kohore prej një gjysmë ore do të trajtohen si të tilla) transhetë, pompat, tubacionet dhe mjete të tjera të shpërndarjes shpëlahen dhe pastrohen. Ato shpëlahen gjithashtu menjëherë para rifillimit të betonimit dhe nuk duhet të kenë beton të ngrirë. Ujërat e përdorura duhet të shkarkohen jashtë armaturës dhe larg çdo betoni të sapo vendosur.

- **Hedhja dhe Ngjeshja**

Betoni nuk vendoset deri në momentin që kontraktuesi të ketë marrë miratimin e Supervizorit. Kur Kontraktuesi ka si qëllim të vendosë betonin, ai njofton menjëherë Supervizorin në kohë të mjaftueshme për tëi mundësuar studimin dhe inspektimin e armimit, elementeve të ngulitur të kallëpeve prej betoni dhe sipërfaqen në të cilën do të vendoset betoni, gjë që për këtë Inspektim, Kontraktuesi duhet të sigurojë të gjitha lehtësitë e mundshme.

Betoni duhet të vendoset brenda 30 minutave të përzierjes, në nivel të njëtrajtshëm, në shtresa me thellësi jo më të madhe se 500mm në mënyrë të tillë që të shmangë veçimin, dhe çdo shtresë duhet të ngjishet me anë të vibratorëve të miratuar për të formuar një material të ngjeshur pa zgavra dhe pa mangësi të tjera. Ngjeshja manuale mund të bëhet vetëm me miratimin paraprak të Supervizorit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Koha e vibrimit, rrezja efektive e veprimit dhe karakteristikat e tjera të vibrimit duhet të jenë në përputhje me rekomandimet e prodhuesit të vibratorit.

Nëse përdoren vibratorë të brendshëm, atyre u hiqet uji menjëherë ose në sipërfaqen e betonit fillon të krijohet një shtresë e hollë llaçi. Largimi ujit duhet të bëhet ngadalë për të shmangur krijimin e zgavrave.

Në rastin kur dy seri betoni të dallueshme, të vendosura në periudha të ndryshme dhe që përbëjnë pjesë të të njëjtit betonim, nevojitet të lidhen në mënyrë monolite me njëra tjetrën, në betonin më të maturuar bëhet vibrimi në thellësi të mjaftueshme për të kryer lëvizjen plastike ndërmjet dy serive. Në rastin kur betoni nuk i përgjigjet veprimit të vibratorit, konsiderohet se është ngrirë, dhe nuk lejohet vibrim i mëtejshëm. Nëse nuk kërkohet ndryshe nga Supervizori, situata trajtohet si për "ndërprerje punimi" dhe bashkimi i dy betoneve do të bëhet vetëm kur dy betonet të jenë ngrirë siç duhet.

Nëse përdoren vibratorë të jashtëm, kallëpet e betonit duhet të jenë mjaft të fortë për tëi rezistuar forcave të vibrimit.

Ndërprerjet e përhershme ose të përkohshme të punës bëhen vetëm në pjesën fundore të ndërprerjes Nëse nuk përcaktohet ndryshe, para vendosjes së betonit të ri përkundrejt betonit që tashmë është ngrirë, ana e betonit më të vjetër përgatitet duke i hequr çdo shtresë të dobët çimentoje dhe inertet e shkrifëruara, dhe pastrohet nëpërmjet shkarkimit të ajrit të ndrydhur.

Tabela.2: Shembjet standarde para vendosjes

Lloji i Strukturës së Betonit	**Shembja**
Strukturat Mbajtëse të Lëndës së Lëngshme	75mm
Strukturat Mbajtëse të Lëndës jo të Lëngshme (Të përgjithshme)	100mm
Strukturat Mbajtëse të Lëndës jo të Lëngshme (Të groposura)	150mm
Beton Homogjen në Transhetë e	75mm

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Kanalit Shkarkues	
Beton homogjen (i përgjithshëm)	150mm

- **Betonimi nga lartesi te medha**
- **Kufizimet**

Çdo lartësi më e madhe se 2.5 m nga e cila derdhet betoni në kallëpe për të formuar pjesët e murit, do të analizohet sipas termave të kësaj Pjese.

Hedhja e betonit nga lartesia nuk lejohet kur shufrat përforcuese duhet të vendosen më afër se 100 mm me njëra tjetrën në çdo drejtim ose, kur hapesira ndermjet shufrave apo shtresave te armimit (ose në rastin e mureve të përforcuara në mënyrë individuale ndërmjet armimit dhe kallëpeve të betonit) është më e vogël se 200 mm.

Metoda përdoret vetëm kur pjesët e provave nxjerrin në pah faktin se, sipas Supervizorit, kjo metodë mund të përdoret në mënyrë të suksesshme, ku në këtë rast zbatohen kërkesat e këtij Specifikimi me përjashtim të rastit kur nuk përputhen me kërkesat e kësaj pjese të veçantë, rast në të cilin mbizotërojnë këto të fundit.

Për të parandaluar veçimin e inerteve, planifikohet përzierje betoni për lidhjen e përforcuar, ose, sipas rastit, duke u bazuar në nivelimin e gropave. Për të arritur këtë qëllim mund të përdoret aditivi i miratuar (pjesa 3.2.4).

Në të njëjtën kohë, përzierja duhet të jetë e tillë që të kufizojë sasinë e rrjedhjes se betonit, dhe ku sipas Supervizorit, sasia e ujit që rrjedh lirshëm dhe arrin në sipërfaqe është mbi parametrat përkatës, bëhet ndryshimi i përzierjes para vazhdimit të të betonimit.

Me qëllim që të kompensohet rritja e raportit ujë-çimento në nivelet e larta, Supervizori mund të kërkojë ndryshimin e përzierjes së betonit për depozitimet e sipërme.

Ulja e konusit nuk duhet të jetë më e madhe se 80mm.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

- **Armimi**

Me qëllim që armimi të mos dëmtohet ose zhvendoset gjatë ndërtimit kur hyn apo del nga kallëpet, të gjitha kryqëzimet prej çeliku në drejtimin vertikal dhe horizontal duhet të mbërthehen siç duhet.

Të gjitha pengesat e shkaktuara nga ndenjëset apo blloqet ndarëse duhet të eliminohen për të lejuar kalimin pa pengesa të betonit në pjesën fundore të kallëpit. Kontraktuesi mund të përdorë rondela rrëshqitëse prej druri në vend të blloqeve ndarëse plastike apo prej betoni të fiksuar për vendosjen e armimit.

- **Ngjeshja**

Ngjeshja bëhet kur është e mundur në mënyrë manuale duke përdorur vibratorët brenda kallëpit. Kur një gjë e tillë nuk mund të bëhet, vibratorët lihen në pozicion të varur në numër të mjaftueshëm për të siguruar ngjeshjen e njëtrajtshme në të gjithë gjatësinë e murit që merr betoni, pa pasur nevojën e tërheqjes së tyre dhe ri-përfshirjen. Mjetet e lënies në pozicion të varur duhet të jenë të tillë që vibratorët të ngrihen në mënyrë sistematike dhe progresive ndërkohë që vazhdon betonimi për të siguruar se çdo seksion i betonit të vendosur bashkohet me seksionet në afërsi dhe ato në themele.

Nuk lejohet përdorimi i vibratorëve për të ri pozicionuar betonin e depozituar. Vibratorët në sipërfaqe ngjitur me kallepin mund të përdoren vetëm për të shtuar mjetet kryesore të ngjeshjes.

- **Vrimat, Zgavrat dhe Fiksimi**

Kontraktuesi është përgjegjës për koordinimin e të gjitha kërkesave të nën-kontraktuesve të tij në lidhje me sigurimin e vrimave, gdhendjeve, zgavrave dhe fiksimeve dhe nëse kërkohet nga Supervizori, duhet të përgatisë vizatime me detaje të kërkesave të tij dhe nën-kontraktuesve të tij dhe duhet tëi dërgojë Supervizorit kopje të këtyre vizatimeve para ndërtimit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Vrimat, etj duhet të shënohen me saktësi dhe të vendosen në formë drejtkëndore para fillimit të betonimit, dhe pa miratimin paraprak të Supervizorit, asnjë vrimë e tillë, etj. nuk mund të modelohet pas ngrirjes së betonit.

Kur shufrat, nëse janë vendosur në hapësira të përcaktuara bllokojnë vrimat me madhësi më të vogël se 250mm x 250mm gjatësia e plotë e shufrës zhvendoset në njërën anë dhe në rastin e vrimave që janë më të mëdha se 250mm x 250mm, shufrat priten në vend dhe mbivendosen në shufra të njëjta shtesë, ose në një mënyrë tjetër të paraqitur në Vizatime.

Kur është e mundur duhet të vendosen të gjithë gypat, hekurat, etj. te cilat kalojnë në muret dhe dyshemetë dhe këto gypa dhe hekura fillimisht duhet të pastrohen plotësisht dhe të mos kenë asnjë lëndë të dëmshme, dhe gjithashtu merren masat për të siguruar se ato inkasohen plotësisht në beton.

Bulonat, kanxhat dhe fiksime të tjera duhet të nguliten në beton ose vrimat shpohen dhe pajisen me punto të filetuara për të futur bulonat. Kontraktuesi duhet të sigurojë se bulonat, kanxhat etj. janë vendosur me saktësi. Bulonat e varur për makineritë përcaktohen si mostra.

Kur muraturat prej guri ose tulle duhet të krijojnë një veshje të betonit apo ku pjesa fundore e muraturës prej guri ose tulle ndeshet me faqen e betonit, duhet të përfshihet lidhje metalike e galvanizuar e prodhimit të miratuar BS 1243. Distanca ndërmjet lidhjeve duhet të matet me shumë kujdes për bashkimin e mureve, dhe në intervale të përcaktuara nga Supervizori.

- **Mbrojtja dhe Ngurtesimi**

Kontraktuesi duhet të sigurojë mbrojtjen e betonit të sapo vendosur, nga shiu, erërat e thata dielli dhe lëndët të cilat mund të ndikojnë negativisht në të.

Nuk lejohet lëvizja ose vendosja e ngarkesave mbi betonin e sapo vendosur deri kur të jetë ngurtësuar në mënyrë të mjaftueshme për të përballuar këtë lëvizje apo ngarkesë pa dëmtuar ose shformuar sipërfaqen e betonit.

Pajisja për ngrirjen dhe mbrojtjen e betonit duhet të funksionojë në vendndodhjen e çdo betoni para fillimit të vendosjes së tij.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Sipërfaqja e zbuluar e betonit e cila është lustruar, duhet të mbrohet nga rrezet e drejtpërdrejta të diellit të paktën për dy ditë pas vendosjes. Betoni i sapo vendosur duhet të mbrohet nga dëmtimi i shkaktuar nga reshjet.

Sipërfaqet e zbuluara duhet të mbahen të lagështa ose duhet të parandalohet avullimi i lagështirës në beton pas vendosjes me anë të spërkatjes së vazhdueshme me ujë, ose me metoda të tjera të miratuara nga Supervizori. Ngrirja bëhet për 4 ditë në kushte normale dhe minimalisht për 7 ditë në mot të nxehtë ose kushte erërash të thata.

Kujdes i veçantë duhet treguar për të mos dëmtuar armimin me çelik të dalë nga çdo vendosje të paktën për 24 orë pas përfundimit të kësaj vendosje.

- **Betonimi në mot me lagështirë**

Gjatë periudhave të shirave të vazhdueshme, betonimi nuk lejohet nëse nuk mbulohen siç duhet materialet e grumbulluara, përzierësit, dhe mjetet e transportit, si dhe zonat që do të betonohen.

Gjatë rënies së shirave, Kontraktuesi duhet të sigurojë se puna do të përfundojë pas njoftimit të menjëhershëm të sigurimit të skajeve bllokuese. Për asnjë arsye, puna nuk konsiderohet e përfunduar pa u mbyllur çdo seksion ndërmjet pajisjeve të tilla. Për të mbrojtur nga shiu betonin e sapo vendosur duhet të sigurohen mbulesa të përshtatshme.

- **Betonimi në mot të ftohtë**

Kushtet e motit të ftohtë do të konsiderohen të efektshme kur temperatura ditore mesatare të bjerë nën 5°C.

Temperatura e betonit kur vendoset në mot të ftohtë, duhet të jetë si më poshtë:

- Beton kompakt, jo më pak se 7°C,
- Beton ndërtimor, jo më pak se 10°C,
- Strukturat më të holla se 300mm, jo më pak se 13°C.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Kur temperaturat janë mbi 10°C gjatë një periudhe më të madhe se gjysma e periudhës 24 orëshe, betoni nuk konsiderohet më si "beton dimri", dhe për rrjedhojë zbatohet praktika normale e betonimit.

Kontraktuesi duhet të zbatojë masat paraprake në vijim:

- Betonim vetëm gjatë ditës
- Kontraktuesi duhet të sigurojë se temperatura e vendosjes së betonit është siç shprehet më lart
- Inertet nuk duhet të kenë akull para përzierjes
- Të mos bëhet vendosje e betonit në terren të ngrirë
- Kallëpi duhet të ngrohet
- Ngrohja e ujit
- Ngrohja e inerteve, në asnjë pikë temperatura e inerteve nuk duhet të jetë më e lartë se 100^0C. Temperatura mesatare e inerteve për çdo grupim më vete nuk duhet të jetë më e lartë se 65^0C.
- Aditivi
- Minimalisht 24 orë mbrojtje nga ngrirja e betonit të sapo vendosur duke përdorur mbulesa termike apo metoda të tjera
- Izolimi i betonit
- Shembje më e ulët se parametrat normalë për të minimizuar rrjedhjen dhe për të pakësuar kohën e ngrirjes
- Teste shtesë me kubikë për të optimizuar kohën e dizarmimit të kallëpit

Gjatë motit të ftohtë, të gjitha sipërfaqet e betonit duhet të mbulohen menjëherë pas vendosjes së betonit me qëllim që nxehtësia të mbetet brenda dhe të parandalohet ngrirja nga temperaturat e ulëta. Mund të përdoren shtresa kashte të pastra, mushama, pëlhurë e gomuar, polistiren me shkumë, pllaka plastike dhe të padepërtueshme nga uji në lidhje me gropat ajrore si udhëzues. Nëse është e mundur, materiali izolues vendoset mbi çdo kallëp para betonimit dhe i njëjti material mund të përdoret si shtresë mbrojtëse pas dizarmimit të kallëpit.

Gjatë vendosjes së betonit të pamodeluar, ngjitur me vendosjen e betonit vendosen mushama ose mbulesa të tjera mbi kallëp që hiqen menjëherë, në mënyrë që në çdo moment të zbulohet ndaj ajrit vetëm një pjesë e pllakave të lëmuara. Këto mbulesa mushamaje përdoren me qëllim që ajri

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

i nxehtë të qarkullojë lirshëm në pllakë. Gjithashtu njësoj efektive për mbrojtjen e betonit janë shtresat prej materialesh izoluese që vendosen drejtpërdrejt mbi beton.

Kontraktuesi duhet të ruajë betonin e përshkruar më lart të paktën për 7 ditë përveç rastit kur Punëdhënësi miraton ndryshe.

Bazuar në ashpërsinë e motit, duhet të merren masat paraprake si më poshtë:

- Kur temperatura është nën 5 C por nuk bie nën pikën e ngrirjes.
- Mbajtja e kallëpit në pozicion për një kohë më të gjatë, ose përdorimi i çimentos që ngurtësohet menjëherë;
- Mbulimi i pjesës së sipërme të betonit me material izolues;
- Izolimi i kallëpit; dhe
- Sigurimi se betoni është shpërndarë në pikën e vendosjes në temperaturë jo më të vogël se 5C
- Kur ka ngricë natën:
- Merren të gjitha masat paraprake përshkruar më lart
- Të sigurohet se betoni nuk është vendosur në temperatura ngrirjeje nën 0C apo në armim ose kallëpe të mbuluara me dëborë ose akull; dhe
- Të vendoset betoni menjëherë dhe të izolohet.
- Kur ka ngricë të fortë ditën dhe natën
- Anulohen të gjitha operimet e betonimit
- Betonimi në mot të nxehtë

Kërkesat e kësaj Pjesë zbatohen kur temperatura e ajrit është mbi 20C.

Betonimi nuk lejohet nëse temperatura e tij gjatë vendosjes është më e lartë se 26C. Me qëllim që të ruhet temperatura e betonit nën këtë vlerë, merren masat paraprake në vijim, pjesërisht ose tërësisht, sipas udhëzimeve të Supervizorit:

- I gjithë stoku i grumbulluar i inerteve, linjat e ujit dhe objektët si dhe përzierësi duhet të mbrohen nga rrezet e drejtpërdrejta të diellit;
- Inertet e ashpra duhet të ftohen nëpërmjet spërkatjes së vazhdueshme me ujë kur është e mundur;
- Uji për përzierje duhet të ftohet nëpërmjet shtimit të akullit në objekt kur është e nevojshme;

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

- Çimentoja me ngurtësim të menjëhershëm nuk duhet të përdoret;
- Kur masat paraprake të mësipërme janë të pamjaftueshme, betonimi duhet të kryhet gjatë periudhave më të ftohta të ditës ose gjatë natës sipas udhëzimeve të Supervizorit.

Kur temperatura është mbi 20C, humbja e ujit për përzierje nëpërmjet avullimit bën të nevojshme shtimin e ujit në këtë përzierje. Në këtë përzierje shtohet një agjent i miratuar për pakësimin e ujit me qëllim që të ruhet raporti ujë/çimento brenda limiteve të lejueshme.

Me qëllim që të zvogëlohet tharja e parakohshme e betonit gjatë transportimit dhe vendosjes, të gjitha transhetë, kallëpi dhe armimi ftohen nëpërmjet spërkatjes me ujë kur është e mundur, ose në të kundërt mbrohen nga rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Çdo sasi uji e përdorur në këtë mënyrë largohet nëpërmjet shkarkimit me ajër të kompresuar dhe para vendosjes së betonit në kontakt.

- **Gabionet dhe rrjetat kuadratike**

Kontraktuesi duhet të përdorë gabione me përmasa jo me shume se 1m x 1m x 2m të gjata, Ato duhet të kenë tela anësorë të fortë në gjithë gjatësinë e skajeve të paneleve që të lidhen së bashku me unazat lidhëse. Teli i paneleve duhet të lidhet në mënyrë të sigurtë në pjesët anësore.

Pjesët e rrjetës metalike duhet të fiksohen në gabione në mënyrë të tillë që gjerësia ose gjatësia e kompartimenteve të krijuara të mos jetë më e madhe se një metër. Rrjeta duhet të lidhet me telin anësor me anë të unazave dhe makinerisë në mënyrë të tillë që ngarkesa e nevojshme për të ndarë rrjetën nga teli anësor të mos jetë më e vogël se qëndrueshmëria e rrjetës.

Për raste të veçanta prodhohen gabionet trapezoidale të nevojshme për ndërtimin e mureve të rrafshëta të zgjeruara në bazament. Kontraktuesi duhet të riparojë vetëm në Terren gabionet kur numri i tyre për riparimin përkatës është i vogël dhe riparimet mund të arrihen thjesht dhe në mënyrë të kënaqshme nëpërmjet prerjes dhe palosjes me qëllim që gabionet e krijuara të mos kenë qëndrueshmëri dhe performancë më të vogël në krahasim me gabionet e pariparuara.

Kontraktuesi duhet të provojë material mbushës me gurë të miratuar për mbushjen e rrjetave gabion. Gurët duhet të jenë të ngjeshur, të fortë, rezistent ndaj abrazionit dhe të kenë vlerë maksimale të Testit të Abrazionit Los Angeles jo më shumë se 30 (EN 1097-8). Copëzat e

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

gurëve nuk duhet të kenë plasaritje, vraja dhe defekte të tjera që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e gurëve ndaj efekteve të motit.

Gurët duhet të jenë prej materiali të niveluar mirë me madhësi pjesëze ndërmjet 100mm dhe 200mm dhe 300mm me tolerancë maksimale prej 5% jashtë këtyre limiteve (si gurët me madhësi më të madhe, ashtu edhe ato me madhësi më të vogël) me kusht që asnjë gurë të mos ketë asnjëherë madhësi të tillë që të depërtojë rrjetat gabion.

Gurët vendosen në lartësi 300 mm për gabionet me lartësi 1m, dhe 250mm për gabionet me lartësi 0.5m. Shtresa e mbushur nuk duhet të jetë më shumë se 300mm më e lartë se çdo hojëz ngjitur me të.

Gurët vendosen me dorë ose me makineri të lehta. Nëse vendosen me makineri, gurët sistemohen të ngjeshur dhe pas punimit të majave të tyre sistemohen në mënyrë manuale. Pas vendosjes në hojëz të një shtrese me gurë, gurët sistemohen në mënyrë të mjaftueshme me dorë për të minimizuar boshllëqet e krijuara dhe për të arritur ngjeshje maksimale të gurëve në gabion.

Përforcuesit ose lidhje të kryqëzuara të brendshme instalohen për të lidhur faqet ballore dhe të pasme të çdo faqeje të mbështetur ose të zbuluar në pikat e treta vertikale për gabionet me lartësi 1m, gjatë kohës që hojëza është duke u mbushur. Njësitë e gabioneve të vendosura në pjesët fundore të murit, të cilat kanë dy pjesë të zbuluara, përfshijnë gjithashtu një grup lidhjesh të kryqëzuara të vendosura pingul me faqen anësore të zbuluar.

Kur vendoset më shumë se një shtresë vertikale e gabioneve, njësitë mbushen së tepërmi afërsisht në 25-40mm për të lejuar uljen e natyrshme.

Kontraktuesi paraqet mostra të gurëve, të cilat i propozon për përdorim në gabione pas miratimit të marrë nga Supervizori. Kontraktuesi paraqet gjithashtu mostra të gabioneve dhe rrjetave gabion për të marrë miratimin e Supervizorit.

Kontraktuesi grupon dhe ndërton gabione dhe rrjeta gabion në përputhje me Specifikimet e prodhuesit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

Kontraktuesi siguron se rrjetat gabion vendosen në skarpata 1:1.5 apo më të pjerrëta me piketa kryq ose kunja druri të ngulitura në tokë brenda panelit të fundit të sipërm 2.0m nga qendra ose sipas udhëzimeve të Supervizorit.

- **Gabionet me rrjet metalik special (monotek) saldim me kontakt**

Gabionet me rrjet metalik special (monotek) e me saldim me kontakt prodhohen nga rrjeta metalike katerkëndore të galvanizuara nëpërmjet mbështjelljes me shtresë zinku.

Teli i përdorur duhet të jetë në përputhje me kërkesat e ISO 10544 dhe i galvanizuar në përputhje me ISO 7989-2.

Diametri i telit të rrjetës duhet të jetë 3.5mm me fortesi 470 n/mm2.. Rrjeta kuadratike nuk duhet të jetë më shumë se 80-100 mm ndërmjet boshteve te telit te gabionet.
Ndertimi penelave mbrojtes te mbeshtetur mbi nje skoliere me gure masive , behet sipas projektit me nje kriter te caktuar , per te ruajtur sadopak nje konfiguracion sa me te rregullt.

Skoliera do realizohet nepermjet hedhjes ne forme te lire te gureve te medhenj (masiv) me volume deri 1 m3 sejcili e peshe deri ne 2 ton,duke mbushur boshlleqet midis tyre edhe me mbeturina gurore

Pas realizimit te skolieres, ndertohet shtresa e pare ,ose shtresa e e poshteme e penelave ne nje lartesi 1-1,5 m , e cila pergjithesisht realizohet me gabiona me gure kave , e me nje rrjete gabioni me rrjet çeliku te tipit monotek me saldime me kontakt e cila ndikon ndjeshem ne elasticitetin e penelave.

Ne funksion te thellesise se vete shtrtait te lumit, per te lehtesuar sa me shume te jete e mundur ndertimin e penelave, duhet mbajtur parasysh qe:

Rreshti i pare i penelit, pra rreshti me gabiona, qe mbeshtetet mbi skolieren (tip prizmi) duhet te realizohet deri ne nje lartesi te mundeshme, jo me poshte se rreth 1,0 m nga niveli maximal i ujit ne kohen e ndertimit. Presupozohet, qe deri ne kete thellesi uji, mund te realizohet (me disa mjete te posaçme), shtresa e pare e gabionave me H deri 1-1.5 m.

Gurët për mbrojtjen nga gerryerjet duhet të jenë në përputhje me specifikimin për mbushjet me gure dhe me Vizatimet e Ndërtimit dhe Specifikimet e Veçanta Teknike.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

- **Punime Çeliku të galvanizuara**

Të gjitha detajet prej çeliku, bulonat, dadot dhe pajisjet mbërthyese të filetuara që janë të nevojshme për galvanizim, pasi janë pastruar tërësisht nga ndryshku dhe ashklat, galvanizohen në përputhje me EN ISO 1461:1999 (Veshjet e galvanizuara në thellësi në të nxehtë për artikujt e prodhuar prej hekuri dhe çeliku). Veshja prej zinku duhet të jetë të paktën 350 g/m^2. Çdo pjesë që është galvanizuar dhe është shtrembëruar gjatë galvanizimit, duhet të drejtohet. Filetimet në bulonat dhe dadot e galvanizuara duhet të modelohen me mjete të përshtatshme dhe bojëra të tilla që e ruajnë pastërtinë e tyre normale pas galvanizimit me anë të mbështjelljes me shtresë zinku të shkrirë.

Pas instalimit në vendin përfundimtar, të gjitha pjesët e dëmtuara të veshjes së galvanizuar pastrohen me rrymë rëre dhe përgatiten si dhe u vishen 2 shtresa me bojë të re zinku të miratuar. Përgatitja e sipërfaqes së punimeve prej çeliku dhe lyerja me bojë bëhet në përputhje me udhëzimet e prodhuesit të bojës.

Kontraktuesi siguron dëshmitë e përputhjes me standardet e mësipërme për të gjitha materialet e galvanizuara të shpërndara në Terren.

- **Pajisjet Mbërthyese**

Pajisjet mbërthyese për punimet e ndryshme metalike që përfshijnë bulonat, ganxhat, vidhat dhe dadot duhet të jenë prej çeliku të paoksidueshëm nëse nuk kërkohet ndryshe.

Gozhdët dhe ganxhat për fiksimin e punimeve metalike në beton duhet të jenë prej çeliku të paoksidueshëm nëse nuk kërkohet ndryshe dhe të jenë të tipit zgjerues (p.sh. Nelson ose Hilti) nëse nuk kërkohet ndryshe.

PËRGATITI:

"SELAS" sh.p.k

Ing. Vladimir Agalliu

SHENIME DHE SPECIFIKIME TEKNIKE TE VEÇANTA PER MENYREN E REALIZIMIT TE MBUSHJEVE TE ARGJINATURAVE MBROJTESE BRI SHTRETERVE TE LUMENJEVE

1. Per realizimin e punimeve te dherave ne germim apo mbushje, ne te gjitha rastet, mepare eshte e detyrueshme te behet perpunimi i bazamenteve duke realizuar se pari skarifikimet, dhe largimet e materialeve te papershtatshem.
2. Mbas shpyllezimit dhe shkuljes se rrenjeve do te realizohet germimi per skarifikimin me trashesi jo me pak se 20 cm i te gjithe siperfaqeve qe zihen nga germimi i zones ku do te krijohen mbushjet ne formen e argjinaturave.
3. Trungjet e pemeve rrenjet dhe dherat e dala nga shpyllezimi dhe skarifikimi per arsye te permbajtjeve mjaft te larta organike nuk do te depozitohen brenda sheshit te ndertimit por do te nxirren e sistemohen jashte kesaj zone.
4. Mbushja per realizimin e argjinatures do te realizohet vetem pasi te jete kryer me pare skarifikimi i gjithe siperfaqes qe do te zihet prej saj sipas pik. 2.
5. Materiali mbushes i argjinatures do te realizohet me nje material mix, i cili do te perfitohet nga perzjerja ne nje mase (*ne %*) te caktuar me dhera argjilore plus ato zhavorore, nje perzierje e tillë, e cila ne trupin e argjinatures duhet te plotesoje keto kerkesa teknike:
   - Pesha volumore e skeletit ɣ =1.6 *gr/cm3*
   - Lageshtia optimale 16 % *(me tolerance ± 5 %)*
6. Paraprakisht ne funksion te materialeve qe do te sigurohen, do te behen prova (kontrolle) me analiza laboratorike per te percaktuar nje raport optimal te perzierjes te dherave argjilore me zhavoret.

   Fillimisht sugjerohet qe të fillohet me nje raport 3:1 (ne baze te nje pervoje te fituar ne objekte te ngjashme) dhe me tej ne funksion te parametrave qe perfitohen nga kjo perzierje pas proves percaktohet raporti i sakte i perzierjes.
7. Pasi jane bere provat laboratorike dhe jane garantuar parametrat e mesiperm mund te filloje mbushja per realizimin e argjinatures.

8. Paraprakisht, ne nje vend depozitimi (ne nje shesh te vecante) do te behet perzierja e materailit, dhe me tej ky material do te transportohet per mbushjen e argjinatures, duke u hedhur ne argjinature me shtresa, me trashesi jo me shume se 20-25 cm.
9. Per te provuar peshen volumore te skeletit te realizuar, per cdo volum prej 2-3000 m3 dhera te ngjeshura ne veper, nga ana e firmes zbatuese duhet te behet nje analize ne nje laborator te specializuar per te konfirmuar peshen volumore te skeletit te realizuar ne fakt, nepermjet tre kampioneve te marre ne zona te ndryshme te zones ku eshte realizuar volumi perkates.

“SELAS” sh.p.k
Projekt – Menaxhim - Konsulta

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania

Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

RELACION TEKNIK

“ PUNIME REHABILITIMI PER MIREMBAJTJEN E DIGES TE REZERVUARIT BOVE, ROSHNIK”

BASHKIA BERAT

TIRANE, KORRIK 2026

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

PËRMBAJTJA:

1. Detyra e projektimit me disa te dhena dhe kerkesat kryesore per hartimin e projektit
1.1.1 Rezervuari Bove
1.1.2 Vlerësimet, nga Autoriteti Kontraktor mbi gjendja aktuale te objekteve dhe disa nga kerkesat kryesore që duhet të zgjidhen nga projekti
2. Një pershkrimi i pergjitheshem dhe vleresimi nga ana inxhinierike e projektit dhe gjendjes se objektit e nenobjekteve te tjera qe lidhen me to
2.1 Nje vleresim i pergjithshem
2.2 Vendodhja dhe vleresimi i disa prej treguesve fiziko- gjeogtrafikë e hidroteknike te objekteve qe trajtohen
3. Disa të dhëna gjeologjike për bazamentin dhe themelet ku është vendosur diga e rezervuarit të Bove
4. Sizmiciteti i zonës
5. Zona e Pellgut shimbledhës
6. Klima dhe reshjet
6.1 Temperaturat
6.2 Reshjet atmosferike
6.3 Regjimi Hidrologjik
6.4 Erërat
6.5 Llogaritjet hidrologjike dhe hidraulike në lidhje me reshjet atmosferike
7. Studimi dhe trajtimi i zgjidhjeve teknike te projektit
8. Volumet kryesore dhe kosto e punimeve

"SELAS" sh.p.k
Projekt – Menaxhim - Konsulta

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania

Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

RELACION TEKNIK

Objekti : PUNIME REHABILITIMI PER MIREMBJTJEN E DIGES TE REZERVUARIT TE BOVËS, ROSHNIK, BASHKIA BERAT

1. DETYRA E PROJEKTIMIT ME DISA TË DHËNA DHE KËRKESAT KRYESORE PËR HARTIMIN E PROJEKTIT.

Projekti për objektin : *"Punime rehabilitimi për mirembajtjen e digës se rezervuarit Bovë, Roshnik, Bashkia Berat,* hartohet duke u bazuar ne detyrën e projektimit dhe specifikime të tjera teknike të shprehura në detyre nga Autoriteti Kontraktues, Bashkia Berat.

Referuar kerkesave kryesore të bera nga autoriteti kontraktor e të përfshira në detyrën e projektimit si dhe ne pershkrimin që i bëhet gjendjes fizike e teknike të diges së ketij rezervuari, midis të tjerash, mund të thuhet se:

1.1- Rezervuari i Bovës: Është projektuar për një kapacitet ujëmbajtës rreth 350 mije m^3 ujë me aftësi ujitëse prej rreth se 120 ha, por aktualisht kapaciteti ujëmbajtës i tij është reduktuar disi për shkak të mbushjes qoftë edhe të pjesëshme të kupës së rezervuarit nga aluvionet.

Rezervuari ka vetëm një digë me gjatësi të digës rreth **230 m,** dhe gjerësi të kurorës prej rreth **5 m.**
Sipërfaqja e rezervuarit në kuotën e nivelit normal të ujit është rreth 6.7 ha.
Përgjatë kurorës së digës duken gjurmë rrotash, çka tregon se ajo (kurora e digës) shërben edhe si rrugë për komunitetin e zonës, megjithëse akualisht kurora e digës nuk është aspak e shtruar as me çakull e as me ndonje material tjetërl.
Diga është e tipit homogjene me mbushje e ngjeshje me material argjilore të gërmuara kryesisht në karrierat në bjefin e sipërm të kupës së rezervuarit.
Mbushja me ujë e rezervuarit realizohet nga vetë pellgu i tij shimbledhës direkt i rezervuarit.
Shkarkimi i ujrave të tepërta nga rezervuari i Bovës është parashikuar dhe bëhet nga një shkarkues katastrofik i tipit "i lirë" me një prag betoni që ndodhet në krahun e majtë të kurorës së digës.
Ky shkarkues duket se ka qënë i veshur me beton, por aktualisht në segmente të caktuara ka mjaftë dëmtime të ndryshme të koritës (seksionit terthor) së këtij shkarkuesi, sa mund të gjykohet se është komplet i dëmtuar përgjatë gjithë gjatësisë së tij.
Kurse ujëlëshuesi është i tipit klasik me "tub çeliku " ndoshta me diameter Fi 400-500 mm me një sistem komandimi nga ana e jashtëme e rezervuarit, ku duket se ka dy saraçineska por që nuk punojnë mirë.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Aktualisht ujëlëshuesi në dalje duket se është pjesërisht i bllokuar.

1-2 Vlerësimet, nga Autoriteti Kontraktor mbi gjendja aktuale te objekteve dhe disa nga kerkesat kryesore që duhet të zgjidhen nga projekti

Sipas vlerësimit nga Autoriteti Kontraktor, gjendja aktuale e fizike trupit të digës rezulton se: **Në përgjithësi nuk ka e nuk ka patur probleme të dukshme të qëndrueshmërie (si rrëshqitje, shkarje apo ulje të dukshme të kurores apo cedime të ndyshme në të dyja skarpatat e digës).**

Ndërkohë që në skarpatat e jashtme vihen re disa vatra të vogla erozionale që shkaktohen edhe nga prezenca e ujrave sipërfaqësore që rrjedhin nga të dyja shpatet (kodrinat) e luginës.

Shkarkuesit e ujrave te ketij rezervuari, si ai me transhe apo edhe ai me tub kanë dëmtime të konsiderueshme sidomos shkarkuesi i katastrofik (shkarkuesi i ujrave te tepërta) që pothuajse e ka shumë të dëmtuar veshjen me beton që ka patur dikur.
Skarpata e brendshme e diges pjesërisht eshte e veshur me gurë, por në disa zona kalldrëmi me gurë është i dëmtuar (shpesh, në zona të caktura edhe mungon fare).
Veshjet me beton në kanalet e mbledhjes së ujrave sipërfaqësore në skarpatat e jashtme janë të dëmtuara si dhe në segmente të caktuara mungojnë fare.
Edhe drenazhet e digës janë praktikisht të padukshme, per shkak te mbulimit nga barerat apo shtresat e ndryshme vegjetale ,
Poshtë digës e kryesisht në të gjithë luginën nën bjefin e poshtëm të saj, deri në një distancë prej afro 2-3 km nuk ka qendra të banuara, me përjashtim të disa kasolleve në fund të skarpatës së digës.
Ky fakt, duhet mbajtur në konsideratë në vlerësimin e elementeve të sigurisë së digave referuar normave shtetërore të sigurisë së projektimit për këto vepra.

Për sa me siper, nga Autoriteti Kontraktor kërkohet :

- *Riparimi dhe venia në funksion e të gjithë elementëve kryesore të dëmtuar të diges*

- *Në mënyrë të veçantë duhen trajtuar riparimet e shkarkuesëve, drenazhet apo element të tjerë si kanalet e mbledhjes se ujrave siperfaqesor për zvogëlimin e ndikimit negativ të tyre në trupin e digave.*
- *Të vlerësohet zhbllokimi i ujlëshuesit apo gjetja e mënyrave të tjera për shfrytëzimin e volumit të ujit në rezervuari, etj.*

Në pergjigje të kerkesave të mesiperme, përgjithesisht, nga subjekti projektues eshte synuar te merren në konsiderate dhe të përfshihen e të trajtohen në projekt të gjitha punimet rehabilituese, duke i vleresuar ato si te domosdoshme edhe në kuadrin e mirembajtjes e rritjes se sigurise te ketyre veprave.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

2. *NJË PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM DHE VLERESIMI NGA ANA INXHINIERIKE E GJENDJES SE OBJEKTIT DHE NENOBJEKTEVE TE TJERA QE LIDHEN ME TO*

2.1 Nje vleresim i pergjithshem per sa me siper :

Nga ana e subjektit projektues është dashur e janë kryer në këto objekte e nënobjekte, një sërë inspektimesh, më së pari për njohjen dhe vlerësimin e gjëndjes së përgjithshme të këtyre objekteve, dhe më tej, për të bërë vlerësimet teknike të problemeve e të dukurive te veçanta që shfaqen në këto nënobjekte mbi bazën e të cilave do të përcaktohen edhe masat më të nevojshme që duhet të merren.

Konkretisht, bazuar në sa me siper, nga ana e firmes projektuese jane bere rikonicionet e nevojshme, eshte bere njohja nga afer me zonen në fjale, jane organizuar takime, biseda e konsulta me specialistet e me drejtues të pushtetit lokal te zones ,etj.

Gjithashtu, jane bere matjet e nevojshme topografike, jane bere llogaritjet dhe vleresimet e situatës nga pikpamja hidrologjike dhe gjeologo-inxhinierike te zones duke terhequr edhe mendime nga specialiste qe jane marre per nje kohe te gjate me projektimin, ndertimin apo shfrytezimin e këtyre veprave etj.

Në këto inspektime janë evidentuar e vleresuar pothuajse gjithçka që lidhet me qëndrueshmërinë dhe shfrytëzimin e këtyre veprave dhe gjendjen e tyre fizike, duke marre në konsiderate edhe rekomandime edhe nga specialiste që janë marrë me projekte të ngjashme por edhe me vetë objektin në fjalë.

Konkretisht nga ana e grupit të projektimit jane evidentuar problemet dhe shqetesimet e ngritura, në detyrën e projektimit, jane bere perllogaritjet e nevojshme hidroteknike dhe mbi kete baze jane nxjerre disa konkluzione e jane përcaktuar disa nga punimet më te domosdoshme qe duhet të realizohen në këtë vepër apo nënvepra, kryesisht në kuadrin e mirëmbajtjes së digës, për rehabilitimin dhe ruajtjen e sigurisë së saj, si dhe për një shfrytëzim më të mirë të mundshëm të kësaj vepre shumë të rëndësishme edhe për Autoritetin Kontraktor dhe komunitetin e kësaj zone në Bashkinë e Beratit.

2- 2 VENDODHJA DHE VLERESIMI I DISA PREJ TREGUESVE FIZIKO-GJEOGRAFIKË E HIDROTEKNIKE TË OBJEKTTIT QE TRAJTOHET

Vendndodhja dhe Pershkrimi i pergjithshem

Diga e Rezervuari të Bovës ndodhet ne Qarkun e Beratit ne Shqiperi.
Ajo ndodhet rreth 20 km ne Lindje te Beratit me koordinatat Gjatesi 40º 73'33'' dhe 20º 03'44'' Lartesi.
Diga e Rez. të Bovës ka nje lartesi max rreth 34 m dhe gjatesi rreth 230 m.
Pozicioni i diges eshte treguar ne fleten perkatese të vizatimit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Detaje per Rezervuarin dhe Digen e Rezervuarit të Bovës si dhe rrjetin ujites qe lidhet me të, jane dhene më poshtë në vijim të këtij Relacioni Teknik.

Konkretisht :

Rezervuari i Bovës, është ndërtuar sipas një projekti të hartuar qysh në vitin 1976-1977 nga ish Instituti i Studimeve Projektimeve te Veprave te Kullimit e Ujitjes (ISPVKU), Tiranë, në këto vite në mvartësi të Ministrisë së Bujqësisë .
Vetë objekti i digës si dhe një rrjet i tërë ujitës janë ndërtuar nga ish Ndermarrja e Bonifikimit Berat dhe janë vënë në punë për herë të pare pas vitit 1978.
Nga rikonjicionet e kryera në këtë objekt, rezulton se trupi i digës në përgjithësi nuk ka probleme të dukshme në lidhje me qëndrueshmërie e digës si dhe filtrimet.
Ndërkohë që në skarpatën e jashtme vihen re disa vatra erozionale, dhe në zona të caktura edhe një bimësi relativisht e dëndur .
Ujëlëshuesi në hyrje nuk mund të vlerësohet pa u boshatisur rezervuari, ndërkohë që në dalje, ai është pjesërisht i bllokuar, sidomos puseta e daljes është e mbushur me aluvione dhe pothuajse e bllokuar.
Edhe shkarkuesi katastrofik nuk është aspak në parametrat e projektit, pasi gjëndja fizike e tij paraqitet e amortizuar, me betone të dëmtura , me skarpata të deformuara etj.
Ndaj, në këtë objekt është e nevojshme ndërhyrja për zgjerim,thellim dhe riveshjen me beton e hekur të seksionit tërthor të shkarkuesit, ndërkohë që elementë të veçanta të shkarkuesit kanë pësuar dëmtime me kalimin e kohës.
Skarpata e brendshme e digës është e veshur me gurë por në disa zona, kalldrëmi me gurë është dëmtuar.
Vizualisht, drenazhet në bjefin e poshtëm të digës nuk duken por edhe ato mund të jenë të bllokuara dhe të mbuluara nga aluvionet apo nga bimësia.
Në afërsi dhe poshtë digës nuk ka qëndër të banuar, por në një distancë fare te afert me digën jane ngritur disa ngrehina Tip hangare (Baraka) kryesisht per bageti ose baxho.
Siç u tha edhen më sipër , nisur nga ky fakt, duhet mbajtur në konsideratë rritja e elementëve të sigurisë së digës për kontrollin dhe monitorimin e digës, referuar edhe normave shtetërore në fuqi të sigurisë për këto vepra.

Diga eshte një dige e tipit homogjene, ndertimi i te ciles ka mundur te krijoji nje rezervuar me një kapacitet ujmbjatës, qe sipas projektit fillestar arrin ne rreth 350 mijë m3. uji
Kurse, sipërfaqja e rezervuarit në TWL (Niveli Normal) është rreth 6.7 ha.
Eshte vertetuar se rezervuari mbushet me uji tërësisht nga pellgu i tij ujëmbledhësi e i drejtpërdrejtë.
Që nga viti 2015, rezervari Bovës menaxhohet nga Bashkia Berat, ne prefekturen e Beratit.
Pergjithesisht, diga e rez. duket në gjendje te mire, pa fenomene të dukshme të rreshqitjeve apo cedimeve të ndryshme në kurorë apo në skarpatat e saj.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Faqja e skarpatës se diges në bjefin e sipërme te rrjedhës ka një pjerrësi rreth 1:2.5 dhe vijon ne 1 : 3 .
Skarpata është e mbrojtur me veshje me gurë e duket që relativisht është në gjendje të mirë, por ka zona te veçante te skarpates se brendshme ku veshja eshte e demtuar.
Skarpata në bjefin e poshtëm të digës ka një pjerrësi që është rreth 1 : 2.5 deri në 1 : 3 dhe ku gjendet edhe një bermë 5 m të gjerë.
Skarpatat, e sipërme dhe ajo e poshtme, të digës janë të rregullta pa ndonjë element paqëndrueshmërie, por ne skarpaten e bjefit te poshtem në shume zona ka fenomene te erozionit dhe demtime të veshjes me beton të kanaleve te mebledhjeve e largimit te ujrave siperfaqesore.
Nga ujrat siperfaqesore, të cilat vijnë nga jashte trupit të diges, jane dëmtuar edhe kontaktet e diges me shpatin natyral, në krahun e majte të saj, çka e ka bërë të dukshem fenomenin e gërryerjes dhe rrezikimin e qendrueshmerise se trupit të diges ne këte anë.

Ujleshuesi i rezervuarit

Tubi i ujleshuesit mendohet të jetë të paktën Fi 0.5-0.6 m në diameter, por ai duket se është relativisht i mbushur me aluvione, por të dhëna më të plota do të sigurohen gjatë zbatimit të punimeve kur të boshatiset rezervuari e të vlerësohet situata, që sipas një batimetrie të kryer në rezervuar, niveli i aluvioneve duhet të ketë hipur rreth 5÷6 m.
E domosdoshme per tu trajtuar eshte edhe dalja e ujelshuesit, ku nuk nuk duket qartë në se saraçineskat punojnë mirë apo jo.
Dalja e ujlshuesit duhet lidhur edhe me pjesen e pare te lidhjes se ujleshuesit me segmentin e pare te kanalit ujites.

Shkarkuesi katastrofik i rezervuarit.

Eshte i tipit automatik i lire, me pragë e me kapërderdhje
Ka qënë i veshur me beton, por aktualisht kjo veshje rezulton tejet e dëmtuar.
Edhe pragu i shkarkuesit nuk funksionon normalisht dhe ka probleme, sidomos pas renies nga pragu i shkarkuesit, në nje distance prej rreth 50-60 ml , në pjesen e rrymeshpejtuesit (koritës) vihen re disa demtime te mëdha të veshjes, me te theksuara keto ne krahun e majtë pikerisht aty ku në këtë krah, mbi shkarkues ka zona relativisht jo të qëndrueshme me potencial aktiv për të lëvizur, prandaj edhe në projekt janë parashikuar të merren masa më të plota për të shmangur sa do pak ndonjë shkarje të mundshme të zonës mbi shkarkues.
Ne një segment të caktuar është e domosdoshme rehabilitimi i shkarkuesit duke patur në konsideratë edhe formacionet e dëmgtuar ne faqen e majtë të rrjedhës.

Rruga e objektit
Rruga për të shkuar ne objekt e per te hyrë drejt rezervuarit nuk është shumë larg nga rruga kryesore e fshatit, në nje gjatësi prej rreth 750 m, e cila në disa segmente eshte shume e pjerrët dhe, relativisht në gjendje të keqe.
Ajo ka nevojë dhe është konsideruar si një nënobjekt që duhet trajtuar.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

3. DISA TË DHËNA MBI KUSHTET GJEOLOGO-INXHINIERIKE PËR BAZAMENTIN DHE THEMELET KU ËSHTË VENDOSUR DIGA E REZERVUARIT TË BOVËS

Janë të ekspozuara e të dukshme formacionet e shtresave ranore te erreta deri në formacione relativisht të buta, që përfaqësojne bazamentet mbështetëse si në shpatullën e djathtë edhe ne ate të majte të mbështetjes se digës .
Sipas hartes gjeologjike ku publikohet edhe diga e rezervuarit të Bovës , tregohet se bazamentet e digës shtrihen në një zone të mirëfilte argjilore, deri diku edhe me prezencë të lymrave, te rërave si dhe formacionet konglomerate shpesh here të pandarë.

Te pergjithshme

Nje studim gjeologjik eshte ndermarre per kushtet aktuale te diges se Rezervuarit të Bovës dhe punimeve rehabilituese qe nevojiten per ta sjelle ate ne standarte nderkombetare te pranueshme .
Ne menyre qe te behet nje projekt zbatimi per punimet qe propozohen, eshte ndermarre nje studim i hollesishem përgjatë periudhës kohore Qershor – Korrik 2026 .
Mbi bazën e këtyre studimeve që u kryen pergjate diges egzistuese është nxjerrë e përfituar nje informacioni lidhur me kushtet hidrologjike dhe hidrogjeologjike të gjëndjes së digës e të materialeve ndërtimore që janë përdorur për ndërtimin e saj të saj mbi bazën e të cilave mund të dalin konkluzione të nevojshme për vlerësimin e krejt objketit përfshi edhe veshtiresitë e mundeshme që mund të dalin gjatë realizimit të punimeve të propozuara.
Te dhenat qe kane rezultuar nga ky studim i hollesishem jane permbledhur ne kete raport si vijon :

Objektivat :

Objekti i pergjithshem i ketij raporti interpretativ eshte:

- *Te rishikoje dhe te permbledhe te dhenat e meparshme qe kane te bejne me materialet ndertimore te diges ekzistuese;*
- *Permbledhje e informacioneve gjeoteknike te mbledhura ne studimet e fundit me të cilat do të mund te mbeshtet projekti i zbatimit te punimeve ne dige dhe strukturat e veçanta qe i bashkengjiten asaj;*
- *Të identifikoje dhe te pershkruaj veshtiresite e mundshme qe mund te vijne nga ndyshimet e dherave;*
- *E së fundmi të paraqese nje interpretim te rezultateve te studimit gjeologjik per nxjerrjen e parametrave te projektit; ose*
- *Të paraqese rekomandime te projektit lidhur me qendrueshmerine e diges, perfshire nje vleresim te qendrueshmerise se diges ne kushte aktuale dhe nje vleresim per kushtet e propozuar ne projekt.etj.*

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Pershkrimi i Punimeve:
Programi i punes eshte i bashkrenduar me studimin gjeologjik dhe raportin interpretues, i cili mund te permblidhet ne:

- *Pregatitja e programit dhe specifikimeve teknike per punimet;*
- *Supervisioni i punimeve fushore; dhe i provave laboratorike;*
- *Shqyrtimi dhe komentet per draftin e raportit të të dhënave per dherat, dhe*
- *Pregatitja e nje raporti interpretativ lidhur me studimin gjeologjik.*

Burimet e Informacioneve:

Informacionet qe jane perdorur ne kete raport jane marre nga burimet e meposhteme:

- Hartat e publikuara gjeologjike;
- Projektet origjinale dhe te dhena nga ndertimi;
- Vizitat ne terren;
- Informacioni faktik nga studimi gjeoteknik faktik i specifikuar nga kompania SELAS shpk te identifikuara ne listen e references, dhe
- Burime te tjera sic permenden ne listen e references.

Pjesemarresit e perfshire ne studim
Klienti per punimet fushore ishte:
SELAS sh.p.k, Rruga "Vaso Pasha", Pallati 7/1, Tiranë

Kontraktore te ketyre punimve fushore janë :
ALTEA sh.p.k, Pallati "Daci" Apartmenti 5, Tirana

SELAS sh.p.k ka bere specifikimin e punimeve per studimin gjeologjik dhe ka dhene udhezime dhe komente gjate kryerjes se punimeve.

Kufizimet dhe Pergjegjesite per Informacionet
Ky dokument eshte hartuar per porositesin dhe qellimet specifike qe lidhen vetem me projektin e siperpermendur.
Nuk mund te perdoret nga te tjere apo te perdoret per qellime te tjera.
Ne nuk marrim persiper pergjegjesine per pasojat qe mund te kete ky dokument nese perdoret nga te tjere, apo nese perdoret per qellime te tjera, apo nese ka ndonje gabim qe mund te kete rezultuar nga te dhena te furnizuara nga te tjere.
Ky dokument permban informacion konfidencial dhe te drejten e autorit.
Nuk mund t'u behet i ditur te tjereve pa marre miratim nga ne dhe nga porositesi.
Si material shtese:
Meqenese ky dokument bazohet ne informacione te furnizuara nga te tjere, SELAS sh.p.k., nuk merr persiper ndonje mungese apo shtremberim qe mund te vije nga konkluzionet e klientit te bazuar ne te dhenat e marra nga te tjere pervec SELAS sh.p.k ose atyre te perdorura nga SELAS sh.p.k per hartimin e ketij raporti.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Po ashtu, ky dokument eshte i bazuar edhe në informacione të marra nga studimet e meparshme apo ato ta tanishme, personat qe do t'i perdorin, duhet te kene parasysh se keto studime jane kryer per kushtet e nje fraksion te caktuar të nenshtresave.
Dhe në çfardo studimi tjeter gjeologjik mbetet me risk në se do të mund te gjenden xhepa apo "pjese te nxehta" te rezikshme te cilat mund te mos jene identifikuar, kjo per arsye se studimi eshte kryer ne baze te provave ne pika te veçanta.
Disa nga treguesit, të evidentuar si tregues te rezikshme apo konditcione që mund te kene qene jashte pjese qe eshte marre ne shqyrtim, mund te mos jene identifikuar dhe vleresuar plotesisht, prandaj ato duhet të merren gjithënjë me rezerva.

Pershkrimi i Zones dhe Perkufizime

Vendndodhja dhe Pershkrimi i pergjithshem

Diga e Rezervuari të Bovës ndodhet ne Qarkun e Beratit ne Shqiperi. Ajo ndodhet rreth 20 km ne Lindje te Beratit me koordinatat **40º 73'33" gjatesi dhe 20º 03'44"** Lartesi.
Diga e Rez. të Bovës ka nje lartesi rreth 30 m dhe gjatesi 230 m.
Pozicioni i diges eshte treguar ne fleten e vizatimit perktes. që është paraqiutur nga firma kliente "Selas" shpk.

Detaje per Rezervuarin dhe Digën e Rez. të Bovës dhe rrjetit ujites qe lidhet me të, jane dhene ne Relacionin Teknik të hartuar nga firma Projektuese per Rehabilitimin e digës dhe nënobjekteve të saj nga SELAS sh.p.k

Gjeologjia:

Harta gjeologjike lokale e zones se Beratit eshte shqyrtuar per te bere studimin gjeologjike te zones se Diges se Rez. të Bovës (Figure 3.1).
Harta gjeologjike tregon se Diga e Rez. Të Bovës eshte ndertuar ne rajonin e depozitimeve flishire te moshes Oligocene te Mesme, me permbajtje "argjilite, shtufe, konglomerate si edhe qymyre".
Harta nuk paraqet perberjen gjeologjike te siperfaqes qe mbulon depozitimet flishore te kesaj zone.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Figure 3.1: Harta gjeologjike e rajonit te Diga e Rez. Të Bovës (Pa shkalle)



Burimi: Harta Gjeologjike e Shqiperise, Shkalla 1:200,000, Viti 2002

Gjate vizitave te para bazamenti natyral eshte gjetur i zhveshur ne shpatullen e majte te diges. Materiali rezulton te jete "Argjilite te shtresezuara te dobeta me ngjyre gri te hapur, (35-50 mm trashesi) te perziera me shtresa shtufi (30-70 mm te trasha)"
Ky material eshte konsideruar si prezantues i depozitimeve flishore te pershkruara ne harten gjeologjike.

Shqyrtimi i te dhenave te meparshme

Hartat e projektit original tregojne se Diga e Rez. të Bovës kryesisht eshte e mbeshtetur në këto shtresa:

- *Argjila lymore te verdha ne kafe pak te lageshta dhe normalisht te konsoliduara, qe mbulojne Lyme te lagesht ne ngjyre te verdhe mesatarisht te konsoliduara me pjese laralara (vendevende), te mbi vendosura mbi zhavorre e popla gelqerore (deri me 50 mm diameter) me permbajtje rere, argjile e lymi, te vendosura mbi Depozitimet flishore (me origine Oligocene) me permbajtje shtufi dhe argjilitesh.*

Keto detaje tregojne se mbi bazamentin flishor te zones se diges ka materiale siperfaqesore. Vetem nje vizatim eshte gjetur nga dokumentet e projektit original.
Ky vizatim tregon nje shtrese zhavorrore ne pjesen e shtratit te prroit me trashesi rreth 2 m. Keto duken se jane zhavorre tipike te shtratit te lumit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Nje shtrese 2m e trashe me permbajtje argjila lymore shtrihet ne dy anet e lugines.
Keto duken te jene me se shumti depozitime aluviale.
Keto detaje do te merren parasysh gjate hartimit te modelit te vleresimit te qendrueshmerise se diges.
Vizatimet e projektit origjinal jane dhene ne Shtojce të veçantë

Punimet Fushore
Punimet fushore jane kryer nga ALTEA Shpk ne Qershor- Korrik 2026 dhe bazohen në vrojtimin dhe vlerësimin e tre zona (tip gropash) te hapura me dore nga gërmime të mëparshme ose rreshqitje relativisht të pastra , dhe nje profil idetajuar gjeologjik i faqeve të ekspozuara ne zonen e demtuar te rrymeshpejtuesit.
Provat laboratorike jane kryer nga kompania ALTEA Shpk, mbi bazën e vlerësimit të kampionebve të prishura e të paprisjhura që muatren në object
Nje permbledhje e punimve fushore dhe provave perkatese laboratorike jepet me poshte.

Punimet fushore :
ALTEA Shpk paraqiti nje çertifikate per kryrjen e aktivitetit fushor te mbeshtetur me kerkesat e ISO 9001:2008.
Specifikimet teknike, te cilat jane pjese e dokumenteve te kontrates, deshmohet se punimet do te kryhen sipas kodeve:

BS5930 + Amendmenti 2 (BSI, 2010); Kodi mbi praktikat e punimeve gjeoteknike
BS1377:1990; Metodat e testimit per dherat per qellime inxhinierike (BS, 1990)
BS EN ISO 22475-1 (BSI, 2006); Punime Gjeoteknike dhe provat: Metodat e marrjes se mostrave matja e ujerave nentokesore
BS EN ISO 14688-1 (BSI, 2002); Identifikimi dhe klasifikimi i dherave
BS EN ISO 14689-1 (BSI, 2003); Identifikimi dhe klasifikimi i shkembit
Thellesia e marrjes se kampionve varion ndermjet 1.0 m dhe deri në 2.5 m.
Plisa dhe mostra te prishura jane mrre edhe nga gropa te vogëla të hapura e të dukshme , me synim paraqitjen e shtresave gjeologjike te hasura në objket .
Keto mostra kishin nje peshe 10 deri 15 kg.
Provat Laboratorike
Provat laboratorike te mostrave te marra në object, jane percaktuar nga SELAS Ltd dhe jane marre nga ALTEA Shpk.
Keto prova jane kryer ne perputhje me standartet e specifikuara
Sistemi i cilesise se laboratorit te ALTEA-s jane te çertifikuara nga CISQ (Federata Italiane e menagimit te sistemit te Çertifikimit) qe jane te njejta me ISO 9001:2000

Table 3.1: Permbledhje e provave te plotesuara nga ana e ALTEA Shpk

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Lageshtia	BS 1377-2:1990
Granulometria	BS 1377-2,9,5:1990
Pesha specifike	ASTM D 854-10
Kufijt e Atterbergut	ASTM D 4318-10
Prova e Modifikuar e ngjeshjes Proctor	ASTM D 1557

Rezultatet e Studimit te Dherave
Lloji i Dherave
Materialet e dherave te marra gjate kryerjes se studimit ne digen e Diga e Rez. të Bovës jane permbledhur me poshte. Me synimin e pershkrimit me te sakte te dherave te kesaj zone, eshte pregatitur nje model dherash per trupin e diges dhe nje per dherat natyrale ne afersi te shkarkuesit. Keto jane permbledhur ne tabelat 4.1 dhe 4.2 respektivisht.

Table 4.1: Permbledhje e kushteve te dherave te hasura gjate studimit te diges se Diga e Rez. të Bovës – Trupi i Diges

Shtresa e siperme ngjeshur me prani rrenjesh.	0	0.35 - 0.7	Argjile pak e lagesht boje kafe me lyme te

Tabela 4.2: Permbledhje e kushteve te dherave te hasura gjate studimit te diges se Diga e Rez. të Bovës – Formacioni baze, afer shkarkuesit

Aluvione Lumore (Kohezive)	0	0.35 - 3.5 (Deri ne 3.5)	Argjile lymore pak e lagesht te forta me permbajtje rrenjesh. Lym argjilor kafe e hapur te ngjeshura
Zhavorre Lumore	0.35 - 0.7 (aty ku gjenden)	0.4 - 0.9	Zhavorr gri I perzier me rere te ngjeshur. Zhavor me korkiza pak te rrumbullakosura e gjysem te kendore.
Depozitime flishore	0.75 - 1.6 (aty ku gjenden)	Deri ne 0.9	Argjilite lymore te ngjeshura kafe e hapur te perajruara me shtresa te nderthurura shtufi.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Nga vrojtimet rezulton materiali mbushes me mbizoterim te Argjilave dhe Lymeve (aluvione lumore) me shtresa zhavorri (Lumi) jane hasur gjate vleresimeve metra trashesi.
Depozitimet flishore kapen ne thellesine 0.75 m ne DH-MTP-201 dhe ne 1.6m ne DH-MTP-204.
Ne te dy rastet materiali u gjet shume i fort dhe i veshtire per t'u germuar keshtu thellesia e gropes ndaloi ne 1.0m ne DH-MTP-201 dhe ne 2.5m ne DH-MTP-204.
Nje profil I detajuar eshte bere per skarpaten e zhveshur ne afersi te shkarkuesit, qe perbehet nga nje material " Argjile me rrenje kafe e hapur nganjehere blu e hapur" e cila mbulohet nga nje shtrese kafe zhavorore me kokriza te medha"
Kjo eshte konsideruar si prezantuese e shtrese se holle aluvionale, shtrese e cila shtrihet edhe ne shpatet e lugines nen dige.
Kjo po ashtu perfaqeson edhe terracat e vjetra lumore shtrirja e te cilave nuk ka qene e mundur te percaktohet me saktesi gjate vizitave te bera.
Lageshtia
12 prova jane bere per percaktimin e lageshtise natyrale te materialit mbushes te diges dhe aluvioneve lumore dhe dhe zhavorreve lumore. Rezultatet jepen ne Figuren 4.1.
Lageshtia e dherave te mbushjes luhatet ndermjet vlerave 8% deri 11%, nderkohe kur depozitimet Pliocene dhe depozitimet e perajruara Pliocene tipikisht kishin nje lageshti 13% deri 16%. Vihet re nje tendence ne rritje e lageshtise ne lidhje me thellesine duke u zvogluar ne afersi te siperfaqes. Bovet theksuar se shumica e mostrave eshte marre ne nje shtrese te siperme qe nuk e kalon thellesine 3.45 m. po ashtu Bovet theksuar se megjithe perkushtimin e dhene nuk ka qene e mundur te merret nje moster e paprishur ne zonen e Diga e Rez. të Bovës, keshtu qe lageshtia e dheut mund te mos jete ruajtur e pandryshuar deri ne berjen e proves.

Figure 4.1: Grafik i lageshtise natyrale ne lidhje me thellesine nen siperfaqen e tokes



Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

4. *Sizmiciteti i zonës*

Harta sizmike e përpunuar nga ***Aliaj et. al****. (Akademia e Shkencave 2004),* për referencë (shih vëllimin 1 te ketij libri), tregon se vendi ku shtrihet diga e rezervuarit të Bovës , përfaqesohet nga një zonë ku ngjarja sizmike e periudhës së kthimit të vlerësuar prej 475 vitesh do të kishte një përshpejtim maksimal të tokës jo me shume se 0.4g.

Për vlerësimin treguesve të rrezikut sizmik në zonë , nga disa të dhëna të kufizuara që janë në dispozicion, tregojne se rreziku i llogaritur i shkatërrimit për shkak të një ngjarjeje sizmike nuk është i pranueshëm, edhe per faktin se të gjitha të dhënat gjeoteknike për shumë nga digat e tjera flasin për një stabiliteti që është shmë më shqetësues se zona e digës në fjalë.

.

5. Zona e Pellgut shimbledhës

Përsa i përket zonës së drejtpërdrejtë të pellgut shimbledjës të rezervuarit në një sipërfaqe prej 7 km2 , shtrihet përgjithësisht i gjithë ne nje pellg shimbledhes te tipit të nje zone relativisht zonë malore

Permbledhje dhe konkluzione
Kushtet e Gjeoteknike
Rezultatet e punimeve te fundit gjeologjike tregojne se materiali mbushes qe eshte perdorur per ndertimin e diges se Diga e Rezervuarit të Bovës perbehet nga "Lyme argjilore pak te lageshta me ngjyre kafe te hapur ne kafe te mbyllur"
Harta gjeologjike tregon se diga eshte ndertuar ne nje rajon te depozitimeve Flishore me depozitime te aluvionove lumore dhe zhavorore. Diga eshte ndertuar me nje dhemb ne baze, i cili nderpret shtresen e siperme dhe inkastrohet ne flishe. Jane percaktuar parametrat gjeoteknike per materialin mbushes dhe ate ne trupin e diges, bazuar ne studimin e fundit, studimet e mepershme dhe njohurite e formuara nga kushtet aktuale te diges.
Keta paramatra Boven perdorur si udhezues per projektimin e diges, pasi ka mundesi te variacioneve te vetive te materilait mbushes dhe atij te bazamentit. Parametrat e dale Boven zbatuar me kujdes me synim marrjen parasysh te ketyre variacioneve.

Qendrueshmeria e Diges
Qendrueshmeria e diges eshte analizuar ne ngarkesa statike, nivel maksimal llogarites, ulje te shpejte te nivelit te ujit dhe ngarkesa pseudostatike te ndara ne dy grupe, bazuar ne tedhenat e projektit original dhe at ate tanishmetMundesia e lengezimit te materialit po ashtu eshte vleresuar. Rezultatet jane vleresuar bazuar ne kriteret e projektimit te paraqitura ne Raportin e Kritereve te Projektimit (Mott MacDonald, 2012b), dhe ne permbledhjen e meposhtme:
Koeficienti i Qendrueshmerise (KQ) per ngarkesa statike dhe nivel maksimal jane te pranueshem per ted y skarpatat te poshtemen dhe te sipermen ne te gjithe seksionet e shqyrtuara.
Analiza per gradiente te larte hidraulike ka treguar se nuk ka ndonje problem lidhur me sufozine ne thembren e diges ne anen e poshteme te saj.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Skarpata e anes se siperme ka rezultuar me KQ te pranueshem per nje ulje te shpejte te nivelit te ujit ne rezervuar deri ne 3 m. Analiza e ndjeshmerise ka treguar se ky koefiçient bie deri ne 1.0 nese ulja e nivelit behet 6 m.

KQ per digen me ngarkesa seizmike, per analizen pseodostatike ka rezultuar me I vogel se vlera e lejuar (<1.0) per skarpaten e anes se poshteme te disa nga seksionet e shqyrtuar te anes se siperme dhe per te gjithe seksionet e anes se poshteme. Nje analize e deformimeve eshte bere me kete rast.

Vleresimi ne teresi i mundesise se lengezimit te materialit tregon se materiali mbushes ne digen e Diga e Rez. të Bovës nuk eshte potencialisht i lengezueshem. Reziku I lengezimit ne digen e Diga e Rez. të Bovës nuk egziston.

Nje analize e deformimeve, bazuar ne metoden e Makdisi-Seed (1978), eshte bere per percaktimin e deformimeve qe mund te ndodhin ne digen e Diga e Rez. të Bovës ne rast te renies se ndonje termeti ne zonen rreth saj. Rezultatet e ketij vleresimi tregojne se edhe ne termetin me nje magnitude 7.5 M deformimi arrin deri ne vleren 0.9 m. Ky deformim nuk ka mundesi te shkaktoje nje kaperderdhje te ujit mbi dige, keshtu qe eshte konsideruar si deformim I pranueshem.

Konkluzione

Analizat e bera si pjese e studimit te diges egzistuese te Diga e Rez. të Bovës kane treguar se ajo eshte e qendrueshme me nje koeficient qendrueshmerie me te mad hose te barabarte me 1.5 per te gjithe seksionet e shqyrtuar. Per ngarkesa pseudostatike koeficenti I qendrueshmerise ka rezultuar me I vogel se
1.0, por deformimet e shaktuara nga nje ngjarje seizmike maksimale kane rezultuar te pranueshme.

6. KLIMA DHE RESHJET

Bashkia e Beratit dhe Njësia Administrative Roshnik , shtrihen pothuajse, në dy zona klimatike. Territori verior i bashkisë, karakterizohet nga *klima mesdhetare fushore jugore.*
Ndërkohë që pjesa tjetër e territorit të bashkisë, në Jug e Jug-Lindje i nënshtrohet kushteve klimaterike karakteristike për nënzonën *mesdhetare kodrinore jug-lindore* , përfshi këtu edhe zonën e pellgut ujëmbledhës.

Në përgjithësi, kjo zonë karakterizohet nga një shpërndarje e dukshme e rreshjeve ku numri i ditëve me rreshje është nga 110 deri 120 ditë.
Dimri është relativisht i butë dhe ditët me ngrica në këtë territor janë të pakëta, duke mos i kaluar 5 -10 ditë në vit.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com



Figura 6 .1. Harta e Zonave Klimatike

6.1 Temperaturat e ajrit

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Mesatare Mujore	**7.1**	**9.2**	**11.3**	**14.6**	**17.8**	**23.5**	**25.9**	**26.2**	**22.2**	**16.9**	**12.5**	**8.4**
Mesatare Maksimale	**11.6**	**13.4**	**16.2**	**20.2**	**24.2**	**29.1**	**32.1**	**32.4**	**27.4**	**22.9**	**18.4**	**13.3**
Mesatare Minimale	**4.1**	**5.3**	**7.2**	**10.5**	**14.4**	**18.7**	**20.9**	**21.1**	**17.2**	**13.3**	**10.3**	**5.2**
Ditë me ngrica	**2.8**	**1**	**0.2**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**1**
Ditë të nxehta	**0**	**0.4**	**0**	**4.2**	**11.6**	**25.1**	**30**	**29**	**21.1**	**8.5**	**0.5**	**0**
Maksimum absolut	**18.7**	**23.3**	**24.9**	**271**	**33.1**	**37.6**	**40.2**	**39.8**	**36.7**	**34.2**	**29.1**	**23.5**
Minimum absolut	**-7.5**	**-2.5**	**-0.1**	**2.8**	**7.9**	**11.4**	**15.2**	**16.2**	**7.8**	**4.6**	**0.5**	**-3.6**

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Tabelë: 4. **Error! No text of specified style in document.** Luhatja e temperaturave gjatë vitit



Figura 6-2 Grafiku i shpërndarjes së temperaturave

Nga tabela duket se muaji më i ftohtë është Janari dhe më i ngrohti Gushti. Minimumet absolute që vrojtohen pothuaj çdo vit janë nga – deri 0 °C.
Në dimrat e ftohtë ato zbresin deri –4 deri –7 °C.
Maksimumet absolute që vrojtohen pothuaj çdo vit janë nga 31 deri 36°C. Në verat e nxehta temperaturat shkojnë deri 40 °C.

6- 2 RESHJET

Njësia Administrative Roshnikut përfshihet në *Nënzonën Klimatike Mesdhetare Kodrinore Jugore*.
Në pjesën lindore kodrinore të nënzonës, ku ndodhet edhe përroi i Bovës shuma vjetore e reshjeve arrin deri në 1000-1200 mm.
Numri i ditëve me reshje (llogariten rreshjet që rezultojne më të mëdha se 1 mm) është mbi 110 ditë në vit .
Për të karakterizuar regjimin e reshjeve në këtë zonë në tabelat dhe grafiket e mëposhtëm jepen të dhëna të rëndësishme mbi rreshjet në Zonën e Roshnikut, Bashkia Berat,
Këto vlera janë rezultat i përpunimit të serive shumëvjeçare të reshjeve (20,30 vjet), seri vrojtimesh e pranuar nga Organizata Botërore e Meteorologjisë për kryerjen e studimeve klimatike të një rajoni të dhënë.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
50-100 mm	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
20-50 mm	1.7	1	1.3	1.3	1	0.9	0.2	0.4	1.3	1.4	1.9	2.3

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 *Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974*
Tiranë-Albania *Email : selasltd@hotmail.com*

10-20 mm	3.2	3	2	1.8	2.2	0.7	0.6	0.6	1.4	1.8	2.5	2.8
5-10 mm	2.2	3.4	2.6	2	2.6	0.8	0.8	0.4	1.5	1.6	2	2.1
1-5 mm	3.4	3.1	3.5	3.1	3.2	2.2	1.2	1.5	2.3	2.9	3.2	2.5
0.1-1 mm	2.3	2.8	2.9	2.3	2.2	2	1.7	0.5	1.6	2.1	2.8	2.4
Ditë e Thatë	18.2	14.7	18.7	19.5	19.8	23.4	26.5	27.6	21.9	21.2	17.6	18.9
Ditë me Shi	12.8	13.3	12.3	10.5	11.2	6.6	4.5	3.4	8.1	9.8	12.4	12.1
Rreshjet Mesatare (Rreshjet Mesatare (mm) mm)	125.4	107.2	100.5	89.4	105.5	57.4	24.2	34.1	77.5	96.2	158.2	124.4



Figura 6-3 Histograma e reshjeve mesatare mujore

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania

Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
0.1-1 mm	2.2	2.7	2.9	2.3	2.2	1.4	1.8	0.5	1.7	2.1	2.8	2
1-5 mm	3.5	3.2	3.7	3	3.6	2.3	1.2	1.5	2.3	3	3	2.5
5-10 mm	2.2	3.9	2.8	2	2.7	0.7	1	0.2	1.5	1	2.2	2
10-20 mm	2.8	3	1.8	1.5	2.4	0.6	0.5	0.6	1.3	1.6	2.4	2
20-50 mm	1.6	0.9	1.3	1.3	1	0.9	0.2	0.6	1.3	1.4	2.1	1.4
50-100 mm	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ditë e Thatë	18.5	15	18.9	19.7	18.7	23.8	26.2	27.3	21.5	21.7	16.8	20.8
Ditë me Shi	12.5	13	12.1	10.3	12.3	6.2	4.8	3.7	8.5	9.3	13.2	10.2

Figura 6-4 Shpërndarja e reshjeve

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com



Figura 6-4 Densiteti i Reshjeve Vjetore (1), Verë (2), Dimër (3)

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

6-3 REGJIMI HIDROLOGJIK

Një tregues i rëndesishëm dhe i dobishëm për qëllime hidroteknike është sasia e reshjeve maksimale 24 orëshe dhe reshjet maksimale për intervale të tjera kohore përfshi edhe 20 min e për periudha të ndryshme përsëritje.
Duke u mbështetur në seritë e vlerave maksimale të reshjeve të rëna gjatë 24 orëve. është bere e mundur dhe janë llogaritur vlerat e pritura të intensiteteve të reshjeve për periudha të ndryshme përsëritje si dhe kurba IDF.
Në tabelat e mëposhtme shfaqen dhe prurjet mesatare ndër vite të matura në stacionet hidrometeorologjike përkatëse dhe të përpunuara për përqindje sigurie të ndryshme.

VEND	MMND	24h	C_v	C_s	1	2	5	10	25	50	75	90	99	VITE
Kuçove	53	74.6	0.49	2.94	206.0	182.0	139.0	116.0	87.3	66.4	51.5	41.8	30.6	23
Corrovode	290	110	0.35	2.10	242.0	220.0	180.0	156.0	125.0	102.0	84.7	72.6	58.3	18
Mes.	-	92.3	0.42	2.52	226.0	205.0	158.0	139.0	107.0	79.0	68.1	57.2	44.5	-

Tabelë: Rreshjet më të medha 24h për sigurinë P%, Vendmatja Kuçovë

Kohëzgjatja e reshjeve [orë]	Siguria (shpeshtësia) [%]					
	1	2	5	10	20	50
	[mm]	[mm]	[mm]	[mm]	[mm]	[mm]
24	226	205	158	139	107	79
12	211	190	143	123	93	65
6	163	146	111	97	73	52
2	109	99	76	67	51	38
1	93	84	63	54	42	30
0.5 (30 min)	63	58	43	38	30	22
0.33 (20 min)	52	44	33	30	24	19
0.1667 (10 min)	40	36	28	24	19	14

Tabelë: Intesitetet orare me periudhë përsëritje të ndryshme

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com



Figura 6-5 Kurba IDF, mesatarizuar mes për Kuçovën

6-4 ERËRAT

Zona e Beratit sadopak, ndikohet nga erërat që vijnë nga Deti Adriatik që hasin pengesa vetëm përgjatë terrenit kodrinor. Zona e Roshnikut, për shkak edhe të gjeografisë e terrenit kodrinor ndikohet më shumë nga erëra me drejtim veriperëndimin dhe juglindjen, me vlerë rastisje mesatare prej jo më shumë se 33% dhe qetësie Q=44%.



Figura 6-6 Grafikët e shpejtësisë dhe rastisjes së erës

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

6. 5 Llogaritjet hidrologjike dhe hidraulike në lidhje me reshjet atmosferike.

Përgjithësisht për perllogaritjet hidrologjike, ne studim, duhet ti referohemi *Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 68, dt. 13.02.1989,*
Referuar këtij Vendimi, objekti ne fjale i takon te jete objekt i Klasit III, dhe sipas ketij vendimi, prurjet llogaritese te shkarkimit, duhet ti referohen prurjeve me 2 % siguri, dhe për ato kontrolluese, prurjeve me 0.5 % siguri.
Por per vleresimin e klasit te veprës se mesiperme , në kete studim i jemi referuar edhe udhëzimeve që janë dhëne nga Komiteti Kombetar i Digave te Larta (KKDM), sipas te cilit shkalla e sigurise se digave, duhet të rritet disi ,në rastin kur në zonën mbas digës ka qëndra banimi. Në rastin tonë, qendra më e afert e banimit eshtë larg dhe praktikisht ai është relativisht larg aksit të digës deri në më shumë se 16 km.
Sidoqofte, projekti ka marre parasysh prezencën e disa shtëpive, jommë shumë se 20-30 shtëpi, të vendosuar përgjtë brigjeve të përoit të Boves , diku në afersi të fshatit Roshnik, por edhe këto shtëpi ndodhen relativisht lartë, rreth 10-15 m mbi brigjet e tabanit të rrjedhes së përroit të Boves.
Duke marrë parasysh nje numur relativisht të vogël banoresh, mbase jo më shumë se 100 vetë, referuar Udhëzimitt ë mësipërm të KKDM , në project është përzgjedhur që llogaritjet hidrologjike të keyhen për një periudhë kthimi (përsëritje) prej 100 vitesh, ose 1 %) . ndërkohë që kontrolli duhet të bëhet për periudhën e kthimit një herë në 1000 vijet, ose me siguri 0.1%.
Ne studim, janë marrë në konsoderatë disa teori të ndryshme, për të vlerësuar prurjen e gjeneruar nga reshjet atmosferike në një vepër të tillë. Por në këtë material, më shumë jemi ndalur në dy teori te përzgjedhura për trajtimin e fenomeneve hidrologjike dhe ato hidraulike,

Konkretisht :
Në teorinë e njohur si Teoria e ashtuquajtur Teoria e **MUSKİNGUM-it**, e cila bazohet tek **Metoda SCS CN.**
Sipas së cilës pellgu shimnbledhës ndahet, virtualisht, në shumë nën pellgje të tjerë më të vegjël të cilet, nëpërmjet një seri koeficientesh japin prurjet max për një sasi të caktuar rreshjes e por disa karakteristika të caktuara atmosferike.

Në këtë rast, metoda e llogaritjes së vonesës të kohës së bashkëardhjes si shtesë në degëzime të ndryshme të rrjedhës do të rregullohet duke u bazuar në metodën e Muskingum, e cila bën saktësimin final të vlerës së ardhur të prurjes dhe hidrografit përfundimtar të prurjes, i cili është rezultati i nevojshëm e i pranueshëm i të gjithë llogaritjeve.

Metoda tjetë është ajo e futur ne këto 30 vitet e fundit nga Kompania Britanike **“ HALCROW”**, e cila I referohet kryesisht llogaritjeve hidrologjike të shumë vendeve Perëndimore që bazohen tek teorite e njohura te trupave ushtarake amerikane, të cilat përgjithësisht kanë ndërtuar disa grafike ku krahasohen e vlerësohen element, në dukje të rëndomtë , por me rezultate relativisht të mira e të dokumentuara të cilat kanë dhënë rezultat.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Në këtë studim, është përzgjedhur që të përdoret kjo metodë, e cilësuar si metoda e "HALCROW" dhe sipas se cilës do të kemi pasqyren e meposhtme te prurjeve maximale me nje propabilitet (% te sigurie te caktuar).

Mbi bazen e ketyre prurjeve jane bere edhe llogaritjet per vleresimin e prurjeve te akumuluar dhe te atyre qe do te mund te largohen pa shkaktuar probleme ne veprat e veçanta te diges.

7.STUDIMI DHE TRAJTIMI I ZGJIDHJEVE TEKNIKE TE PROJEKTIT

Bazuar ne te dhenat e siguruara dhe studimet e kryera siç shprehet me siper, projekti e ka trajtuar rehabilitimin, ne kuader te mirembajtjes te kesaj vepre si me poshte:

Ne Rezervuarin e Bovës, kemi te bejme me nje dige e cila eshte ndertuar rreth 45 vjet me pare dhe i ka rezistuar normalisht kohes qe ka kaluar.

Ajo eshte nje dige homogjene me mbushje argjilore. Ajo digë, eshte e inkastruar nepermjet nje dhembi ne formacionet rrenjesore flishore ne te dy brigjet dhe ne shtratin e perroit mbi te cilin ajo eshte ndertuar.

Mbushja e rezervuarit realizohet plotesisht nepermjet pellgut te vet shimbledhes.

Nga vrojtimet e kryera dhe nga informacionet e marra nga specialistet qe jane marre dhe e kane shfrytezuar kete rezervuar, duket se diga ka funksionuar normalisht dhe pa probleme te vecanta qendrueshmerie.

Diga paraqitet ne gjendje te mire, me skarpata qe pergjithesisht ruajne pjerresite fillestare dhe nuk vihet re ndonje deformacion i dukshem apo ndonje rreshqitje ne trupin e diges.

Shkarkuesi siperfaqesor automatik megjithë dëmtimet që ka pësuar, eshte ne gjende pune dhe ka funksionuar.

Problem, kryesor per kete veper eshte bllokimi i pjesshëm i ujleshuesit dhe dëmtimet në shkarkuesin katastrofik.

Pavarësisht se rezervuari nuk shfrytëzohet shumë për ujitje, për shkak të mos ekzistencës e mos funksionimit të stacionit të pompimit, fakti që kemi të bëjmmë me një rezervuar me volum ujë të konsiderueshem, projekti sugjeron se masat për rritjen e qëndrueshmäerise së digës dhe monotorimit të saj duhet ti kushtohet patjetër vëmëndja dhe masat për rritjen e sigurisë së kësaj vepre duhet të meren në përputhje me klasin e veprës.

Sidoqofte, meqenese ketu kemi te bejme me nje rezerve ujore te konsiderueshme, nevoja per kujdesin dhe miremabtjen per kete rezervuar eshte e domosdoshme.

Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1
Tiranë-Albania
Tel / Cel : + 355 68 20 95 150 , + 355 42 24 4974
Email : selasltd@hotmail.com

Projekti ka parashikuar qe kanali i mbledhjes se ujrave ne fund te skarpates se jashteme te diges te kete edhe nje nenshtrese zhavori me t = 10 cm nga ana e faqes se diges, ku eshte parashikaur te lihen edhe bira shkarkimi (me tuba PVC) per te mbledhur ujrat e mundshme te filtrimeve nga ana e skarpates se diges.

Rikonstruksioni i shkarkuesit katastrofik te rezervuarit te Bovës

Siç u pershkrua edhe me siper, pergjithesisht shkarkuesi i ketij rezervuari ka funksionuar normalisht e pa probleme, por pas renies nga pragu i shkarkuesit, pas nje distance prej rreth 30-40 ml , ne pjesen e rrymeshpejtuesit (korites) jane vene re demtime të konsiderueshme te veshjes me beton te shkarkuesit.

Ne keto kushte projekti ka parshikuar riparimin në tërësi të veshjes se shkarkuesit si dhe trajtimin me disa masa mbrojtese (veshje me beton e përforcim me mure mbajtës te zones qëndrore të shkarkuesit).

Riparimi i veshjeve te demtuara te shkarkuesit eshte bere sipas detajeve te veshjeve egzistuese me b/arme M 200, shoqeruar edhe me disa brinjerigjide , ose dhembe inkastrimi me gjersi 40 cm e thellesi deri ne 40 cm, te realizuar me b/arme M200 , kurse rakordimi i derdhjes se perroit (rrekese) ne shkarkues eshte trajtuar ne nje segment deri ne reth 2 ml para derdhjes ne shkarkues me veshje me trashesi 20 cm dhe me dy dhemb inkastrimi nje ne hyrje dhe nje na dalje te veshjes (shih detajet ne fletet e vecanta te vizatimeve .

Ne kuadrin e mirembjatjes se rruges per ne kete veper projekti ka perfshire edhe riparimin e nje ure te re auto me Hd = 5m, pikerisht mbi perroin kreysor te kryqezimit te rruges me shkarkuesin.

Per rikonstruksionin e ujleshuesit te rezervuarit

Siç u theksua edhe me siper, ky rezervuar ka vetem nje ujleshues, ate te realizuar nepermjet nje tubacioni te komanduar nepermjet nje sistemi saraçineska, ne seri, njera pas tjetres.

Nga inspektimet qe u ben, rezulton se edhe ky ujleshues mund të jetë i dëmtuar dhe jashte funksioni.

Ne keto kushte projekti ka pare disa mundesi per riparimin e ketyre defekteve
Menyra e pare, duhet të pastrohet ujlëshuesi nepermjet agregateve (makineri te posaçme) te pajisura me mjetet e nevojshme, perfshi motopompa me presion, tubacionet e largimit te ujit etj , nepermjet te cilave do te behet thithja dhe largimi i ujit nga rezervuari, duke e hedhur ujin ne shkarkuesin e diges. Pas boshtisjes se rezervuarit, do te shikohet mundesia per riparimin e pusetës së hyrjes dhe saracineskave ne dalje të ujlëshuesit.

